


Manuali referencë për instaluesin

Seria Split R32 – Depozita e ujit të ngrohtë sanitar



<https://daikintechicaldatahub.eu>



EKHWET90B ▲ V3 ▼
EKHWET120B ▲ V3 ▼

▲ = 1, 2, 3, ..., 9, A, B, C, ..., Z
▼ = , , 1, 2, 3, ..., 9

Tabela e përmbajtjes

1	Rreth këtij dokumenti	5
1.1	Kuptimi i alarmeve dhe simboleve.....	6
1.2	Vështrim mbi udhërrëfyesin referencë të instaluesit	7
2	Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme	9
2.1	Për instaluesin	9
2.1.1	Këshilla të përgjithshme	9
2.1.2	Vendi i instalimit	10
2.1.3	Gaz ftohës - në rastin e R410A ose R32	10
2.1.4	Uji	12
2.1.5	Elektriket	12
3	Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit	15
4	Rreth kutisë	20
4.1	Njësia e brendshme.....	20
4.1.1	Hegja nga paketimi i njësive të brendshme.....	20
4.1.2	Hegja e aksesorëve nga njësia e brendshme	20
5	Rreth njësive dhe opsioneve	22
5.1	Identifikimi.....	22
5.1.1	Etiketa e identifikimit: Njësia e brendshme	22
5.2	Opsionet e mundshme për njësine e brendshme	22
6	Udhëzimet e përdorimit	23
6.1	Përmbledhje: Udhëzimet e përdorimit.....	23
6.2	Konfigurimi i depozitës së ujit të ngrohtë sanitar.....	23
6.2.1	Ndërtimi i sistemit – Depozita e pavarur e ujit të ngrohtë sanitar.....	23
6.2.2	Zgjedhja e vëllimit dhe temperaturës së dëshiruar për depozitën e ujit të ngrohtë sanitar.....	23
6.2.3	Parametrizimi dhe konfigurimi – Depozita e ujit të ngrohtë sanitar	25
6.3	Konfigurimi i kontrollit të konsumit të energjisë.....	25
6.3.1	Kufizimi i përhershëm i fuqisë	26
6.3.2	Procesi i kufizimit të fuqisë.....	26
7	Instalimi i njësive	28
7.1	Përgatitja e vendit të instalimit.....	28
7.1.1	Kërkesat e vendit të instalimit për njësine e brendshme	28
7.1.2	Kërkesat e veçanta për njësitet R32	29
7.1.3	Modelet e montimit.....	31
7.2	Hapja dhe mbyllja e njësive.....	36
7.2.1	Rreth hapjes së njësive	36
7.2.2	Për të hapur njësine e brendshme.....	36
7.2.3	Mbyllja e njësive të brendshme	37
7.3	Montimi i njësive të brendshme	37
7.3.1	Rreth montimit të njësive të jashtme	37
7.3.2	Masat paraprake kur montohet njësia e brendshme	37
7.3.3	Instalimi i njësive të brendshme.....	37
8	Instalimi i tubacionit	39
8.1	Përgatitja e tubacionit të ftohësit.....	39
8.1.1	Kërkesat e tubacionit të ftohësit	39
8.2	Lidhja e tubacionit të gazit ftohës.....	39
8.2.1	Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësine e brendshme	39
8.3	Përgatitja e tubave të ujit.....	40
8.3.1	Kërkesat për qarkun e ujit	40
8.4	Lidhja e tubave të ujit.....	42
8.4.1	Rreth lidhjes së tubave të ujit.....	42
8.4.2	Masat e kujdesit gjatë lidhjes së tubave të ujit.....	42
8.4.3	Për të lidhur tubat e ujit	42
8.4.4	Për të lidhur tubacionin e riqarkullimit	43
8.4.5	Për të mbushur depozitën e ujit të ngrohtë sanitar	43
9	Instalimi elektrik	45
9.1	Rreth lidhjes së instalimeve elektrike	45
9.1.1	Masat paraprake kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike	45
9.1.2	Udhëzimet kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike	46
9.1.3	Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike.....	47

9.1.4	Rreth pajisjes elektrike.....	48
9.2	Lidhjet në njësinë e brendshme.....	48
9.2.1	Për të lidhur ushqimin elektrik nga rrjeti	48
9.2.2	Për të lidhur ushqimin elektrik të rezistencës përforcuese	49
9.2.3	Për të lidhur kartën e Wi-Fi (dërgohet si aksesori)	51
10	Konfigurimi	52
10.1	Përmbledhje: Konfigurimi	52
10.1.1	Hyrja në komandat për të përdorura	53
10.1.2	Për të lidhur kabllon e PC në kutinë shpërndarëse.....	55
10.2	Ndihmuesi i konfigurimit.....	56
10.3	Pamjet e mundshme të ekranit.....	57
10.3.1	Pamjet e mundshme të ekranit: Përmbledhje.....	57
10.3.2	Ekrani kryesor	57
10.3.3	Pamja e menysë kryesore.....	59
10.3.4	Pamja e ekranit të menysë	59
10.3.5	Pamja e ekranit të vlerës së caktuar.....	60
10.3.6	Pamja e detajuar e ekranit me vlerat	61
10.4	Vlerat e paracaktuara dhe programet	61
10.4.1	Përdorimi i vlerave të paracaktuara	61
10.4.2	Përdorimi dhe programimi i programeve	62
10.4.3	Ekrani i programit: Shembull ilustrues	64
10.5	Kurba në varësi të motit.....	68
10.5.1	Çfarë është kurba në varësi të motit?	68
10.5.2	Kurba me 2 pika	68
10.5.3	Kurba pjerrësi-kompensim	69
10.5.4	Përdorimi i kurbave në varësi të motit.....	70
10.6	Menyja e cilësimeve	71
10.6.1	Funksionimi me defekt	72
10.6.2	Depozita	72
10.6.3	Cilësimet për përdoruesin	81
10.6.4	Informacion	84
10.6.5	Cilësimet për instaluesin	86
10.6.6	Vënia në përdorim	92
10.6.7	Profili i përdoruesit	92
10.6.8	Funksionimi	93
10.6.9	Wi-Fi	93
10.7	Struktura e menysë: Përmbledhje e cilësimeve për përdoruesin	96
10.8	Struktura e menysë: Përmbledhje e cilësimeve për instaluesin	97
11	Vënia në punë	98
11.1	Pamja e përgjithshme: Autorizimi.....	98
11.2	Masat paraprake kur jep autorizim.....	98
11.3	Lista e plotë para komisionimit	99
11.4	Lista e plotë gjatë komisionimit	100
11.4.1	Prova e funksionimit të aktuatorit.....	100
11.4.2	Prova e funksionimit	100
12	Kthimi te përdoruesi	102
13	Mirëmbajtja dhe shërbimi	103
13.1	Masat paraprake të sigurisë së mirëmbajtjes.....	103
13.2	Mirëmbajtja vjetore	103
13.2.1	Mirëmbajtja vjetore e njësisë së brendshme: përmbledhje.....	103
13.2.2	Mirëmbajtja vjetore e njësisë së brendshme: udhëzimet	104
13.3	Për të zbratur depozitën e ujit të ngrohtë sanitar	105
14	Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve	106
14.1	Pamje e përgjithshme: Zgjidhja e problemeve	106
14.2	Masat paraprake kur zgjidhni problemet	106
14.3	Zgjidhja e problemeve bazuar në simptoma	107
14.3.1	Simtoma: Uji i ngrohtë NUK arrin temperaturën e dëshiruar	107
14.3.2	Simtoma: Presioni në pikën e marrjes së ujit është përkohësisht jashtëzakonisht i lartë.....	107
14.3.3	Simtoma: Funksioni i dezinfektimit të depozitës NUK përfundon si duhet (gabim AH)	107
14.4	Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimit.....	107
14.4.1	Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti.....	108
14.4.2	Kodet e gabimeve: Përmbledhje	108
15	Të dhënat teknike	112
15.1	Diagrami i tubacionit: Njësia e brendshme.....	113
15.2	Skema e qarkut: Njësia e brendshme	114

16 Fjalori	116
17 Tabela e cilësimeve të fushave	117

1 Rreth këtij dokumenti

Audienca e synuar

Instaluesit e autorizuar

Seti i dokumentacionit

Ky dokument është pjesë e setit të dokumentacionit. Seti i plotë përbëhet nga:

- **Masa sigurie të përgjithshme:**

- Instruksionet e sigurisë që duhet të lexoni përpara instalimit
- Format: printuar në letër (në kutinë e njësisë së brendshme)

- **Manuali i përdorimit:**

- Udhëzues i shpejtë për përdorimin bazë
- Format: printuar në letër (në kutinë e njësisë së brendshme)

- **Manuali referencë për përdoruesin:**

- Instruksione të detajuara hap pas hapi dhe informacione mbështetëse për përdorimin bazë dhe të avancuar
- Format: Skedarët digjitalë në <https://www.daikin.eu>. Përdorni funksionin e kërkimit Q për të gjetur modelin tuaj.

- **Manuali i montimit – Njësia e jashtme:**

- Instruksionet e montimit
- Format: printuar në letër (në kutinë e njësisë së jashtme)

- **Manuali i montimit – Njësia e brendshme:**

- Instruksionet e montimit
- Format: printuar në letër (në kutinë e njësisë së brendshme)

- **Manuali referencë për instaluesin:**

- Përgatitja për montimin, praktikat e mira, të dhënat referencë, ...
- Format: Skedarët digjitalë në <https://www.daikin.eu>. Përdorni funksionin e kërkimit Q për të gjetur modelin tuaj.

Rishikimi më i fundit i dokumentacionit të dhënë botohet në faqen rajonale Daikin të internetit dhe vihet në dispozicion përmes shitësit tuaj.

Udhëzimet origjinale janë të shkruara në anglisht. Të gjitha gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.

Të dhënat inxhinierike teknike

- Një **nëngrup** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në faqen rajonale të internetit Daikin (e aksesueshme nga publiku).
- **Grupi i plotë** i të dhënave më të fundit teknike disponohen në Daikin Business Portal (kërkohet vërtetimi).

Mjetet online

Përveç paketës së dokumentacionit, për instaluesit ofrohen edhe disa mjete online:

- **Heating Solutions Navigator**

- Kutitë mjete digjitale që ofron një shumëllojshmëri mjete për të lehtësuar montimin dhe konfigurimin e sistemeve të ngrohjes.
- Për të hyrë te Heating Solutions Navigator, kërkohet regjistrimi në platformën Stand By Me. Për më shumë informacion shihni faqen <https://professional.standbyme.daikin.eu>.

▪ Daikin e-Care

- Aplikacion për celular për instaluesit dhe teknikët e servisit që ju mundësojnë të regjistroni, të konfiguroni dhe të zgjidhni problemet në sistemet e ngrohjes.
- Përdorni kodet QR më poshtë për të shkarkuar aplikacionin celular për pajisjet me iOS dhe Android. Për të hyrë në aplikacion nevojitet regjistrimi në platformën Stand By Me.

App Store



Google Play



1.1 Kuptimi i alarmeve dhe simboleve



RREZIK

Tregon një situatë që rezulton në vdekje ose dëmtim të rëndë.



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

Tregon një situatë që mund të rezultojë në goditje elektrike.



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI

Tregon një situatë që mund të rezultojë në djegie/përvëlim për shkak të temperaturave ekstreme të ngrohta ose të ftohta.



RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI

Tregon një situatë, që mund të rezultojë në shpërthim.



PARALAJMËRIM

Tregon një situatë që mund të rezultojë në vdekje ose dëmtim të rëndë.



ALARM: MATERIAL I NDEZSHËM



KUJDES

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtim të lehtë ose të mesëm.



NJOFTIM

Tregon një situatë që mund të rezultojë në dëmtimin e pajisjeve ose të pronës.



INFORMACION

Tregon këshilla të dobishme ose informacion shtesë.

Simbolet e përdorura në njësi:

Simboli	Shpjegimi
	Para instalimit, lexoni manuali i instalimit dhe përdorimit dhe fletën e udhëzimit për lidhjet elektrike.

Simboli	Shpjegimi
	Para kryerjes së detyrave të mirëmbajtjes dhe shërbimit, lexoni manualin e shërbimit.
	Për më shumë informacion, shikoni instaluesin dhe udhëzuesin referencë të përdoruesit.
	Njësia përmban pjesë rrotulluese. Bëni kujdes kur i bëni njësisë servis ose inspektim.

Simbolet e përdorura në dokumentacion:

Simboli	Shpjegimi
	Tregon një titull figure ose një referencë për të. Shembull: "▲ 1–3 Titulli i figurës" do të thotë "Figura 3 në kapitullin 1".
	Tregon një titull tabele ose një referencë për të. Shembull: "■ 1–3 Titulli i tabelës" do të thotë "Tabela 3 në kapitullin 1".

1.2 Vështrim mbi udhërrëfyesin referencë të instaluesit

Kapitulli	Përshkrimi
Rreth dokumentacionit	Dokumentacioni që disponohet për instaluesin
Masa sigurie të përgjithshme	Instruksionet e sigurisë që duhet të lexoni përpara instalimit
Udhëzimet specifike të sigurisë për instaluesin	
Rreth kësaj kutie	Instruksionet si të trajtoni kutinë, si të nxirrni njësitet nga ambalazhi dhe si të hiqni aksesoret e tyre
Rreth njësive dhe opsioneve	▪ Instruksionet si të identifikoni njësinë ▪ Kombinimet e mundshme të njësive dhe opsionet
Udhëzimet e përdorimit	Konfigurimet e ndryshme të montimit të sistemit
Montimi i njësisë	Informacioni që duhet të dini dhe veprimet që duhet të bëni për montimin e sistemit, duke përfshirë edhe informacionet për përgatitjen e një montimi
Instalimi i tubacioneve	Informacioni që duhet të dini dhe veprimet që duhet të bëni për instalimin e tubave të sistemit, duke përfshirë edhe informacionet për përgatitjen e një instalimi
Instalimi elektrik	Informacioni që duhet të dini dhe veprimet që duhet të bëni për instalimin e komponentëve elektrikë të sistemit, duke përfshirë edhe informacionet për përgatitjen e një instalimi

Kapitulli	Përshkrimi
Përfundimi i montimit të njësive së jashtme	Instruksonet se çfarë duhet bërë pas montimit të njësive, instalimit të tubacioneve dhe pas instalimit elektrik
Konfigurimi	Informacioni që duhet të dini dhe veprimet që duhet të bëni për të konfiguruar sistemin pasi ai të montohet
Vënia në përdorim	Informacioni që duhet të dini dhe veprimet që duhet të bëni për vënien në përdorim të sistemit pasi ai të konfigurohet
Dorëzimi te përdoruesi	Çfarë duhet t'i jepni dhe t'i shpjegoni përdoruesit
Mirëmbajtja dhe shërbimi	Instruksonet për mirëmbajtjen dhe shërbimin e njësive
Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve	Instruksonet si të veproni në rast problemesh
Hedhja	Instruksonet sesi duhet asgjësuar sistemi
Të dhënat teknike	Specifikimet teknike të sistemit
Fjalori	Përkufizimi i termave
Tabela e cilësimeve të fushave	Tabela që duhet plotësuar nga instaluesi dhe që ruhet për referencë në të ardhmen Shënim: Në udhëzuesin referencë për përdoruesin ka gjithashtu një tabelë të cilësimeve për instaluesin. Kjo tabelë duhet plotësuar nga instaluesi dhe i dorëzohet përdoruesit.

2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme

Në këtë kapitull

2.1	Për instaluesin.....	9
2.1.1	Këshilla të përgjithshme.....	9
2.1.2	Vendi i instalimit.....	10
2.1.3	Gaz ftohës - në rastin e R410A ose R32.....	10
2.1.4	Uji	12
2.1.5	Elektriket	12

2.1 Për instaluesin

2.1.1 Këshilla të përgjithshme

Nëse NUK jeni i sigurt si ta instaloni apo operoni njësinë, kontaktoni distributorin tuaj.



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI

- MOS e prekni tubacionin e ftohësit, tubacionin e ujit apo pjesët e brendshme gjatë dhe menjëherë pas operimit. Mund të jetë shumë i nxehtë ose shumë i ftohtë. Prisni pak kohë sa të kthehet në temperaturën e zakonshme. Nëse DUHET ta prekni, mbani doreza mbrojtëse.
- MOS prekni ftohës me rrjedhje aksidentale.



PARALAJMËRIM

Instalimi i papërshtatshëm ose lidhja e pajisjeve apo aksesorëve mund të çojë në goditje elektrike, qark të shkurtër, rrjedhje, zjarr ose dëmtime të tjera ndaj pajisjes. Përdorni VETËM aksesorë, pajisje opsionale dhe pjesë këmbimi prodhuar ose miratuar nga Daikin përveç nëse specifikohet ndryshe.



PARALAJMËRIM

Sigurohu që instalimi, testimi dhe materialet e përdorura përputhen me legjislacionin në fuqi (në krye të udhëzimeve të përshkruara në dokumentacionin Daikin).



PARALAJMËRIM

Shqyeni dhe hidhni qeset plastike të paketimit në mënyrë që asnjëri, veçanërisht fëmijët, të mos luajnë me to. **Pasoja e mundshme:** mbytje.



PARALAJMËRIM

Merr masa të përshtatshme për të parandaluar që njësia të përdoret si strehë nga kafshë të vogla. Kafshët e vogla që bien në kontakt me pjesët elektrike mund të shkaktojnë ndërprerjen e funksionit, tym ose zjarr.



KUJDES

Mbaj veshur pajisje të përshtatshme mbrojtëse personale (doreza mbrojtëse, syze sigurie,...) kur kryen instalimin, mirëmbajtjen ose servisin e sistemit.



KUJDES

MOS e prek grykën hyrëse të ajrit ose fletët alumini të njësisë.



KUJDES

- MOS vendosni sende ose pajisje mbi njësinë.
- MOS u ulni, mos hipni ose mos qëndroni mbi njësinë.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të kërkohet sigurimi i një regjistri bashkë me produktin që përmban të paktën: informacione për mirëmbajtjen, punë riparimi, rezultate testimesh, periudha gatishmërie,...

Të paktën gjithashtu edhe informacioni vijues DUHET të ofrohet në një vend të aksesueshëm te produkti:

- Udhëzime për fikjen e sistemit në rast urgjence
- Emri dhe adresa e zjarfikësit, policisë dhe spitalit
- Emri, adresa dhe numrat e telefonit për ditën e natën për përdorimin e shërbimeve

Në Evropë, EN378 ofron udhëzimet e nevojshme për këtë regjistrë.

2.1.2 Vendi i instalimit

- Siguro hapësirë të mjaftueshme rreth njësisë për kryerjen e servisit dhe qarkullimit të ajrit.
- Sigurohuni që vendi i instalimit e përballon peshën dhe dridhjen e njësisë.
- Sigurohu që zona të jetë e ajruar mirë. MOS blloko vrimat e ajrit.
- Sigurohu që njësia është e niveluar.

MOS e instalo njësinë në vendet e mëposhtme:

- Në ambiente me mundësi shpërthimi.
- Në vende ku ka makineri, që lëshojnë valë elektromagnetike. Valët elektromagnetike mund të trazojnë sistemin e kontrollit dhe shkaktojnë ndërprerje të funksionit të pajisjes.
- Në vende ku ka rrezik zjarri për shkak të rrjedhjes së gazrave të djegshëm (shembull: holluesi ose benzina), fibrave të karbonit, pluhurit të ndezshëm.
- Në vende ku nxirret gaz gërryes (shembull: gazi acido sulfurik). Gërryerja e tubave të bakrit ose pjesëve të ngjitura mund të shkaktojë rrjedhjen e ftohësit.

2.1.3 Gaz ftohës - në rastin e R410A ose R32

Nëse zbatohet. Shihni manualin e instalimit ose udhëzuesin e referencës së instaluesit të aplikacionit tuaj për më shumë informacion.



RREZIK: RREZIK SHPËRTHIMI

Mbyllja e valvulit – Rrjedhje e ftohësit. Nëse do të mbyllësh valvulin e sistemit dhe në qarkun e ftohësit ka rrjedhje:

- MOS përdorni funksionin e mbylljes automatike të valvulit të njësisë, me të cilin ju mund të grumbulloni të gjithë ftohësin nga sistemi në njësinë e jashtme. **Pasoja e mundshme:** Vetë-djedia dhe shpërthimi i kompresorit për shkak të ajrit që hyn në kompresorin operues.
- Përdor një sistem të ndarë rikuperimi në mënyrë që kompresori i njësisë të MOS operojë.



PARALAJMËRIM

Gjatë testimeve, KURRË mos ushtro presion më të lartë se maksimumi i lejuar mbi produktin (siç tregohet në pllakën e markës së njësisë).

**PARALAJMËRIM**

Merr masa të mjaftueshme paraprake në rast të një rrjedhjeje të ftohësit. Nëse rrjedh gazi i ftohësit, ajros menjëherë ambientin. Rreziqet e mundshme:

- Përqendrimet e tepërta të ftohësit në një dhomë të mbyllur mund të çojnë në mungesë oksigjeni.
- Nëse gazi i ftohësit bie në kontakt me zjarrin, mund të prodhohet gaz toksik.

**PARALAJMËRIM**

GJITHMONË kthejeni ftohësin në gjendje normale. MOS i lëshoni ato direkt në mjedis. Përdorni një pompë vakumi për të hequr instalimin.

**PARALAJMËRIM**

Kontrolloni që në sistem nuk ka oksigjen. Ftohësi mund të ngarkohet VETËM pas kryerjes së testimit të rrjedhjes dhe tharjes me vakum.

Pasoja e mundshme: Vetë-djegje dhe shpërthim i kompresorit për shkak se oksigjeni depërton në kompresorin e operimit.

**NJOFTIM**

- Për të shmangur avarinë e kompresorit, MOS e ngarkoni më shumë se sasinë e specifikuar të ftohësit.
- Kur hapet sistemi i ftohësit, ai DUHET të menaxhohet në përputhje me legjislacionin në zbatim.

**NJOFTIM**

Sigurohu që instalimi i tubacionit të ftohësit përputhet me legjislacionin në fuqi. Në Evropë, EN378 është standardi që zbatohet.

**NJOFTIM**

Sigurohuni që tubacioni në ambient të hapur dhe lidhjet të MOS i nënshtrohen tensionit.

**NJOFTIM**

Pas lidhjes të të gjithë tubacionit, sigurohu që nuk ka rrjedhje gazi. Përdor nitrogjen për të kapur rrjedhjen e gazit.

- Në rast se duhet një ringarkim, referoju pllakës të njësisë ose etiketës së ngarkimit të ftohësit të njësisë. Ajo konstaton llojin e ftohësit dhe sasinë e nevojshme.
- Qoftë kur njësia është e ngarkuar me ftohës ose jo që nga dalja nga fabrika, në të dy rastet mund t'ju duhet të ngarkoni ftohës shtesë, në varësi të madhësive dhe gjatësive të tubave të sistemit.
- Përdor vegla ekskluzive VETËM për llojin e ftohësit të përdorur në sistem, për të siguruar rezistencën e presionit dhe për të parandaluar hyrjen e materialeve të huaja brenda në sistem.
- Ngarko ftohësin e lëngshëm si në vazhdim:

Nëse	Atëherë
Ka prani të një tub sifoni (d.m.th. cilindri është i shënuar "Ngjitur gjendet sifoni që mbushet me lëng")	Ngarko me cilindrin në pozicion vertikal. 
Nuk ka prani të tubit të sifonit	Ngarko me cilindrin përmbys. 

- Hapi cilindrin e ftohësit ngadalë.
- Ngarko ftohësin në formë të lëngshme. Shtimi tij në formë të gaztë mund të parandalojë përdorimin normal.



KUJDES

Kur kryhet procedura e ngarkimit të ftohësit ose kur ndërpritet, mbyllni menjëherë valvulin e enës së ftohësit. Nëse valvuli NUK mbyllet menjëherë, presioni i mbetur mund të ngarkojë ftohës shtesë. **Pasoja e mundshme:** Sasi e pasaktë e ftohësit.

2.1.4 Uji

Nëse aplikohet. Për më shumë informacion shiko manualin e instalimit ose udhëzuesin e referimit për instaluesin lidhur me përdorimin tënd.



NJOFTIM

Sigurohuni që cilësia e ujit të përshtatet me direktivën e BE-së 2020/2184.

2.1.5 Elektri



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

- FIKNI të gjithë furnizimin me energji elektrike para se të heqësh kapakun e kutisë së çelësit, duke lidhur instalimet elektrike ose duke prekur pjesët elektrike.
- Shkëputni furnizimin me energji elektrike për më shumë se 10 minuta dhe matni voltazhin te terminalet e kondensatorëve të qarkut kryesor ose përbërësve elektrikë para shërbimit. Voltazhi DUHET të jetë më i vogël se 50 V DC para se të prekni përbërësit elektrikë. Për vendndodhjen e terminaleve, shikoni skemën e instalimeve elektrike.
- MOS i prek përbërësit elektrikë me duar të lagura.
- MOS e lër njësinë të pambikëqyrur kur hiqet kapaku i servisit.



PARALAJMËRIM

Nëse NUK instalohet që në fabrikë, një çelës kryesor ose mjete të tjera për shkëputje, duke pasur një ndarje kontakti në të gjitha shtyllat që ofrojnë shkëputje të plotë në gjendjen e kategorisë III të mbitensionit, DUHEN instaluar tek instalimet elektrike.



PARALAJMËRIM

- Përdorni VETËM tela bakri.
- Sigurohuni që instalimet elektrike në terren të përputhen me rregulloret kombëtare të instalimeve.
- Të gjitha instalimet elektrike në terren DUHET të kryhen në përputhje me diagramin e instalimeve elektrike të furnizuar me produktin.
- KURRË MOS i ngjishni kabllo të paketuara dhe sigurohuni që TË MOS bien në kontakt me tubacionet dhe skajet e mprehta. Sigurohuni që asnjë presion i jashtëm të mos ushtrohet në lidhjet e kontakteve.
- Sigurohuni që të instaloni linjën e tokëzimit. MOS e tokëzoni njësinë në tuba shërbimi, absorbues mbitensioni apo tokëzime telefonike. Tokëzimi i paplotë ose i gabuar mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Sigurohuni të përdorni qark të dedikuar elektrik. Mos përdorni ushqim elektrik të ndarë me pajisje tjetër.
- Sigurohuni të instaloni siguresat ose automatët e kërkuar.
- Sigurohuni të instaloni automat mbrojtës me shkarkim tokëzimi. Përndryshe mund të ndodhin goditje elektrike ose zjarr.
- Kur instaloni automat mbrojtës me shkarkim tokëzimi, sigurohuni që të pajtohet me inverterin (rezistent ndaj zhurmës elektrike me frekuencë të lartë) për të shmangur hapjen e panevojshme të automatit mbrojtës me shkarkim tokëzimi.



PARALAJMËRIM

- Pas përfundimit të instalimeve elektrike, konfirmoni që secili komponent elektrik dhe terminal brenda kutisë së ndërrimit është i lidhur në mënyrë të sigurt.
- Sigurohu që të gjithë kapakët të jenë të mbyllur para se të ndezësh njësinë.



KUJDES

- Kur lidhni energjinë: së pari bëni lidhjen e kabllot të tokëzimit para se të kryeni lidhjet që mbartin rrymën.
- Kur ndërpritni furnizimin me energji: së pari bëni ndërprerjen e kabllot që mbartin rrymën para se të kryeni ndarjen e lidhjes së tokëzimit.
- Gjatësia e përcjellësve mes çlirimit të presionit të energjisë dhe vetë bllokut të terminalit DUHET të jetë e atillë që telat që mbartin rrymë janë të tendosur para telit të tokëzimit në rast se korrenti lirohet nga çlirimi i presionit.



NJOFTIM

Masat paraprake kur kryeni instalimet elektrike:



- MOS i lidhni instalimet me trashësi të ndryshme me bllokun e terminalit të energjisë (xhokoja në instalime mund të shkaktojë nxehtësi anormale).
- Kur lidhni instalimet elektrike që kanë të njëjtën trashësi, veproni siç tregohet në figurën e mësipërme.
- Për instalimet, përdorni telin e përcaktuar të korrentit dhe lidhni fort, pastaj siguroni për të parandaluar ushtrimin e presionit në bordin e terminalit.
- Përdorni një kaçavidë të përshtatshme për shtrëngimin e vidhave terminale. Një kaçavidë me kokë të vogël e dëmton kokën dhe e bën shtrëngimin të pamundur.
- Shtrëngimi më tepër se duhet i vidhave terminale mund t'i thyejë ato.

Instaloni kabllot energjie të paktën 1 metër larg televizorëve ose radiove për të penguar interferencën. Në varësi të valëve të radios, distanca prej 1 metri mund të MOS jetë e mjaftueshme.



NJOFTIM

Zbatohet VETËM nëse furnizimi me energji elektrike është me tre faza, dhe kompresori ka një metodë fillimi me NDEZJE/FIKJE.

Nëse ekziston mundësia e fazës së kthimit pas një bllokimi momental dhe energjia NDIZET dhe FIKET kur produkti është në përdorim, ngjitet lokalisht një qark mbrojtës të fazës së kthimit. Vënia në punë e produktit në fazën e kthimit mund të thyjë kompresorin dhe pjesë të tjera.

3 Udhëzimet specifike për sigurinë e instaluesit

Zbatoni gjithmonë udhëzimet për sigurinë dhe rregullat vijuese.

Vendi i montimit (shihni "7.1 Përgatitja e vendit të instalimit" [▶ 28])



PARALAJMËRIM

Zbatoni dimensionet e hapësirës së shërbimit në këtë manual për instalimin e saktë të njësies. Shihni "7.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e brendshme" [▶ 28].



PARALAJMËRIM

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).



PARALAJMËRIM

MOS përdorni përsëri tubacionin e gazit ftohës që është përdorur me një tjetër gaz ftohës. Ndërroni tubat e gazit ftohës ose pastrojini ato shumë mirë.



PARALAJMËRIM

Pajisja është IPX3. Kur montoni këtë produkt në një banjë, ndiqni legjislacionin e zbatueshëm për montimin në vende të tilla.

Kërkesat e veçanta për gazin R32 (shihni "7.1.2 Kërkesat e veçanta për njësitet R32" [▶ 29])



PARALAJMËRIM

- MOS shponi ose mos digjni pjesët e ciklit të gazit ftohës.
- MOS përdorni mjete për të përshpejtuar procesin e shkrirjes ose për të pastruar pajisjen, të ndryshme nga ato të rekomanduara nga prodhuesi.
- Jini të vetëdijshëm se gazi ftohës R32 NUK ka aromë.



PARALAJMËRIM

Pajisja duhet të ruhet për të parandaluar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa burime ndezjeje që janë vazhdimisht në gjendje pune (p.sh. flakë të hapura, pajisje gazi në gjendje pune ose një ngrohës elektrik po në gjendje pune).



PARALAJMËRIM

Sigurohu që instalimi, servisi, mirëmbajtja dhe riparimi janë në përputhje me udhëzimet nga Daikin dhe me legjislacionin në fuqi (për shembull me rregullat kombëtare të përdorimit të gazit) dhe ekzekutohen VETËM nga persona të autorizuar.



PARALAJMËRIM

Për njësitet që përdorin gaz ftohës R32, është e nevojshme t'i mbani të gjitha foletë e nevojshme të ventilimit pa pengesa.

Hapja dhe mbyllja e njësive (shihni "7.2 Hapja dhe mbyllja e njësive" [▶ 36])



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

MOS e lini njësinë të pambikëqyrur kur hiqet kapaku i servisit.



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI

Montimi i njësive të brendshme (shihni "7.3 Montimi i njësive të brendshme" [▶ 37])



PARALAJMËRIM

Mënyra e fiksimit të njësive të brendshme DUHET të jetë në përputhje me udhëzimet nga ky manual. Shikoni "7.3 Montimi i njësive të brendshme" [▶ 37].

Instalimi i tubacioneve (shihni "8 Instalimi i tubacionit" [▶ 39])



PARALAJMËRIM

Tubacionet në terren DUHET të jenë në përputhje me udhëzimet nga ky manual. Shihni "8 Instalimi i tubacionit" [▶ 39].



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI



PARALAJMËRIM

- Përdorni vetëm R32 si ftohës. Substancat e tjera mund të shkaktojnë shpërthime dhe aksidente.
- R32 përmban gazra serë të fluorinuara. Vlera e tyre për ndikuar te ngrohja globale (GWP) është 675. MOS i lëshoni këto gazra në atmosferë.
- Kur ngarkoni ftohësin, përdorni GJITHMONË doreza dhe syze mbrojtëse.



KUJDES

- Kur për brenda ripërdoren lidhës **mekanikë**, vini pjesë të reja izolimi.
- Kur për brenda ripërdoren **dado ngjeshëse**, bëjeni nga e para pjesën e ngjeshur.



PARALAJMËRIM

MOS montoni asnjë valvulë midis depozitës së ujit të ngrohtë sanitar dhe valvulës së çlirimit të presionit.



PARALAJMËRIM

Instaloni kovën ndërmjetëse larg çdo pajisje elektrike. **Pasoja e mundshme:** Goditje elektrike ose zjarr.

Instalimi elektrik (shihni "9 Instalimi elektrik" [▶ 45])



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE

**PARALAJMËRIM**

Lidhja elektrike DUHET të jetë në përputhje me udhëzimet nga:

- Ky manual. Shihni "9 Instalimi elektrik" [▶ 45].
- Skemën e qarkut që ofrohet me njësinë, që ndodhet në brendësi të kapakut të kutisë shpërndarëse të njësisë së brendshme. Për përkthimin e legjendës, shihni "15.2 Skema e qarkut: Njësia e brendshme" [▶ 114].

**PARALAJMËRIM**

- Të gjitha instalimet elektrike DUHEN kryer nga një elektrikist i autorizuar dhe DUHET të pajtohen me rregulloren kombëtare të instalimeve elektrike.
- Kryeni lidhjet elektrike tek instalimet e montuara.
- Të gjithë komponentët e prokuruar në vend dhe të gjitha punimet elektrike DUHET të përputhen me legjislacionin në fuqi.

**PARALAJMËRIM**

- Nëse ushqimit elektrik i mungon ndonjë fazë ose ka fazë të gabuar N, pajisjet mund të prishen.
- Vendosni tokëzimin e duhur. MOS e tokëzoni njësinë në tuba shërbimi, absorbues mbtensiononi apo tokëzime telefonike. Tokëzimi i paplotë ose i gabuar mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Instaloni siguresat ose automatët e kërkuar.
- Siguroni instalimet elektrike me lidhje kablore në mënyrë që kabllot TË MOS bien në kontakt me skajet e mprehta ose tubacionet, veçanërisht në anën e presionit të lartë.
- MOS përdorni tela me ngjitje, kordona zgjatues apo lidhje me sistem në formë ylli. Ato mund të shkaktojnë mbinxehje, goditje elektrike ose zjarr.
- MOS instaloni kondensator avancimi faze, pasi kjo njësi është e pajisur me inverter. Kondensatori i avancimit të fazës zvogëlon performancën dhe mund të shkaktojë aksidente.

**PARALAJMËRIM**

Nëse kordoni i korrentit është i dëmtuar, DUHET të ndërrohet nga prodhuesi, agjenti i shërbimit ose persona të ngjashëm të kualifikuar për të shmangur një rrezik.

**PARALAJMËRIM**

GJITHMONË përdor kablo me shumë bërthama për kabllot e furnizimit me energji elektrike.

**KUJDES**

MOS e shtyni apo mos e vini kabllon e mbetur në njësi.

**PARALAJMËRIM**

Rezistenca përforcuese DUHET të ketë një linjë të veçantë ushqimi elektrik dhe DUHET të mbrohet nga pajisjet e sigurisë që kërkohen nga legjislacioni i zbatueshëm.

**KUJDES**

Për të garantuar që njësia të jetë plotësisht e tokëzuar, lidhni GJITHMONË ushqimin elektrik të rezistencës përforcuese dhe kabllon e tokëzimit.



INFORMACION

Për detaje mbi normat e siguresave, llojet e siguresave dhe normat e automatëve, shihni "9 Instalimi elektrik" [▶ 45].

Konfigurimi (shihni "10 Konfigurimi" [▶ 52])



KUJDES

Cilësimet e funksionit të dezinfektimit DUHEN konfiguruar nga instaluesi në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.



PARALAJMËRIM

Mbani parasysh se temperatura e ujit të ngrohtë sanitar në rubinetin e ujit të ngrohtë do të jetë e barabartë me vlerën e zgjedhur në cilësimin e fushës [2-03] pas një operacioni dezinfektimi.

Kur temperatura e lartë e ujit të ngrohtë sanitar mund të jetë një rrezik i mundshëm për lëndim të personave, një valvul përzierjeje (sigurohet në terren) duhet instaluar në lidhjen e daljes së ujit të ngrohtë në depozitën e ujit të ngrohtë sanitar. Kjo valvul përzierjeje do të sigurojë që temperatura e ujit të ngrohtë në rubinetin e ujit të ngrohtë të rritet kurrë mbi një vlerë maksimale të caktuar. Kjo temperaturë maksimale e lejuar e ujit të ngrohtë duhet zgjedhur në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.



KUJDES

Sigurohni që koha e fillimit të funksionit të dezinfektimit [5.7.3] me kohëzgjatje të përcaktuar [5.7.5] të MOS ndërpritet nga kërkesa e mundshme për ujë të ngrohtë sanitar.

Vënia në përdorim (shihni "11 Vënia në punë" [▶ 98])



PARALAJMËRIM

Vënia në përdorim DUHET të jetë në përputhje me udhëzimet nga ky manual. Shihni "11 Vënia në punë" [▶ 98].

Mirëmbajtja dhe shërbimi (shihni "13 Mirëmbajtja dhe shërbimi" [▶ 103])



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI



KUJDES

Uji që del nga jashtë nga valvula mund të jetë shumë i nxehtë.



PARALAJMËRIM

Nëse instalimi i brendshëm elektrik është dëmtuar, ai duhet zëvendësuar nga prodhuesi, agjenti i tij i shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI

Uji brenda në depozitë mund të jetë shumë i nxehtë.

Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve (shihni "14 Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve" [▶ 106])



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI



PARALAJMËRIM

- Kur kryeni një inspektim të kutisë së çelësit të njësisë, GJITHMONË sigurohuni që njësia është e shkëputur nga tubat kryesorë. Fikni çelësin përkatës.
- Kur aktivizohet një pajisje sigurie, ndalni njësinë dhe gjeni pse pajisja e sigurisë u aktivizua para rivendosjes. KURRË mos spostoni pajisjet e sigurisë apo të ndryshoni vlerat e tyre me një vlerë ndryshe nga ajo e cilësimit të parazgjedhjes nga fabrika. Nëse nuk arrini të gjeni shkakun e problemit, telefononi distributorin tuaj.



PARALAJMËRIM

Parandaloni rreziqet të shkaktuara nga rivendosja e shkujdesur e çelësit automatik termal: kjo aparaturë NUK DUHET të sigurohet përmes një pajisjeje të jashtme suiçing, siç është kohëmatësi, ose e lidhur me një qark që rregullisht NDIZET dhe FIKET nga shërbimi.



PARALAJMËRIM

Në rastin e kodit të gabimit F3-00, ekziston rreziku i mundshëm për rrjedhje të gazit ftohës. Kontaktoni me instaluesin.


4 Rreth kutisë

Mbani këto parasysht:

- Njësia DUHET të kontrollohet për dëmtime dhe plotësi gjatë dorëzimit. Çdo dëmtim ose pjesë që mungon DUHET t'i raportohet menjëherë agjentit të ankesave të operatorit.
- Sill njësine e paketuar sa më afër të jetë e mundur te pozicioni final i instalimit për të parandaluar dëmtimin gjatë transportimit.
- Përgatitni paraprakisht rrugën gjatë të cilës dëshironi të sillni njësine në pozicionin e saj përfundimtar të instalimit.


4.1 Njësia e brendshme

4.1.1 Heqja nga paketimi i njësisë së brendshme



4.1.2 Heqja e aksesorëve nga njësia e brendshme

Disa aksesore ndodhen brenda njësisë. Për më shumë informacion mbi hapjen e njësisë, shihni "[7.2.2 Për të hapur njësine e brendshme](#)" [▶ 36].



a Karta e Wi-Fi

- b** Masa sigurie të përgjithshme
- c** Manuali i përdorimit
- d** Manuali i montimit të njësisë së brendshme

5 Rreth njësive dhe opsioneve


Në këtë kapitull

5.1	Identifikimi	22
5.1.1	Etiketa e identifikimit: Njësia e brendshme	22
5.2	Opsionet e mundshme për njësinë e brendshme	22

5.1 Identifikimi

5.1.1 Etiketa e identifikimit: Njësia e brendshme

Vendndodhja



Identifikimi i modelit

Shembull: EK HW E T 120 BA V3

Kodi	Përshkrimi
EK	Komplet për Evropë – i markës Daikin
HW	Uji i ngrohtë për LT
E	Emalim
T	Montuar në mur
120	Vëllimi në litra
BA	Seria e modelit
V3	1~ / 230 V / 50 Hz

5.2 Opsionet e mundshme për njësinë e brendshme

Kabloja e PC (EKPCCAB4)

Kabloja e PC realizon lidhjen midis kutisë shpërndarëse të njësive të brendshme dhe një kompjuteri. Ajo krijon mundësinë e përditësimit të softuerit të njësive të brendshme.

Për udhëzimet e instalimit, shihni:

- manualin e instalimit të kabllot së PC
- "10.1.2 Për të lidhur kabllon e PC në kutinë shpërndarëse" [▶ 55]

6 Udhëzimet e përdorimit

Në këtë kapitull

6.1	Përmbledhje: Udhëzimet e përdorimit	23
6.2	Konfigurimi i depozitës së ujit të ngrohtë sanitar	23
6.2.1	Ndërtimi i sistemit – Depozita e pavarur e ujit të ngrohtë sanitar	23
6.2.2	Zgjedhja e vëllimit dhe temperaturës së dëshiruar për depozitën e ujit të ngrohtë sanitar	23
6.2.3	Parametrizimi dhe konfigurimi – Depozita e ujit të ngrohtë sanitar	25
6.3	Konfigurimi i kontrollit të konsumit të energjisë	25
6.3.1	Kufizimi i përhershëm i fuqisë	26
6.3.2	Procesi i kufizimit të fuqisë	26

6.1 Përmbledhje: Udhëzimet e përdorimit

Qëllimi i udhëzimeve të përdorimit është të japë një tablo të shpejtë të mundësive të sistemit me pompë nxehtësie.



NJOFTIM


- Ilustrimet në udhëzimet e përdorimit janë menduar vetëm si referencë dhe ato NUK duhen përdorur si skema hidraulike të detajuara. Përmasat e detajuara hidraulike dhe balancimi NUK tregohen, sepse këto janë përgjegjësi e instaluesit.
- Për më shumë informacion rreth cilësimeve të konfigurimit për optimizimin e punës së pompës së nxehtësisë, shihni "10 Konfigurimi" [▶ 52].

Ky kapitull përmban udhëzimet e përdorimit për sa më poshtë:

- Konfigurimi i depozitës së ujit të ngrohtë sanitar
- Konfigurimi i kontrollit të konsumit të energjisë

6.2 Konfigurimi i depozitës së ujit të ngrohtë sanitar

6.2.1 Ndërtimi i sistemit – Depozita e pavarur e ujit të ngrohtë sanitar



- A** Depozita e ujit të ngrohtë sanitar
a Hyrja e ujit të ftohtë
b Dalja e ujit të ngrohtë

6.2.2 Zgjedhja e vëllimit dhe temperaturës së dëshiruar për depozitën e ujit të ngrohtë sanitar

Njerëzit e perceptojnë ujin si të nxehtë kur temperatura e tij është 40°C. Për këtë arsye, konsumi i ujit të ngrohtë sanitar (DHW) shprehet gjithmonë si vëllimi ekuivalent i ujit të nxehtë në 40°C. Megjithatë, ju mund ta vendosni temperaturën e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar në një temperaturë më të lartë (për shembull: 53°C), e cila më pas përzihet me ujin e ftohtë (për shembull: 15°C).

Zgjedhja e vëllimit dhe temperaturës së dëshiruar për depozitën e ujit të ngrohtë sanitar përbëhet nga:

- 1 Përcaktimi i konsumit të ujit të ngrohtë sanitar (vëllimi ekuivalent i ujit të nxehtë në 40°C).
- 2 Përcaktimi i vëllimit dhe temperaturës së dëshiruar për depozitën e ujit të ngrohtë sanitar.

Përcaktimi i konsumit të ujit të ngrohtë sanitar

Përgjigjuni pyetjeve më poshtë dhe llogaritni konsumin e ujit të ngrohtë sanitar (vëllimi ekuivalent i ujit të nxehtë në 40°C) duke përdorur vëllimet tipike të ujit:

Pyetja	Vëllimi tipik i ujit
Sa larje në dush nevojiten në ditë?	1 dush = 10 min×10 l/min = 100 l
Sa larje në vaskë nevojiten në ditë?	1 vaskë = 150 l
Sa ujë nevojitet në lavamanin e kuzhinës në ditë?	1 lavaman = 2 min×5 l/min = 10 l
A ka nevoja të tjera për ujë të ngrohtë sanitar?	—

Shembull: Nëse konsumi i ujit të ngrohtë sanitar i një familjeje (4 persona) në ditë është si më poshtë:

- 3 dushe
- 1 vaskë
- 3 vëllime lavamani

Atëherë konsumi i ujit të ngrohtë = (3×100 l)+(1×150 l)+(3×10 l)=480 l

Përcaktimi i vëllimit dhe temperaturës së dëshiruar për depozitën e ujit të ngrohtë sanitar

Formula	Shembull
$V_1 = V_2 \times (T_2 - T_1) / (40 - T_1)$	Nëse: ▪ $V_2 = 120$ l ▪ $T_2 = 54^\circ\text{C}$ ▪ $T_1 = 15^\circ\text{C}$ Atëherë $V_1 = 187$ l
$V_2 = V_1 \times (40 - T_1) / (T_2 - T_1)$	Nëse: ▪ $V_1 = 480$ l ▪ $T_2 = 54^\circ\text{C}$ ▪ $T_1 = 15^\circ\text{C}$ Atëherë $V_2 = 307$ l

- V_1 Konsumi i ujit të ngrohtë sanitar (vëllimi ekuivalent i ujit të nxehtë në 40°C)
 V_2 Vëllimi i kërkuar i depozitës së ujit të ngrohtë sanitar nëse nxehtet vetëm një herë
 T_2 Temperatura e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar
 T_1 Temperatura e ujit të ftohtë

Vëllimet e mundshme të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar

Lloji	Vëllimet e mundshme
Depozita e pavarur e ujit të ngrohtë sanitar	▪ 90 l ▪ 120 l

Këshilla për kursimin e energjisë

- Nëse konsumi i ujit të ngrohtë sanitar ndryshon nga dita në ditë, ju mund të programoni një program javor me temperaturat e ndryshme të dëshiruara të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar për çdo ditë.
- Sa më e ulët të jetë temperatura e dëshiruar e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar, aq më kosto-efektive është ajo. Duke zgjedhur një depozitë më të madhe të ujit të ngrohtë sanitar, ju mund të ulni temperaturën e dëshiruar të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar.
- Vetë pompa e nxehtësisë mund të prodhojë ujë të ngrohtë sanitar me temperaturë maksimumi 53°C (ose më të ulët, në varësi të temperaturës së jashtme). Rezistenca elektrike e integruar në depozitë mund ta rritë këtë temperaturë. Megjithatë, kjo konsumon më shumë energji. Ne rekomandojmë që ta vendosni nën 53°C temperaturën e dëshiruar të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar, për të minimizuar përdorimin e rezistencës elektrike.
- Në rastin kur në njësinë e jashtme lidhen disa njësi të brendshme: kur pompa e nxehtësisë prodhon ujë të ngrohtë sanitar (DHW), në varësi të kërkesës totale për ajrin e kondicionuar (A/C) dhe cilësimin e programuar të prioritetit, ajo mund të mos jetë në gjendje që të ofrojë njëkohësisht edhe ujin e ngrohtë, edhe ajrin e kondicionuar. Nëse ju nevojitet njëkohësisht uji i ngrohtë dhe ajri i kondicionuar, ne rekomandojmë që ta prodhoni ujin e ngrohtë sanitar gjatë natës kur kërkesa për ajër të kondicionuar është më e ulët, ose gjatë kohës kur nuk ka njeri në shtëpi.

6.2.3 Parametrizimi dhe konfigurimi – Depozita e ujit të ngrohtë sanitar

- Për konsume të mëdha të ujit të ngrohtë sanitar, ju mund ta ngrohni depozitën e ujit të ngrohtë disa herë gjatë ditës.
- Për ta ngrohur depozitën e ujit të ngrohtë sanitar në temperaturën e dëshiruar të saj, ju mund të përdorni burimet e energjisë në vijim:
 - Ciklin termodinamik të pompës së nxehtësisë
 - Rezistencën përforcuese elektrike
- Për më shumë informacion rreth:
 - Optimizimit të konsumit të energjisë për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar, shihni "[10 Konfigurimi](#)" [▶ 52].
 - Lidhjes së tubave të ujit të depozitës së pavarur të ujit të ngrohtë sanitar në njësinë e brendshme, shihni manualin e montimit të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar.

6.3 Konfigurimi i kontrollit të konsumit të energjisë

Ju mund të përdorni kontrollat e mëposhtme të konsumit të energjisë. Për më shumë informacion rreth cilësimeve përkatëse, shihni "[Kontrolli i konsumit të energjisë](#)" [▶ 89].

#	Kontrolli i konsumit të energjisë
1	"6.3.1 Kufizimi i përhershëm i fuqisë" [▶ 26] ▪ Ju lejon të kufizoni konsumin e energjisë së të gjithë sistemit të pompës së nxehtësisë (shuma e njësisë së jashtme, njësisë së brendshme dhe rezistencës përforcuese) me një cilësim të përhershëm. ▪ Kufizimi i fuqisë bëhet në kW ose i rrymës në A.

**NJOFTIM**

Caktoni një fuqi minimale prej 3 kW, për të garantuar:

- Funksionimin e shkëmbjes. Përndryshe, nëse shkëmbja ndërpritet disa herë, shkëmbyesi i nxehtësisë do të ngrijë.
- Prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar duke lejuar rezistencën përforcuese.

**NJOFTIM**


- Nëse kontrolli i konsumit të energjisë ndizet dhe aktivizohet ndërkohë që njësia e jashtme është duke punuar në funksionin e ajrit të kondicionuar, ndezja e rezistencës përforcuese mund të ndalohej. Në këtë rast, për të garantuar prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar, rekomandohet që ta vendosni programin e prioritetit tek uji i ngrohtë sanitar (shihni "[Programet e mundshme](#)" [▶ 63]) dhe të minimizoni përdorimin e ajrit të kondicionuar gjatë momenteve kur parashikohet nxehtë e ujit të ngrohtë sanitar.

6.3.1 Kufizimi i përhershëm i fuqisë

Kufizimi i përhershëm i fuqisë është i dobishëm për të garantuar fuqinë maksimale ose hyrjen maksimale të rrymës së sistemit. Në disa vende, legjislacioni kufizon konsumin maksimal të energjisë për ngrohjen e hapësirës dhe prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar.

Parametrizimi dhe konfigurimi

- Nuk nevojitet asnjë pajisje shtesë.
- Vendosni cilësimet e kontrollit të konsumit të energjisë në [9.9] nëpërmjet ndërfaqes së përdoruesit (shihni "[Kontrolli i konsumit të energjisë](#)" [▶ 89]):
 - Zgjidhni modalitetin e kufizimit të vazhdueshëm
 - Zgjidhni llojin e kufizimit (fuqia në kW ose rryma në A)
 - Vendosni nivelin e dëshiruar të kufizimit të fuqisë



- P_i** Hyrja e energjisë
 t Koha
PLL Niveli i kufizimit të fuqisë
a Kufizimi i fuqisë aktiv
b Hyrja aktuale e energjisë


6.3.2 Procesi i kufizimit të fuqisë

Njësia e jashtme ka efikasitet më të mirë sesa rezistencat përforcuese elektrike. Për këtë arsye, në fillim rezistenca përforcuese është e fikur. Sistemi e kufizon konsumin e energjisë në radhën e mëposhtme:

- 1 Fik rezistencën përforcuese.
- 2 Kufizon njësinë e jashtme.

Shembull

Konsumi i energjisë kufizohet si më poshtë:



- P_h** Nxehhtësia e prodhuar
- C_e** Energjia e konsumuar
- A** Njësia e jashtme
- B** Rezistenca përforcuese
- a** Funksionimi i kufizuar i njësisë së jashtme
- b** Funksionimi i plotë i njësisë së jashtme
- c** Rezistenca përforcuese e ndezur

7 Instalimi i njësisë

Në këtë kapitull

7.1	Përgatitja e vendit të instalimit	28
7.1.1	Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e brendshme	28
7.1.2	Kërkesat e veçanta për njësitë R32	29
7.1.3	Modelet e montimit	31
7.2	Hapja dhe mbyllja e njësive	36
7.2.1	Rreth hapjes së njësive	36
7.2.2	Për të hapur njësinë e brendshme	36
7.2.3	Mbyllja e njësive të brendshme	37
7.3	Montimi i njësive të brendshme	37
7.3.1	Rreth montimit të njësive të jashtme	37
7.3.2	Masat paraprake kur montohet njësia e brendshme	37
7.3.3	Instalimi i njësive të brendshme	37

7.1 Përgatitja e vendit të instalimit



PARALAJMËRIM

Pajisa do të ruhet në një dhomë pa burime ndezjesh me operim të vazhdueshëm (shembull: flakë të hapura, një pajisje me gaz ose një ngrohës me energji elektrike).

Zgjidhni një vend instalimi me hapësirë të mjaftueshme për të bërë transportimin e njësive në dhe jashtë kantierit.

MOS e instaloni njësinë në vende që shpesh përdoren si vend pune. Në rast punimesh (p.sh. mprehje) ku krijohet shumë pluhur, njësia DUHET mbuluar.



PARALAJMËRIM

MOS përdorni përsëri tubacionin e gazit ftohës që është përdorur me një tjetër gaz ftohës. Ndërroni tubat e gazit ftohës ose pastrojeni ato shumë mirë.



PARALAJMËRIM

Pajisa është IPX3. Kur montoni këtë produkt në një banjë, ndiqni legjislacionin e zbatueshëm për montimin në vende të tilla.


7.1.1 Kërkesat e vendit të instalimit për njësinë e brendshme



INFORMACION

Lexoni gjithashtu masat paraprake dhe kërkesat në "[2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme](#)" [p. 9].

- Njësia njësi e brendshme është projektuar vetëm për instalim të brendshëm dhe për temperaturat e ambientit që variojnë në 5~35°C.
- Mbani parasysh udhëzimet e mëposhtme për hapësirën e montimit:



Në shtesë të udhëzimeve për hapësirën: Meqë sasia totale e gazit ftohës në sistem është $\geq 1,84$ kg, dhoma ku do të montoni njësinë e brendshme duhet të përputhet gjithashtu me kushtet e përshkruara te ["7.1.3 Modelet e montimit"](#) [▶ 31].

MOS e montoni njësinë në vende të tilla si:

- Në vende ku në atmosferë ka prani piklash prej vaji mineralesh, spërka ose avull. Pjesët plastike mund të përkeqësohen dhe të bien ose mund të shkaktojnë rrjedhje uji.
- Zonat e ndjeshme ndaj zërit (p.sh. afër një dhome gjumi), në mënyrë që zhurma e operimit të mos shkaktojë shqetësime.
- Vendet ku ka mundësi për ngrica. Temperatura e ambientit përreth njësisë së brendshme duhet të jetë $>5^{\circ}\text{C}$.

7.1.2 Kërkesat e veçanta për njësitë R32

Në shtesë të udhëzimeve për hapësirën: Meqë sasia totale e gazit ftohës në sistem është $\geq 1,84$ kg, dhoma ku do të montoni njësinë e brendshme duhet të përputhet gjithashtu me kushtet e përshkruara te ["7.1.3 Modelet e montimit"](#) [▶ 31].



PARALAJMËRIM

- MOS shponi ose mos digjni pjesët e ciklit të gazit ftohës.
- MOS përdorni mjete për të përshpejtuar procesin e shkrirjes ose për të pastruar pajisjen, të ndryshme nga ato të rekomanduara nga prodhuesi.
- Jini të vetëdijshëm se gazi ftohës R32 NUK ka aromë.



PARALAJMËRIM

Pajisja duhet të ruhet për të penguar dëmtimin mekanik dhe në një dhomë të ajrosur mirë pa përdorur vazhdimisht burime ndezëse (shembull: flakë të hapura, pajisje që punon me gaz ose ngrohëse elektrike) dhe përmasa e dhomës të jetë sipas specifikimit të mëposhtëm.



NJOFTIM

- MOS i përdorni sërish nyjat dhe rondelat e bakrit që janë përdorur një herë.
- Nyjat e krijuara në instalimin mes pjesëve të sistemit të ftohësit do të jenë të aksesueshme për qëllime mirëmbajtjeje.



PARALAJMËRIM

Sigurohu që instalimi, servisi, mirëmbajtja dhe riparimi janë në përputhje me udhëzimet nga Daikin dhe me legjislacionin në fuqi (për shembull me rregullat kombëtare të përdorimit të gazit) dhe ekzekutohen VETËM nga persona të autorizuar.



NJOFTIM

- Tubacioni duhet të montohet në mënyrë të sigurt dhe të mbrohet nga dëmtimi fizik.
- Minimizoni sa më shumë instalimin e tubacioneve.

7.1.3 Modelet e montimit

**PARALAJMËRIM**

Për njësitet që përdorin gaz ftohës R32, është e nevojshme t'i mbani të gjitha foletë e nevojshme të ventilimit pa pengesa.

Në varësi të llojit të dhomës ku montoni njësinë e brendshme, lejohen modele të ndryshme montimi:

Lloji i dhomës	Modelet e lejuara
Dhomë ndenjeje, kuzhinë, garazh, papafingo, bodrum, dhomë magazine	1, 2
Dhomë teknike (d.m.th. dhomë ku nuk rrinë KURRË njerëz)	1, 2, 3

	MODELI 1	MODELI 2	MODELI 3
Dritaret e ajrimit	N/A	Midis dhomës A dhe B	Midis dhomës A dhe jashtë
Sipërfaqja minimale e dyshemesë	Dhoma A	Dhoma A + Dhoma B	N/A
Kufizimet	Shihni "MODELI 1" [▶ 32], "MODELI 2" [▶ 32], dhe "Tabelat për MODELIN 1 dhe 2" [▶ 33]		Shihni "MODELI 3" [▶ 35]


A	Dhoma A (= dhoma ku montohet njësia e brendshme)
B	Dhoma B (= dhoma ngjitur)
c1	Dritarja e poshtme për ajrim natyror
c2	Dritarja e sipërme për ajrim natyror
$H_{release}$	Lartësia aktuale e lëshimit: Nga dyshemeja deri në 100 mm poshtë pjesës së sipërme të njësisë.
N/A	Nuk ka; Nuk përdoret

Sipërfaqja minimale e dyshemesë / Lartësia e lëshimit:

- Kërkesat për sipërfaqen minimale të dyshemesë varen nga lartësia e çlirimit të gazit ftohës në rastin e rrjedhjes. Sa më e lartë të jetë lartësia e çlirimit, aq më të ulëta janë kërkesat për sipërfaqen minimale të dyshemesë.
- Pika e paracaktuar e lëshimit është 100 mm nën pjesën e sipërme të njësisë.
- Ju mund të përfitonit nga sipërfaqja e dyshemesë e dhomës ngjitur (= dhoma B) duke hapur dritare ajrimi midis dy dhomave.
- Për instalimet në dhomat teknike (d.m.th. dhomë ku nuk rrinë KURRË njerëz), përveç modelit 1 dhe 2 mund të përdoret edhe **MODELI 3**. Për këtë model nuk ka

kërkesa për sipërfaqen minimale të dyshemesë nëse siguron 2 dritare ajrimi (një poshtë dhe një lart) midis dhomës dhe ambientit jashtë, për të siguruar ajrimin natyror. Dhoma duhet të jetë e mbrojtur nga ngricat.

MODELI 1



MODELI 2

MODELI 2: Kushtet për dritaret e ajrimit


Nëse dëshironi të përfitonit nga sipërfaqja e dyshemesë e dhomës ngjitur, duhet të siguron 2 dritare ajrimi midis dhomave (një poshtë, një lart), për të garantuar ajrim natyror. Dritaret duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:


• Dritarja e poshtme (A_{nv}):

- Duhet të jetë dritare e përhershme që nuk mund të mbyllet.
- Duhet të ndodhet plotësisht midis 0 dhe 300 mm nga dyshemeja.
- Duhet të jetë $\geq A_{nv-min}$ (sipërfaqja minimale e dritares së poshtme).
- $\geq 50\%$ e sipërfaqes së kërkuar të dritares A_{nv-min} duhet të jetë ≤ 200 mm nga dyshemeja.
- Ana e poshtme e dritares duhet të jetë ≤ 100 mm nga dyshemeja.
- Nëse dritarja fillon nga dyshemeja, lartësia e dritares duhet të jetë ≥ 20 mm.

• Dritarja e sipërme:

- Duhet të jetë dritare e përhershme që nuk mund të mbyllet.
- Duhet të jetë $\geq 50\%$ e A_{nv-min} (sipërfaqja minimale e dritares së poshtme).
- Duhet të jetë $\geq 1,5$ m nga dyshemeja.





Tabelat për MODELIN 1 dhe 2

Tabela 1: Sipërfaqja minimale e dyshemesë

Merrni parasysh sa më poshtë:

- Për sipërfaqet e ndërmjetme të dyshemesë, përdorni kolonën me vlerën më të ulët. **Shembull:** Nëse sipërfaqja e dyshemesë është $1,7 \text{ m}^2$, përdorni kolonën e $1,65 \text{ m}^2$.
- Për mbushjet e ndërmjetme me gaz ftohës, përdorni rreshtin me vlerën më të lartë. **Shembull:** Nëse sasia e mbushjes me gaz ftohës është $2,35 \text{ kg}$, përdorni rreshtin e $2,4 \text{ kg}$.

Mbushja (kg)	Sipërfaqja minimale e dyshemesë (m^2)										
	Lartësia e lëshimit (m)										
	1,23	1,35	1,50	1,65	1,80	1,95	2,10	2,25	2,40	2,55	2,70
2,2	9,81	8,14	6,60	5,80	5,31	4,90	4,55	4,25	3,99	3,75	3,54
2,3	10,72	8,90	7,21	6,06	5,55	5,13	4,76	4,44	4,17	3,92	3,70
2,4	11,67	9,69	7,85	6,49	5,80	5,35	4,97	4,64	4,35	4,09	3,87
2,5	12,66	10,51	8,52	7,04	6,04	5,57	5,18	4,83	4,53	4,26	4,03
2,6	13,70	11,37	9,21	7,61	6,40	5,80	5,38	5,02	4,71	4,43	4,19

Tabela 2: Lartësia minimale e lëshimit

Merrni parasysh sa më poshtë:

- Për sipërfaqet e ndërmjetme të dyshemesë, përdorni kolonën me vlerën më të ulët. **Shembull:** Nëse sipërfaqja e dyshemesë është 5 m², përdorni kolonën e 4,00 m².
- Për mbushjet e ndërmjetme me gaz ftohës, përdorni rreshtin me vlerën më të lartë. **Shembull:** Nëse sasia e mbushjes me gaz ftohës është 2,35 kg, përdorni rreshtin e 2,4 kg.

Mbushja (kg)	Lartësia minimale e lëshimit (m)						
	Sipërfaqja e dyshemesë (m ²)						
	2,00	4,00	6,00	8,00	10,00	12,00	14,00
2,2	4,88	2,49	1,70	1,47	(*)	(*)	(*)
2,3	5,10	2,60	1,77	1,53	1,38	(*)	(*)
2,4	5,32	2,71	1,84	1,59	1,43	(*)	(*)
2,5	5,53	2,82	1,91	1,65	1,49	1,37	(*)
2,6	5,75	2,93	1,99	1,71	1,54	1,42	(*)

Tabela 3: Sipërfaqja minimale e dritares së poshtme për ajrimin natyror

Merrni parasysh sa më poshtë:

- Përdorni tabelën e duhur. Për mbushjet e ndërmjetme me gaz ftohës, përdorni tabelën me vlerën më të lartë. **Shembull:** Nëse sasia e mbushjes me gaz ftohës është 2,34 kg, përdorni tabelën e 2,4 kg.
- Për sipërfaqet e ndërmjetme të dyshemesë, përdorni kolonën me vlerën më të ulët. **Shembull:** Nëse sipërfaqja e dyshemesë është 5 m², përdorni kolonën e 4,00 m².
- Për vlerat e ndërmjetme të lartësisë së lëshimit, përdorni rreshtin me vlerën më të ulët. **Shembull:** Nëse lartësia e lëshimit është 2,20 m, përdorni rreshtin e 2,05 m.
- A_{nv}: Sipërfaqja e dritares së poshtme për ajrimin natyror.
- A_{nv-min}: Sipërfaqja minimale e dritares së poshtme për ajrimin natyror.
- (*) : Është OK (nuk nevojitet asnjë dritare ajrimi).

Lartësia e lëshimit (m)	A _{nv-min} (dm ²) – Nëse mbushja me gaz ftohës=2,2 kg						
	Sipërfaqja e dyshemesë e dhomës A (m ²) [! JO dhoma A + dhoma B !]						
	2,00	4,00	6,00	8,00	10,00	12,00	14,00
1,23	4,7	3,1	1,5	0,7	(*)	(*)	(*)
1,45	4,0	2,3	0,6	(*)	(*)	(*)	(*)
1,65	3,6	1,7	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
1,85	3,2	1,2	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,05	2,8	0,7	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,25	2,5	0,3	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,45	2,2	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,65	1,9	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)


Lartësia e lëshimit (m)	A _{nv-min} (dm ²) – Nëse mbushja me gaz ftohës=2,4 kg						
	Sipërfaqja e dyshemesë e dhomës A (m ²) [! JO dhoma A + dhoma B !]						
	2,00	4,00	6,00	8,00	10,00	12,00	14,00
1,23	5,2	3,6	2,0	1,3	0,6	(*)	(*)
1,45	4,6	2,8	1,1	0,2	(*)	(*)	(*)
1,65	4,1	2,2	0,3	(*)	(*)	(*)	(*)
1,85	3,6	1,7	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,05	3,2	1,2	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,25	2,9	0,7	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,45	2,6	0,3	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,65	2,3	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)

Lartësia e lëshimit (m)	A _{nv-min} (dm ²) – Nëse mbushja me gaz ftohës=2,6 kg						
	Sipërfaqja e dyshemesë e dhomës A (m ²) [! JO dhoma A + dhoma B !]						
	2,00	4,00	6,00	8,00	10,00	12,00	14,00
1,23	5,8	4,2	2,6	1,9	1,3	0,6	(*)
1,45	5,1	3,3	1,6	0,8	(*)	(*)	(*)

A _{nv-min} (dm ²) – Nësë mbushja me gaz ftohës=2,6 kg							
Lartësia e lëshimit (m)	Sipërfaqja e dyshemesë e dhomës A (m ²) [! JO dhoma A + dhoma B !]						
	2,00	4,00	6,00	8,00	10,00	12,00	14,00
1,65	4,5	2,7	0,8	(*)	(*)	(*)	(*)
1,85	4,1	2,1	0,2	(*)	(*)	(*)	(*)
2,05	3,7	1,6	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,25	3,3	1,2	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,45	3,0	0,7	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)
2,65	2,7	0,4	(*)	(*)	(*)	(*)	(*)

MODEL 3

MODELI 3 lejohtet vetëm për montime në dhomat teknike (d.m.th. dhomë ku nuk rrinë KURRË njerëz). Për këtë model nuk ka kërkesa për sipërfaqen minimale të dyshemesë nëse siguroni 2 dritare ajrimi (një poshtë dhe një lart) midis dhomës dhe ambientit jashtë, për të siguruar ajrimin natyror. Dhoma duhet të jetë e mbrojtur nga ngricat.



A	Dhoma pa njerëz ku është montuar njësia e brendshme. Duhet të jetë e mbrojtur nga ngricat.
a1	A_{nv}: Dritarja e poshtme për ajrimin natyror midis dhomës pa njerëz dhe ambientit jashtë. ▪ Duhet të jetë dritare e përhershme që nuk mund të mbyllet. ▪ Duhet të jetë mbi nivelin e tokës. ▪ Duhet të ndodhet plotësisht midis 0 dhe 300 mm nga dysHEMEJA e dhomës jo të banuar. ▪ Duhet të jetë $\geq A_{nv-min}$ (sipërfaqja minimale e dritares së poshtme që specifikohet në tabelën më poshtë). ▪ $\geq 50\%$ e sipërfaqes së kërkuar të dritares A_{nv-min} duhet të jetë ≤ 200 mm nga dysHEMEJA e dhomës jo të banuar. ▪ Ana e poshtme e dritares duhet të jetë ≤ 100 mm nga dysHEMEJA e dhomës jo të banuar. ▪ Nëse dritarja fillon nga dysHEMEJA, lartësia e dritares duhet të jetë ≥ 20 mm.
a2	Dritarja e sipërme për ajrimin natyror midis dhomës A dhe ambientit jashtë. ▪ Duhet të jetë dritare e përhershme që nuk mund të mbyllet. ▪ Duhet të jetë $\geq 50\%$ e A_{nv-min} (sipërfaqja minimale e dritares së poshtme që specifikohet në tabelën më poshtë). ▪ Duhet të jetë $\geq 1,5$ m nga dysHEMEJA e dhomës jo të banuar.

A_{nv-min} (sipërfaqja minimale e dritares së poshtme për ajrimin natyror)

Sipërfaqja minimale e dritares së poshtme për ajrimin natyror midis dhomës jo të banuar dhe ambientit jashtë varet nga sasia totale e gazit ftohës në sistem. Për mbushjet e ndërmjetme me gaz ftohës, përdorni rreshtin me vlerën më të lartë.

Shembull: Nëse sasia e mbushjes me gaz ftohës është 2,55 kg, përdorni rreshtin e 2,6 kg.

Mbushja totale e gazit ftohës (kg)	A_{nv-min} (dm ²)
2,20	7,5
2,30	7,7
2,40	7,9
2,50	8,0
2,60	8,2

7.2 Hapja dhe mbyllja e njësive

7.2.1 Rreth hapjes së njësive

Në orare të caktuara, duhet të hapni njësinë. **Shembull:**


- Kur lidhni instalimet elektrike
- Kur mirëmbani ose kryeni servis të njësive


RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE


MOS e lini njësinë të pambikëqyrur kur hiqet kapaku i servisit.

7.2.2 Për të hapur njësinë e brendshme


- 1 Hiqni kapakun e poshtëm për të pasur mundësinë të drejtoni kabllot për në kutinë shpërndarëse.



- 2 Hiqni kapakun e sipërm.



- 3 Hiqni kapakun e kutisë shpërndarëse.



7.2.3 Mbyllja e njësisë së brendshme

- 1 Montoni përsëri kapakun e kutisë shpërndarëse.
- 2 Montoni përsëri kapakun e sipërm.
- 3 Montoni përsëri kapakun e poshtëm.



NJOFTIM

Kur të mbyllni kapakun e njësisë së brendshme, sigurohuni që forca e shtrëngimit të MOS jetë mbi 2,94 N•m.

7.3 Montimi i njësisë së brendshme

7.3.1 Rreth montimit të njësisë së jashtme

Kur

Ju duhet të montoni njësinë e jashtme dhe njësinë e brendshme përpara se të lidhni tubacionet e gazit ftohës dhe të ujit.

7.3.2 Masat paraprake kur montohet njësia e brendshme



INFORMACION

Lexo gjithashtu masat paraprake dhe kërkesat në kapitujt vijues:

- "2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme" [▶ 9]
- "7.1 Përgatitja e vendit të instalimit" [▶ 28]


7.3.3 Instalimi i njësisë së brendshme




NJOFTIM

Sigurohuni që muri në të cilin është montuar mund të mbështesë peshën e pajisjes së mbushur me ujë.

- 1 Futni 2 flutura në mur dhe futni (jo plotësisht) 2 bulonat me rondele brenda fluturave.




2 Ngrini lart njësinë.



3 Kapni njësinë në mur:

- Vendosni kllapën e varjes në pjesën e pasme të njësisë mbi 2 bulonat.
- Ulni kllapën e varjes në pjesën e pasme të njësisë mbi 2 bulonat.
- Shtrëngoni 2 bulonat.
- Sigurohuni që njësia është fiksuar si duhet.



8 Instalimi i tubacionit

Në këtë kapitull

8.1	Përgatitja e tubacionit të ftohësit	39
8.1.1	Kërkesat e tubacionit të ftohësit	39
8.2	Lidhja e tubacionit të gazit ftohës	39
8.2.1	Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme	39
8.3	Përgatitja e tubave të ujit	40
8.3.1	Kërkesat për qarkun e ujit	40
8.4	Lidhja e tubave të ujit	42
8.4.1	Rreth lidhjes së tubave të ujit	42
8.4.2	Masat e kujdesit gjatë lidhjes së tubave të ujit	42
8.4.3	Për të lidhur tubat e ujit	42
8.4.4	Për të lidhur tubacionin e riqarkullimit	43
8.4.5	Për të mbushur depozitën e ujit të ngrohtë sanitar	43

8.1 Përgatitja e tubacionit të ftohësit

8.1.1 Kërkesat e tubacionit të ftohësit



INFORMACION

Lexoni gjithashtu masat paraprake dhe kërkesat në "[2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme](#)" [▶ 9].



KUJDES

- Kur për brenda ripërdoren lidhës **mekanikë**, vini pjesë të reja izolimi.
- Kur për brenda ripërdoren **dado ngjeshëse**, bëjeni nga e para pjesën e ngjeshur.

- **Lidhjet e tubacioneve:** Lejohen vetëm lidhjet konike me gotë dhe me saldim. Njësia e brendshme dhe njësia e jashtme kanë lidhje konike me gotë. Lidhni të dy skajet duke mos përdorur saldimin. Nëse nevojitet saldim, merrni parasysh udhëzimet në manualin referencë për instaluesin të njësive së jashtme.

Shihni edhe "[7.1.2 Kërkesat e veçanta për njësitet R32](#)" [▶ 29] për kërkesat shtesë.

Për informacione lidhur me gjatësinë e tubave, diametrin, lidhjet dhe izolimin, shihni Manuali i montimit – Njësia e jashtme.

8.2 Lidhja e tubacionit të gazit ftohës

Shihni manualin e montimit të njësive së jashtme për të gjitha udhëzimet, specifikimet dhe instruksionet e montimit.

8.2.1 Lidhja e tubacionit të ftohësit me njësinë e brendshme



NJOFTIM


Sigurohuni që valvulat mbyllëse të depozitës janë plotësisht të hapura.



INFORMACION

Valvulat mbyllëse janë të hapura që nga fabrika dhe qarku i gazit ftohës i depozitës NUK është i mbushur.

- 1 Lidhni tubacionin e gazit ftohës nga valvula e ndalimit të lëngut të njësisë së jashtme me valvulën e ndalimit të lëngut të gazit ftohës të njësisë së brendshme.



- a Valvula e ndërprerjes së lëngut të gazit ftohës
b Valvula e ndërprerjes së gazit të gazit ftohës

- 2 Lidhni tubacionin e gazit ftohës nga valvula e ndalimit të gazit të njësisë së jashtme me valvulën e ndalimit të gazit të gazit ftohës të njësisë së brendshme.

8.3 Përgatitja e tubave të ujit

8.3.1 Kërkesat për qarkun e ujit



INFORMACION

Lexoni gjithashtu masat paraprake dhe kërkesat në "[2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme](#)" [9].



NJOFTIM

Në rastin e tubave plastikë, sigurohuni që ato janë plotësisht hermetikë ndaj difuzionit të oksigjenit, sipas standardit DIN 4726. Difuzioni i oksigjenit në tuba mund të çojë në shtim të korrozionit.


- **Lidhja e tubave – Legjislacioni.** Realizoni të gjitha lidhjet e tubave në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe me udhëzimet në kapitullin "Montimi", duke respektuar hyrjen dhe daljen e ujit.
- **Lidhja e tubave – Forca.** MOS ushtroni forcë të tepruar kur lidhni tubat. Deformimi i tubave mund të shkaktojë probleme funksionimi të njësisë.
- **Lidhja e tubave – Veglat.** Përdorni vetëm vegla të përshtatshme për të manovruar tunxhin, që është një material i butë. PËRNDRYSHË, tubat do të dëmtohen.
- **Lidhja e tubave – Ajri, lagështia, pluhuri.** Nëse brenda qarkut futet ajër, lagështi ose pluhur, mund të ndodhin probleme. Për ta parandaluar këtë:
 - Përdorni VETËM tuba të pastër.
 - Mbajini fundet e tubave të kthyer poshtë kur hiqni papastërtitë.
 - Mbuloni fundin e tubit kur e futni përmes një muri, për të parandaluar futjen brenda në tub të pluhurit dhe/ose të grimcave të tij.
 - Përdorni një izolues të përshtatshëm për filetat, për të izoluar lidhjet.
 - Kur përdorni tubacione metalike jo prej tunxhi, sigurohuni të izoloni të dyja materialet nga njëri-tjetri për të parandaluar korrozionin galvanik.
 - Meqenëse tunxhi është material i butë, përdorni veglat e duhura për të lidhur qarkun e ujit. Veglat e papërshtatshme do të shkaktojnë dëmtim të tubave.
- **Glikoli.** Për arsye sigurie, NUK lejohet të shtoni asnjë lloj glikoli në qarkun e ujit.

- **Gjatësia e tubave.** Rekomandohet që të shmanget shtrirja e gjatë e tubave midis depozitës së ujit të ngrohtë sanitar dhe pikës fundore të ujit të ngrohtë (dush, vaskë,...), si dhe rekomandohet shmangia e fundeve të mbyllura.
- **Komponentët që sigurohen në terren – Uji.** Përdorni vetëm materiale që janë të përputhshme me ujin e përdorur në sistem dhe me materialet e përdorura në njësinë e brendshme.
- **Komponentët që sigurohen në terren – Presioni i ujit dhe temperatura.** Verifikoni nëse të gjithë komponentët në tubacionin në terren mund të përballojnë presionin e ujit dhe temperaturën e ujit.
- **Presioni i ujit – Uji i ngrohtë sanitar.** Presioni maksimal i ujit është 7 bar (=0,7 MPa) dhe duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm. Siguroni masa mbrojtëse të përshtatshme në qarkun e ujit për të garantuar që presioni i ujit të MOS tejkalohet (shihni "8.4.3 Për të lidhur tubat e ujit" [▶ 42]). Presioni minimal i ujit për funksionimin është 1 bar (=0,1 MPa).
- **Temperatura e ujit.** Të gjithë tubat dhe aksesoret e tubave të instaluar (valvula, lidhjet,...) DUHET t'u rezistojnë temperaturave të mëposhtme:




INFORMACION

Figura e mëposhtme është një shembull dhe NUK mund të përputhet plotësisht me planin e sistemit tuaj.



- **Tubacionet metalike jo prej tunxhi.** Nëse përdorni tubacione metalike jo prej tunxhi, izoloni si duhet pjesët prej tunxhi dhe jo prej tunxhi, që të MOS kenë kontakt me njëra-tjetrën. Kjo është për të parandaluar korrozionin galvanik.
- **Depozita e ujit të ngrohtë sanitar – Kapaciteti.** Për të shmangur ndenjen e ujit, është e rëndësishme që kapaciteti mbajtës i depozitës së ujit të ngrohtë sanitar të plotësojë konsumin ditor të ujit të ngrohtë sanitar.
- **Depozita e ujit të ngrohtë sanitar – Pas instalimit.** Menjëherë pas instalimit, depozita e ujit të ngrohtë sanitar duhet shpëlarë me ujë të freskët. Kjo procedurë duhet përsëritur të paktën një herë në ditë, në 5 ditët e para rresht pas instalimit.
- **Depozita e ujit të ngrohtë sanitar – Qëndrimet.** Në rastet kur për periudha të gjata kohe nuk ka fare konsum të ujit të ngrohtë, pajisjet DUHEN shpëlarë me ujë të freskët përpara përdorimit.
- **Valvulat termostatike të përzierjes.** Sipas legjislacionit të zbatueshëm, mund të jetë e nevojshme të instalohen valvula termostatike të përzierjes.
- **Masat higjienike.** Montimi duhet bërë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe mund të kërkojë masa shtesë higjienike për instalimin.
- **Depozita e ujit të ngrohtë sanitar – Dezinfektimi.** Për funksionin e dezinfektimit të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar, shihni "10.6.2 Depozita" [▶ 72].

- **Pompa e riqarkullimit.** Sipas legjislacionit të zbatueshëm, mund të kërkohej lidhja e një pompe riqarkullimi midis pikës fundore të ujit të ngrohtë dhe lidhjes së ujit të ftohtë të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar. Siguroni një ushqim elektrik të veçantë për pompën e riqarkullimit.



- a Lidhja e ujit të ftohtë
- b Lidhja e ujit të ngrohtë
- c Dushi
- d Pompa e riqarkullimit
- e Valvula e moskthimit

8.4 Lidhja e tubave të ujit

8.4.1 Rreth lidhjes së tubave të ujit

Përpara lidhjes së tubave të ujit

Sigurohuni që njësia e brendshme dhe njësia e jashtme janë montuar.

Ngarkesa tipike e punës

Në mënyrë tipike lidhja e tubave të ujit përbëhet nga fazat e mëposhtme:

- 1 Lidhja e tubave të ujit në njësinë e brendshme.
- 2 Mbushja e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar.
- 3 Izolimi i tubave të ujit.

8.4.2 Masat e kujdesit gjatë lidhjes së tubave të ujit



INFORMACION

Lexoni gjithashtu masat e kujdesit dhe kërkesat në kapitujt e mëposhtëm:

- "2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme" [▶ 9]
- "8.3 Përgatitja e tubave të ujit" [▶ 40]


8.4.3 Për të lidhur tubat e ujit



NJOFTIM


MOS përdorni forcë të tepruar kur lidhni tubat në vend dhe sigurohuni që tubat të jenë të drejtuar si duhet. Tubat e deformuar mund të shkaktojnë defekt të njësisë.

- 1 Lidhni ujin e ngrohtë sanitar në tubat e hyrjes dhe të daljes në njësinë e brendshme.



- a** DHW – Dalja e ujit të ngrohtë (lidhja e filetuar, ½")
b DHW – Hyrja e ujit të ftohtë (lidhja e filetuar, ½")

- 2** Lidhni komponentët e mëposhtëm (sigurohen në terren) në hyrjen e ujit të ftohtë të depozitës DHW:



- a** DHW – Dalja e ujit të ngrohtë (lidhja e filetuar, ½")
b DHW – Hyrja e ujit të ftohtë (lidhja e filetuar, ½")
c Valvul bllokimi (e rekomanduar)
d Valvul moskthimi (e rekomanduar)
e Valvul reduktuese presioni (e rekomanduar)
***f** Valvul sigurie presioni (maks. 7 bar (=0,7 MPa))(e detyrueshme)
***g** Dalje shkarkimi (e detyrueshme)
h Enë zgjerimi (e rekomanduar)



PARALAJMËRIM

MOS montoni asnjë valvul midis depozitës së ujit të ngrohtë sanitar dhe valvulës së çlirimit të presionit.



NJOFTIM

Një valvul e çlirimit të presionit (sigurohen në terren) me presion hapjeje maksimumi 7 bar (=0,7 MPa) duhet instaluar në lidhjen e hyrjes së ujit të ftohtë sanitar, në përputhje me legjisllacionin e zbatueshëm.



NJOFTIM

Për të shmangur dëmtimin e ambientit përreth nëse rrjedh ujë, rekomandohet që t'i mbyllni valvulat bllokuese të hyrjes së ujit të ftohtë sanitar gjatë periudhave të mungesës.

8.4.4 Për të lidhur tubacionin e riqarkullimit

Nëse në sistemin tuaj kërkohet riqarkullimi, kthimi i ujit në depozitë duhet të jetë nga hyrja e ujit të ftohtë.

Duhet instaluar një valvul kontrolli për të penguar kthimin e ujit në sistemin e furnizimit

8.4.5 Për të mbushur depozitën e ujit të ngrohtë sanitar

- 1** Hapni çdo rubinet të ujit të nxehtë për të nxjerrë ajrin nga rrjeti i tubave të sistemit.

- 2** Hapni valvulën e furnizimit me ujë të ftohtë.
- 3** Mbyllni të gjithë rubinetat e ujit pasi të ketë dalë i gjithë ajri.
- 4** Kontrolloni për rrjedhje uji.
- 5** Vini në punë manualisht valvulën e çlirimit të presionit të instaluar në vend, për të garantuar një rrjedhje të lirë të ujit nëpër tubin e shkarkimit.

9 Instalimi elektrik

Në këtë kapitull

9.1	Rreth lidhjes së instalimeve elektrike.....	45
9.1.1	Masat paraprake kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike.....	45
9.1.2	Udhëzimet kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike.....	46
9.1.3	Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike.....	47
9.1.4	Rreth pajisjes elektrike.....	48
9.2	Lidhjet në njësinë e brendshme	48
9.2.1	Për të lidhur ushqimin elektrik nga rrjeti.....	48
9.2.2	Për të lidhur ushqimin elektrik të rezistencës përforcuese	49
9.2.3	Për të lidhur kartën e Wi-Fi (dërgohet si aksesori)	51

9.1 Rreth lidhjes së instalimeve elektrike

9.1.1 Masat paraprake kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



PARALAJMËRIM

- Të gjitha instalimet elektrike DUHEN kryer nga një electricist i autorizuar dhe DUHET të pajtohen me rregulloren kombëtare të instalimeve elektrike.
- Kryeni lidhjet elektrike tek instalimet e montuara.
- Të gjithë komponentët e prokuruar në vend dhe të gjitha punimet elektrike DUHET të përputhen me legjislacionin në fuqi.



PARALAJMËRIM

GJITHMONË përdor kablo me shumë bërthama për kabllot e furnizimit me energji elektrike.



INFORMACION

Lexoni gjithashtu masat paraprake dhe kërkesat në "2 Masat paraprake të sigurisë së përgjithshme" [9].



PARALAJMËRIM

- Nëse ushqimit elektrik i mungon ndonjë fazë ose ka fazë të gabuar N, pajisjet mund të prishen.
- Vendosni tokëzimin e duhur. MOS e tokëzoni njësinë në tuba shërbimi, absorbues mbtensionit apo tokëzime telefonike. Tokëzimi i paplotë ose i gabuar mund të shkaktojë goditje elektrike.
- Instaloni siguresat ose automatët e kërkuar.
- Siguroni instalimet elektrike me lidhje kablore në mënyrë që kabllot TË MOS bien në kontakt me skajet e mprehta ose tubacionet, veçanërisht në anën e presionit të lartë.
- MOS përdorni tela me ngjitje, kordona zgjatues apo lidhje me sistem në formë ylli. Ato mund të shkaktojnë mbinxehje, goditje elektrike ose zjarr.
- MOS instaloni kondensator avancimi faze, pasi kjo njësi është e pajisur me inverter. Kondensatori i avancimit të fazës zvogëlon performancën dhe mund të shkaktojë aksidente.

**KUJDES**

MOS e shtyni apo mos e vini kabllon e mbetur në njësi.

**NJOFTIM**

Distanca midis kabllave të tensionit të lartë dhe kabllave të tensionit të ulët duhet të jetë të paktën 50 mm.


9.1.2 Udhëzimet kur kryen lidhjet e instalimeve elektrike

**NJOFTIM**


Rekomandojmë përdorimin e telave të fortë (tek bërthamë). Nëse përdoren telat e bllokuar, rrotulloni ngadalë telat për të konsoliduar fundin e përçuesit për secilin prej përdorim të drejtpërdrejtë në kapësen e terminalit ose vendosjen në një terminal të rrumbullakët të llojit dredhë.

Përgatitja e telit të bllokuar të përçuesit për instalim**Metoda 1: Përdredhja e përçuesit**

- 1 Hiqni izolimin (20 mm) nga telat.
- 2 Përdridhni ngadalë anën fundore të përçues për të krijuar një lidhje "të fortë".

**Metoda 2: Përdorimi i terminalit të rrumbullakët të llojit dredhë (rekomandohet)**

- 1 Zhvishni izolimin nga telat dhe përdridhni ngadalë fundin e secilit tel.
- 2 Vendosni një terminal të rrumbullakët të llojit dredhë në fundin e telit. Vendosni terminalin e rrumbullakët i llojit dredhë në tel deri te pjesa e mbuluar dhe shtrëngoni terminalin me mjetin e duhur.



Përdorni metodat vijuese për instalimin e telave:

Lloji i telit	Metoda e instalimit
Tel me tek bërthamë Ose Teli i bllokuar i përçuesit i përdredhur në lidhje "të fortë"	a Tel i dredhur (teli i bllokuar i përçuesit me tek bërthamë ose i përdredhur) b Vidhë c Rondele e sheshtë
Tel i bllokuar përçuesi me terminal të rrumbullakët të llojit dredhë	a Terminal b Vidhë c Rondele e sheshtë ✓ Lejohet ✗ NUK lejohet

Forcat e shtrëngimit

Njësia e brendshme:

Artikulli	Forca e shtrëngimit (N•m)
X2M	2,45 ±10%
X5M	0,88 ±10%
X8M	2,45 ±10%
M4 (toka)	1,47 ±10%

9.1.3 Specifikimet e përbërësve standardë të instalimeve elektrike

Komponenti		
Kablllo ndërlidhjeje (e brendshme↔jashtme)	Tensioni	220~240 V
	Madhësia e telit	Përdorni vetëm tela të harmonizuar që sigurojnë izolim të dyfishtë dhe të përshtatshëm për tensionin përkatës Kablllo me 4 tela Minimumi 1,5 mm ²

Komponenti		
Ushqimi elektrik i ngrohësit përforcues	Tensioni	220~240 V
	Madhësia e telit	Përdorni vetëm tela të harmonizuar që siguronjnë izolim të dyfishtë dhe të përshtatshëm për tensionin përkatës Kablllo me 3 tela Minimumi 1,5 mm ²
	Siguresa e rekomanduar në terren	Kurba 10 A, C
	Automati me shkarkim tokëzimi/pajisja e rrymës së mbetur	30 mA - DUHET të përputhet me rregulloren kombëtare për instalimet elektrike

9.1.4 Rreth pajisjes elektrike

Vetëm për rezistencën përforcuese të njësisë së brendshme

Shihni "9.2.2 Për të lidhur ushqimin elektrik të rezistencës përforcuese" [▶ 49].


9.2 Lidhjet në njësinë e brendshme

Artikulli	Përshkrimi
Ushqimi elektrik (nga rrjeti)	Shihni "9.2.1 Për të lidhur ushqimin elektrik nga rrjeti" [▶ 48].
Ushqimi elektrik (rezistenca përforcuese)	Shihni "9.2.2 Për të lidhur ushqimin elektrik të rezistencës përforcuese" [▶ 49].
Karta e Wi-Fi	Shihni "9.2.3 Për të lidhur kartën e Wi-Fi (dërgohet si aksesori)" [▶ 51]




9.2.1 Për të lidhur ushqimin elektrik nga rrjeti

- Hapni sa më poshtë (shihni "7.2.2 Për të hapur njësinë e brendshme" [▶ 36]):
- Lidhni ushqimin elektrik nga rrjeti.

	Kabllloja e lidhjes (= ushqimi elektrik nga rrjeti)	Telat: (3+GND)×1,5 mm ²
	—	



a Kabloja e lidhjes (=ushqimi elektrik nga rrjeti)



9.2.2 Për të lidhur ushqimin elektrik të rezistencës përforcuese

	Kabloja e rezistencës përforcuese	Telat: (2+GND)×1,5 mm ²
	[9.4]Rezistenca përforcuese	




PARALAJMËRIM

Rezistenca përforcuese DUHET të ketë një linjë të veçantë ushqimi elektrik dhe DUHET të mbrohet nga pajisjet e sigurisë që kërkohen nga legjisllacioni i zbatueshëm.

**KUJDES**

Për të garantuar që njësia të jetë plotësisht e tokëzuar, lidhni GJITHMONË ushqimin elektrik të rezistencës përforcuese dhe kabllon e tokëzimit.

Lidhni ushqimin elektrik të rezistencës përforcuese si më poshtë:




a	Kabllloja e ushqimit elektrik të rezistencës përforcuese
b	Instalim në terren

9.2.3 Për të lidhur kartën e Wi-Fi (dërgohet si aksesori)



- 1 Futni kartën e Wi-Fi në folenë e kartës në ndërfaqen e përdoruesit në njësine e brendshme.



10 Konfigurimi

Në këtë kapitull

10.1	Përmbledhje: Konfigurimi.....	52
10.1.1	Hyrja në komandat për të përdorura	53
10.1.2	Për të lidhur kabllon e PC në kutinë shpërndarëse.....	55
10.2	Ndihmuesi i konfigurimit	56
10.3	Pamjet e mundshme të ekranit.....	57
10.3.1	Pamjet e mundshme të ekranit: Përmbledhje	57
10.3.2	Ekran i kryesor	57
10.3.3	Pamja e menysë kryesore	59
10.3.4	Pamja e ekranit të menysë	59
10.3.5	Pamja e ekranit të vlerës së caktuar	60
10.3.6	Pamja e detajuar e ekranit me vlerat	61
10.4	Vlerat e paracaktuara dhe programet.....	61
10.4.1	Përdorimi i vlerave të paracaktuara	61
10.4.2	Përdorimi dhe programimi i programeve.....	62
10.4.3	Ekran i programit: Shembull ilustrues	64
10.5	Kurba në varësi të motit	68
10.5.1	Çfarë është kurba në varësi të motit?.....	68
10.5.2	Kurba me 2 pika	68
10.5.3	Kurba pjerrësi-kompensim.....	69
10.5.4	Përdorimi i kurbave në varësi të motit	70
10.6	Menyja e cilësimeve	71
10.6.1	Funksionimi me defekt.....	72
10.6.2	Depozita	72
10.6.3	Cilësimet për përdoruesin	81
10.6.4	Informacion	84
10.6.5	Cilësimet për instaluesin.....	86
10.6.6	Vënia në përdorim	92
10.6.7	Profili i përdoruesit	92
10.6.8	Funksionimi	93
10.6.9	Wi-Fi	93
10.7	Struktura e menysë: Përmbledhje e cilësimeve për përdoruesin	96
10.8	Struktura e menysë: Përmbledhje e cilësimeve për instaluesin.....	97

10.1 Përmbledhje: Konfigurimi

Ky kapitull përshkruan ato çfarë ju nevojitet të dini dhe të bëni për të konfiguruar sistemin pasi ai të montohet.

Pse

Nëse NUK e konfiguroni sistemin saktë, ai mund të MOS punojë siç pritet. Konfigurimi ndikon te:

- Llogaritjet e softuerit
- Ajo çfarë shihni dhe çfarë mund të bëni në ndërfaqen e përdoruesit

Si

Ju mund ta konfiguroni përmes ndërfaqes së përdoruesit.

- **Hera e parë – Ndihmuesi i konfigurimit.** Kur ndizni ndërfaqen e përdoruesit për herë të parë (nga njësia), ndihmuesi i konfigurimit fillon t'ju ndihmojë në konfigurimin e sistemit.
- **Rihapni ndihmuesin e konfigurimit.** Nëse sistemi është konfiguruar më parë, ju mund ta rihapni ndihmuesin e konfigurimit. Për të rihapur ndihmuesin e konfigurimit, shkoni te **Cilësimet e instaluesit > Ndihmuesi i konfigurimit**. Për të hyrë te **Cilësimet e instaluesit**, shihni "[10.1.1 Hyrja në komandat për të përdorura](#)" [▶ 53].

- **Më pas.** Nëse nevojitet, mund të bëni ndryshime në konfigurim në strukturën e menysë ose në cilësimet e përgjithshme.



INFORMACION

Kur ndihmuesi i konfigurimit të përfundojë, ndërfaqja e përdoruesit do të tregojë një pamje ekrani përmbledhëse dhe kërkon konfirmim. Kur konfirmohen, sistemi do të rindizet dhe do të shfaqet ekrani kryesor.

Hyrja te cilësimet – Legjenda për tabelat

Ju mund të hyni te cilësimet për instaluesin duke përdorur dy metoda të ndryshme. Megjithatë, JO të gjitha cilësimet mund të shihen nga të dyja metodat. Nëse është kështu, kolonat e tabelave përkatëse në këtë kapitull kanë shënimin N/A (nuk ka).

Metoda	Kolona në tabela
Hyrja te cilësimet nga pema e lundrimit tek ekrani i menysë kryesore ose te strukture e menysë . Për të aktivizuar pemën e lundrimit, shtypni butonin ? në ekranin kryesor.	# Për shembull: [5.5]
Hyrja te cilësimet nga kodi te përmbledhja e cilësimeve të fushave .	Kodi Për shembull: [6-0D]

Shihni edhe:

- "Për të hyrë në cilësimet për instaluesin" [▶ 54]
- "10.8 Struktura e menysë: Përmbledhje e cilësimeve për instaluesin" [▶ 97]

10.1.1 Hyrja në komandat për të përdorura


Ndryshimi i nivelit të autorizimit të përdoruesit

Ju mund ta ndryshoni nivelin e autorizimit të përdoruesit si më poshtë:

1	Shkoni te [B]: Profili i përdoruesit .	
2	Futni kodin PIN të kërkuar për nivelin e autorizimit të përdoruesit.	—
	▪ Lundroni nëpër listën e numrave dhe ndryshoni numrin e zgjedhur.	
	▪ Konfirmoni shifrën për të vijuar në shifrën tjetër.	
	▪ OSE, lëvizni kursorin nga e majta në të djathtë.	
	▪ Konfirmoni kodin PIN dhe vazhdoni më tej.	

Kodi PIN i instaluesit

Kodi PIN për Instaluesi është **5678**. Pas futjes së kodit disponohen pika shtesë të menysë dhe cilësimet për instaluesin.



Kodi PIN për përdoruesin e avancuar

Kodi PIN për Përdoruesin e avancuar është **1234**. Pas futjes së kodit disponohen pika shtesë të menysë për përdoruesin.



Kodi PIN i përdoruesit

Kodi PIN për Përdoruesin është **0000**.



Për të hyrë në cilësimet për instaluesin

- 1 Vendosni nivelin e autorizimit të përdoruesit në **Instaluesi**.
- 2 Shkoni te [9]: **Cilësimet e instaluesit**.

Për të modifikuar një cilësim të përgjithshëm

Shembull: Modifikoni [2-02] nga 23 në 3.

Shumica e cilësimeve mund të konfigurohen përmes strukturës së menysë. Nëse për ndonjë arsye nevojitet të ndryshohet një cilësim duke përdorur cilësimet e përgjithshme, atëherë hyni në cilësimet e përgjithshme si më poshtë:

1	Vendosni nivelin e autorizimit të përdoruesit në Instaluesi. Shihni "Ndryshimi i nivelit të autorizimit të përdoruesit" [► 53].	—																
2	Shkoni te [9.I]: Cilësimet e instaluesit > Përmbledhje e parametrave të vendosur.																	
3	Rrotulloni çelësin rrotullues të majtë për të zgjedhur pjesën e parë të cilësimit dhe konfirmoni zgjedhjen duke shtypur çelësin rrotullues. <table border="1"><tr><td rowspan="5">)</td><td>00</td><td>05</td><td>0A</td></tr><tr><td>01</td><td>06</td><td>0B</td></tr><tr><td>02</td><td>07</td><td>0C</td></tr><tr><td>03</td><td>08</td><td>0D</td></tr><tr><td>04</td><td>09</td><td>0E</td></tr></table>	)	00	05	0A	01	06	0B	02	07	0C	03	08	0D	04	09	0E	
)	00		05	0A														
	01		06	0B														
	02		07	0C														
	03		08	0D														
	04	09	0E															

4	Rrotulloni çelësin rrotullues të majtë për të zgjedhur pjesën e dytë të cilësimit	
5	Rrotulloni çelësin rrotullues të djathtë për të modifikuar vlerën nga 23 në 3.	
6	Shtypni çelësin rrotullues të majtë për të konfirmuar cilësimin e ri.	
7	Shtypni butonin në qendër për t'u kthyer në ekranin kryesor.	



INFORMACION

Kur ndryshoni cilësimet e përgjithshme dhe ktheheni në ekranin kryesor, ndërfaqja e përdoruesit shfaq një dritare kërcyese dhe kërkon që të rindizni sistemin.


Kur kjo konfirmohet, sistemi do të rindizet dhe do të aplikohen ndryshimet e fundit.

10.1.2 Për të lidhur kabllon e PC në kutinë shpërndarëse


Kjo lidhje midis kompjuterit dhe PCB të Hydro nevojitet kur përditësoni softuerin Hydro dhe EEPROM.

Kushti paraprak: Për këtë nevojitet kompleti EKPCCAB4.

- 1 Lidhni konektorin USB të kabllot në kompjuterin tuaj.
- 2 Lidhni fishën e kabllot në folenë X10A në A1P të kutisë shpërndarëse në njësinë e brendshme.



- 3 Kushtojini vëmendje pozicionit të fishës!



10.2 Ndihmuesi i konfigurimit

Në ndezjen e parë elektrike të sistemit, ndërfaqja e përdoruesit hap një ndihmues konfigurimi. Përdorni këtë ndihmues për të vendosur shumicën e cilësimeve fillestare të rëndësishme, që njësia të funksionojë si duhet. Nëse nevojitet, mund të konfiguroni më pas më shumë cilësime. Të gjitha këto cilësime mund t'i ndryshoni nëpërmjet strukturës së menysë.

Këtu do të gjeni një përmbledhje të shkurtër të cilësimeve të konfigurimit. Të gjitha cilësimet mund të rregullohen edhe në menynë e cilësimeve (përdorni pemët e lundrimit).


Për cilësimin...		Referohuni te...
Gjuha [7.1]		
Ora/data [7.2]		
	Orët	—
	Minutat	
	Viti	
	Muaji	
	Data	
Sistemi		
	Lloji i njësisë së brendshme (vetëm për lexim)	"10.6.5 Cilësimet për instaluesin" [▶ 86]
	Uji i ngrohtë sanitar (jo e rregullueshme)	
	Emergjenca [9.5.1]	
	Kapaciteti i rezistencës përforcuese [9.4.1]	"10.6.5 Cilësimet për instaluesin" [▶ 86]
Depozita		

Për cilësimin...	Referohuni te...
Mënyra e ngrohjes [5.6]	"10.6.2 Depozita" [▶ 72]
Setpointi i rehatisë [5.2]	
Setpointi ECO [5.3]	
Setpointi i ringrohjes [5.4]	
Histerezia [5.9] dhe [5.A]	
Modaliteti i funksionimit [5.G]	

10.3 Pamjet e mundshme të ekranit

10.3.1 Pamjet e mundshme të ekranit: Përmbledhje


Pamjet më të zakonshme të ekranit janë si më poshtë:



- a** Ekran kryesor
- b** Pamja e menysë kryesore
- c** Pamjet e ekranit të niveleve më të poshtme:
 - c1:** Pamja e ekranit të vlerës së caktuar
 - c2:** Pamja e detajuar e ekranit me vlerat
 - c3:** Pamja e ekranit me kurbën në varësi të motit
 - c4:** Pamja e ekranit me programin

10.3.2 Ekran kryesor

Shtypni butonin për t'u kthyer në ekranin kryesor. Ju mund të shihni një përmbledhje të konfigurimit të njësisë dhe të temperaturës së dhomës dhe të temperaturës së vlerës së caktuar. Në ekranin kryesor janë të dukshme vetëm simbolet e zbatueshme për konfigurimin tuaj.




Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes listës së menysë kryesore.
	Shkoni tek ekrani i menysë kryesore.
	Aktivizoni/çaktivizoni pemët e lundrimit.

Artikulli	Përshkrimi	
a	Uji i ngrohtë sanitar	
a1		Uji i ngrohtë sanitar
a2		Temperatura e matur e depozitës ^(a)
b	Dezinfektimi / I fuqishëm	
		Modaliteti i dezinfektimit aktiv
		Modaliteti i funksionimit të fuqishëm aktiv
c	Emergjencia	
		Prishje e pompës së nxehtësisë dhe sistemi punon në modalitetin Emergjencia .
d	Data dhe ora aktuale	
e	Modaliteti Jashtë / i qetë	
e1		Temperatura e jashtme e matur ^(a)
e2		Modaliteti i qetë aktiv
e3		Njësia e jashtme
f	Njësia e brendshme / depozita e ujit të ngrohtë sanitar	
f		Depozita e ujit të ngrohtë sanitar
g	Modaliteti i pushimeve	
		Modaliteti i pushimeve aktiv
h	Defekt	
		Ka ndodhur një defekt.
		Shihni " 14.4.1 Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti " [▶ 108] për më shumë informacion.

^(a) Nëse funksioni përkatës nuk është aktiv, rrethi është në ngjyrë gri.

10.3.3 Pamja e menysë kryesore

Duke u nisur nga ekrani kryesor, shtypni (🔍) ose rrotulloni (🔄) çelësin rrotullues të majtë për të hapur ekranin e menysë kryesore. Nga menya kryesore, mund të hyjni në ekranet e vlerave të caktuara të ndryshme dhe në nënmeny.





a Nënmenyja e zgjedhur

Veprimet e mundshme në ekran	
🔍	Kaloni përmes listës.
🔄	Hyni në nënmeny.
?	Aktivizoni/çaktivizoni pemët e lundrimit.

Nënmenyja		Përshkrimi
[0]	🔔 ose ⚠ Defektet	Kufizim: Shfaqet vetëm nëse ndodh ndonjë defekt. Shihni "14.4.1 Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti" [▶ 108] për më shumë informacion.
[5]	🏠 Depozita	Vendosni temperaturën e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar.
[7]	🔧 Cilësimet e përdoruesit	Mundëson hyrjen te cilësimet për përdoruesin, si për shembull modaliteti i pushimeve dhe modaliteti i qetësisë.
[8]	📄 Informacion	Shfaq të dhëna dhe informacione rreth njësisë së brendshme.
[9]	✂ Cilësimet e instaluesit	Kufizim: Vetëm për instaluesin. Mundëson hyrjen te cilësimet e avancuara.
[A]	📋 Vënia në përdorim	Kufizim: Vetëm për instaluesin. Kryen testimet dhe mirëmbajtjen.
[B]	👤 Profili i përdoruesit	Ndryshoni profilin aktiv të përdoruesit.
[C]	🔌 Funksionimi	Ndizni dhe fikni funksionin e ngrohjes/ftohjes dhe të përgatitjes së ujit të ngrohtë sanitar.
[D]	📶 Portë Wireless	Kufizim: Shfaqet vetëm nëse është instaluar një LAN me valë (Wi-Fi). Përmban cilësimet që nevojiten kur konfigurohet aplikacioni ONECTA. Shihni manualin referencë për përdoruesin për më shumë informacion.

10.3.4 Pamja e ekranit të menysë

Shembull:




Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes listës.
	Hyni në nënmeny/te cilësimi.

10.3.5 Pamja e ekranit të vlerës së caktuar


Pamja e ekranit të vlerës së caktuar shfaqet për ekranet që përshkruajnë komponentët e sistemit që kanë nevojë për një vlerë të caktuar.

Shembull

[5] Pamja e ekranit e temperaturës së depozitës




Shpjegimi



Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes listës së nënmenysë.
	Shkoni te nënmenyja.
	Rregulloni dhe aplikoni automatikisht temperaturën e dëshiruar.


Artikulli	Përshkrimi	
Kufiri i temperaturës minimale	a1	I fiksuar nga njësia
	a2	I kufizuar nga instaluesi
Kufiri i temperaturës maksimale	b1	I fiksuar nga njësia
	b2	I kufizuar nga instaluesi
Temperatura aktuale	c	E matur nga njësia
Temperatura e dëshiruar	d	Rrotulloni çelësin rrotullues të djathtë për ta rritur/ulur (për modalitetin Vetëm ringrohje).
Nënmenyja	e	Rrotulloni ose shtypni çelësin rrotullues të majtë për të shkuar te nënmenyja.

10.3.6 Pamja e detajuar e ekranit me vlerat



- a** Cilësimet
b Vlerat
c Cilësimi i zgjedhur dhe vlera

Shembull:



Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes listës së cilësimeve.
	Ndryshoni vlerën.
	Shkoni te cilësimi tjetër.
	Konfirmoni ndryshimet dhe vazhdoni më tej.

10.4 Vlerat e paracaktuara dhe programet

10.4.1 Përdorimi i vlerave të paracaktuara

Rreth vlerave të paracaktuara

Për disa cilësime në sistem, ju mund të vendosni vlera të paracaktuara. Juve ju nevojitet që t'i vendosni këto vlera të paracaktuara vetëm një herë, e më pas t'i ripërdorni këto vlera në ekranet e tjera, si për shembull ekranin e programimit. Nëse dëshironi ta ndryshoni më vonë vlerën, ju duhet ta bëni këtë gjë vetëm në një vend.

Vlerat e paracaktuara të mundshme

Ju mund të vendosni vlerat e paracaktuara të mëposhtme që konfigurohen nga përdoruesi:

Vlera e paracaktuar		Ku përdoret
Temperatura e synuar e depozitës, Modaliteti i funksionimit , Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë	[5.2] Setpointi i rehatisë	Ju mund t'i përdorni këto vlera të paracaktuara te [5.5] Planifikimi Orar (ekrani i programit javor për depozitën e DHW), nëse modaliteti i depozitës së DHW është një nga modalitetet më poshtë: ▪ Vetëm planifikim ▪ Programi + ringrohje
	[5.3] Setpointi ECO	
	[5.4] Setpointi i ringrohjes	Softueri përdor këtë vlerë të paracaktuar nëse modaliteti i depozitës së DHW është Programi + ringrohje
	[5.G] Modaliteti i funksionimit	Ju mund të zgjidhni dy lloje të përdorimit të ujit të ngrohtë sanitar, që lidhet me lejimin e rezistencës përforcuese: ▪ Efikas ▪ I shpejtë
	[5.H] Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë	Ky kohëmatës hyn në punë vetëm nëse opsioni "I shpejtë" zgjidhet si Modaliteti i funksionimit . Mund të zgjidhen tre kohëmatës të paracaktuara: ▪ Turbo (10 minuta) ▪ Normal (20 minuta) ▪ Ekonomik (30 minuta)

Përveç vlerave të paracaktuara që konfigurohen nga përdoruesi, sistemi përmban edhe disa vlera të paracaktuara që përcaktohen nga sistemi, të cilat mund t'i përdorni kur programoni programet.

Shembull: Te [7.4.2] **Cilësimet e përdoruesit > I qetë > Planifikimi Orar** (programi javor për rastin kur njësia duhet të përdorë një nga nivelet e modalitetit e qetë), ju mund të përdorni vlerat e paracaktuara të mëposhtme të përcaktuara nga sistemi: **I qetë/Më i qetë/I heshtur**.

10.4.2 Përdorimi dhe programimi i programeve

Rreth programeve

Në varësi të ndërtimit të sistemit dhe të konfigurimit nga instaluesi, mund të ofrohen programe për disa kontrolle.

Ju mund të...	Shihni...
Vendosni nëse një kontroll specifik duhet të hyjë në veprim sipas një programi.	"Ekran i aktivizimit" te "Programet e mundshme" [▶ 63]
Zgjidhni se cilin program dëshironi të përdorni aktualisht për një kontroll specifik. Sistemi përmban disa programe të parapërcaktuara. Ju mund të:	

Ju mund të...	Shihni...
Konsultohuni se cili program është zgjedhur aktualisht.	"Programi/Kontrolli" te "Programet e mundshme" [▶ 63]
Programoni programet tuaja individuale nëse programet e parapërcaktuara nuk janë sipas dëshirave tuaja. Veprimet që mund të programoni janë specifike sipas kontrollit.	"Veprimet e mundshme" te "Programet e mundshme" [▶ 63] "10.4.3 Ekran i programit: Shembull ilustrues" [▶ 64]

Programet e mundshme

Tabela përmban informacionin e mëposhtëm:

- **Programi/Kontrolli:** Kjo kolonë tregon se ku mund të konsultoheni për programin e zgjedhur aktualisht, për kontrollin specifik. Nëse nevojitet, ju mund të:
 - Programoni programet tuaja individuale. Shihni "10.4.3 Ekran i programit: Shembull ilustrues" [▶ 64].
- **Programet e parapërcaktuara:** (nëse ka) Programet e parapërcaktuara në sistem për kontrollin specifik. Nëse nevojitet, mund të programoni programet tuaja individuale.
- **Ekran i aktivizimit:** Për shumicën e kontrolleve, një program është efektiv vetëm nëse ai aktivizohet në ekranin e tij përkatës të aktivizimit. Kjo pikë ju tregon se ta aktivizoni atë.
- **Veprimet e mundshme:** Veprimet që mund të përdorni kur programoni një program.

Programi/Kontrolli	Përshkrimi
[5.5] Depozita > Planifikimi Orar Programi për temperaturën e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar, për nevojat tuaja normale për ujë të ngrohtë sanitar.	Programet e parapërcaktuara: Nuk përdoret Ekran i aktivizimit: Nuk përdoret. Ky program aktivizohet automatikisht nëse modaliteti i DHW është një nga modalitetet më poshtë: ▪ Vetëm planifikim ▪ Programi + ringrohje Veprimet e mundshme: ▪ Komforti: Kur të fillojë ngrohja e depozitës në vlerën e paracaktuar të konfiguruar nga përdoruesi [5.2] Setpointi i rehatisë. ▪ Ekonomik: Kur të fillojë ngrohja e depozitës në vlerën e paracaktuar të konfiguruar nga përdoruesi [5.3] Setpointi ECO. ▪ Ndalo: Kur të ndalojë ngrohja e depozitës, edhe nëse temperatura e dëshiruar e depozitës nuk është arritur ende. Shënim: Në modalitetin Programi + ringrohje, sistemi merr gjithashtu parasysh vlerën e paracaktuar të konfiguruar nga përdoruesi [5.4] Setpointi i ringrohjes.


Programi/Kontrolli	Përshkrimi
[5.F] Depozita > Planifikimi i prioritetit Program për njësinë e jashtme, për të përcaktuar prioritetin midis funksionimit të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar dhe ajrit të kondicionuar	Programet e parapërcaktuara: Uji i ngrohtë sanitar si prioritet për çdo muaj Ekrani i aktivizimit: Nuk përdoret. Ky program përdoret vetëm kur në njësinë e jashtme është lidhur më shumë se një njësi e brendshme (p.sh. 1 depozitë + njësi 1 A/C). Veprimet e mundshme: ▪ DHW : Nëse ka njëkohësisht kërkesa nga disa njësi të brendshme, njësia e jashtme do t'i japë prioritet prodhimit të ujit të ngrohtë sanitar. ▪ A/C : Nëse ka njëkohësisht kërkesa nga disa njësi të brendshme, njësia e jashtme do t'i japë prioritet funksionimit të ajrit të kondicionuar (ngrohje/ftohje).
[7.4.2] Cilësimet e përdoruesit > I qetë > Planifikimi Orar Program për rastin kur njësia duhet të përdorë një nga nivelet e modalitetit të qetësisë.	Programi i parapërcaktuar: Nuk përdoret Ekrani i aktivizimit: [7.4.1] Modaliteti (ofrohet vetëm për instaluesit). Veprimet e mundshme: Ju mund të përdorni vlerat e paracaktuara të mëposhtme të përcaktuara nga sistemi: ▪ Fikur ▪ I qetë ▪ Më i qetë ▪ I heshtur Shihni "Rreth modalitetit të qetë" [► 82].

10.4.3 Ekrani i programit: Shembull ilustrues

Ky shembull ju tregon si të vendosni një program për nxehjen e depozitës.

Për të programuar programin: përmbledhje

Shembull: Ju dëshironi të programoni programin e mëposhtëm:




- 1 Shkoni te programi.
- 2 (opsionale) Pastroni përmbajtjen e programit për të gjithë javën ose përmbajtjen e programit për një ditë të zgjedhur.
- 3 Programoni programin për ditën **E hënë**.
- 4 Kopjoni programin në ditët e tjera të javës.
- 5 Programoni programin për ditën **E shtunë** dhe kopjojeni atë në ditën **E diel**.


Për të shkuar te programi

1	Shkoni te [5.5]: Depozita > Planifikimi Orar.	
---	---	--


Për të pastruar përmbajtjen e programit javor


1	Zgjidhni emrin e programit aktual. 	
2	Zgjidhni Fshi. 	
3	Zgjidhni OK për ta konfirmuar.	

Për të pastruar përmbajtjen e programit të një dite



1	Zgjidhni ditën për të cilën dëshironi të pastroni përmbajtjen. Për shembull E premte 	
2	Zgjidhni Fshi. 	
3	Zgjidhni OK për ta konfirmuar.	



Për të programuar programin për ditën E hënë

1	Zgjidhni E hënë. 	
2	Zgjidhni Modifiko. 	



3	Përdorni çelësin rrotullues të majtë për të zgjedhur një pikë dhe modifikoni pikën me çelësin rrotullues të djathtë. Mund të programoni deri në 4 veprime çdo ditë.  Shënim: Për të pastruar një veprim, vendosni kohën e tij si kohë të veprimit të mëparshëm.	 
4	Konfirmoni ndryshimet. Rezultati: Përcaktohet programi për ditën e hënë. Vlera e veprimit të fundit është ende e vlefshme deri në veprimin e ardhshëm të programuar. Në këtë shembull, Monday/E hënë është dita e parë që keni programuar. Në këtë mënyrë, veprimi i fundit i programuar është i vlefshëm deri në veprimin e parë të së hënës së ardhshme.	

Për të kopjuar programin në ditët e tjera të javës

1	Zgjidhni E hënë. 	
2	Zgjidhni Kopjo.  Rezultati: Ngjitur me ditën e kopjuar shfaqet "C".	
3	Zgjidhni E martë. 	

4	Zgjidhni Ngjit.  Rezultati: 	
5	Përsëritni këtë veprim për të gjitha ditët e tjera të javës. 	—

Për të programuar programin për ditën E shtunë dhe për ta kopjuar atë në ditën E diel

1	Zgjidhni E shtunë.	
2	Zgjidhni Modifiko.	
3	Përdorni çelësin rrotullues të majtë për të zgjedhur një pikë dhe modifikoni pikën me çelësin rrotullues të djathtë. 	 
4	Konfirmoni ndryshimet.	
5	Zgjidhni E shtunë.	
6	Zgjidhni Kopjo.	
7	Zgjidhni E diel.	
8	Zgjidhni Ngjit. Rezultati: 	

10.5 Kurba në varësi të motit

10.5.1 Çfarë është kurba në varësi të motit?

Funksionimi në varësi të motit

Njësia funksionon "në varësi të motit", nëse temperatura e dëshiruar e përcaktuar përcaktohet automatikisht nga temperatura e jashtme. Nëse temperatura e jashtme bie ose rritet, njësia kompenson në moment. Në këtë mënyrë, njësia nuk i duhet të presë reagimin nga përdoruesi për të rritur ose për të ulur temperaturën e synuar të depozitës. Meqë ajo reagon më shpejt, kjo parandalon rritjet dhe rëniet e larta të temperaturës së ujit në rubineta.

Avantazhi

Funksionimi në varësi të motit zvogëlon konsumin e energjisë.

Kurba në varësi të motit

Që të jetë në gjendje të kompensojë diferencat në temperaturë, njësia mbështetet në kurbën e saj në varësi të motit. Kjo kurbë përcakton sesa e madhe duhet të jetë diferenca midis temperaturës së synuar të depozitës dhe temperaturave të jashtme. Meqenëse pjerrësia e kurbës varet nga rrethanat lokale të tilla si klima dhe izolimi i shtëpisë, kurba mund të përshtatet nga instaluesi.

Llojet e kurbës në varësi të motit

Ekzistojnë 2 lloje të kurbave në varësi të motit:

- Kurba me 2 pika
- Kurba pjerrësi-kompensim

Lloji i kurbës në të cilën dëshironit të bëni rregullime varet nga preferencat personale. Shihni "[10.5.4 Përdorimi i kurbave në varësi të motit](#)" [▶ 70].

Disponueshmëria

Kurba në varësi të motit disponohet për:

- Depozitën (ofrohet vetëm për instaluesit)



INFORMACION


Që funksionimi në varësi të motit të funksionojë, konfiguroni saktë vlerën e caktuar të depozitës. Shihni "[10.5.4 Përdorimi i kurbave në varësi të motit](#)" [▶ 70].

10.5.2 Kurba me 2 pika

Përcaktoni kurbën në varësi të motit me këto dy vlera të caktuara:

- Vlera e caktuar (X1, Y2)
- Vlera e caktuar (X2, Y1)

Shembull



Artikulli	Përshkrimi
X1, X2	Shembuj të temperaturës së jashtme të ambientit
Y1, Y2	Shembuj të temperaturës së dëshiruar të depozitës. Ikona korrespondon me emetuesin e nxehtësisë për atë zonë: ■ : Depozita e ujit të ngrohtë sanitar

Veprimet e mundshme në ekran	
	Kaloni përmes temperaturave.
	Ndryshoni temperaturën.
	Shkoni në temperaturën tjetër.
	Konfirmoni ndryshimet dhe vazhdoni më tej.

10.5.3 Kurba pjerrësi-kompensim


Pjerrësia dhe kompensimi

Përcaktoni kurbën në varësi të motit në varësi të pjerrësisë së saj dhe kompensimit:


- Ndryshoni **pjerrësinë** për të rritur ose për të ulur në mënyrë të ndryshme temperaturën e synuar të depozitës për temperatura ambientit të ndryshme. Për shembull, nëse temperatura e ujit të depozitës në përgjithësi është shumë e mirë, por në temperatura ambientit të ulëta ajo është shumë e ftohtë, rritni pjerrësinë në mënyrë që temperatura e depozitës të nxehet më shumë në temperatura ambientit që ulen më shumë.
- Ndryshoni **kompensimin** për të rritur ose për të ulur njëllëj temperaturën e synuar të depozitës për temperatura ambientit të ndryshme. Për shembull, nëse temperatura e depozitës është gjithmonë pak si e ftohtë për temperatura ambientit të ndryshme, ndryshoni kompensimin më lart, për ta rritur njëllëj temperaturën e synuar të depozitës për të gjitha temperaturat e ambientit.

Shembuj

Kurba në varësi të motit kur zgjidhet pjerrësia:



Kurba në varësi të motit kur zgjidhet kompensimi:



Artikulli	Përshkrimi
a	Kurba në varësi të motit përpara ndryshimeve.
b	Kurba në varësi të motit pas ndryshimeve (si shembull): - Kur ndryshohet pjerrësia, temperatura e re e preferuar në X1 është në mënyrë jo të barabartë më e lartë sesa temperatura e preferuar në X2. - Kur ndryshohet kompensimi, temperatura e re e preferuar në X1 është njëlloj më e lartë si temperatura e preferuar në X2.
c	Pjerrësia
d	Kompensimi
X1, X2	Shembuj të temperaturës së jashtme të ambientit
Y1, Y2, Y3, Y4	Shembuj të temperaturës së dëshiruar të depozitës. Ikona korrespondon me emetuesin e nxehtësisë për atë zonë: : Depozita e ujit të ngrohtë sanitar

Veprimet e mundshme në ekran	
	Zgjidhni pjerrësinë ose kompensimin.
	Rritni ose ulni pjerrësinë/kompensimin.
	Kur zgjidhet pjerrësia: vendosni pjerrësinë dhe shkoni te kompensimi. Kur zgjidhet kompensimi: vendosni kompensimin.
	Konfirmoni ndryshimet dhe kthehuni te nënmenyja.

10.5.4 Përdorimi i kurbave në varësi të motit

Konfiguroni kurbat në varësi të motit si më poshtë:

Për të përcaktuar modalitetin e vlerës së caktuar

Për të përdorur kurbën në varësi të motit, juve ju duhet të përcaktoni modalitetin e saktë të vlerës së caktuar:

Shkoni në modalitetin e vlerës së caktuar...	Vendosni modalitetin e vlerës së caktuar në...
Depozita	
[5.B] Depozita > Modaliteti i setpoint	Kufizim: Ofrohet vetëm për instaluesit. Në varësi të motit

Për të ndryshuar llojin e kurbës në varësi të motit

Për të ndryshuar llojin për depozitën, shkoni te [5.E] Depozita.

- [5.E] Depozita > Lloji i kurbës në varësi të motit

Kufizim: Ofrohet vetëm për instaluesit.

Për të ndryshuar kurbën në varësi të motit

Zona	Shkoni te...
Depozita	Kufizim: Ofrohet vetëm për instaluesit. [5.C] Depozita > Kurba në varësi të motit

**INFORMACION****Vlerat e caktuara maksimale dhe minimale**

Ju nuk mund ta konfiguroni kurbën me temperatura që janë më të larta ose më të ulëta se vlerat e caktuara maksimale dhe minimale, të vendosura për depozitën. Kur arrihet vlera e caktuar maksimale ose minimale, kurba drejtohet.

Për akordim të imët të kurbës në varësi të motit: kurba pjerrësi-kompensim

Tabela në vijim përshkruan sesi të bëni akordin e imët të kurbës në varësi të motit të depozitës:

Temperatura e ujit të ngrohtë sanitar është...		Akordimi i imët me pjerrësinë dhe kompensimin:	
Në temperatura të jashtme normale...	Në temperatura të jashtme të ftohta...	Pjerrësia	Kompensimi
OK	Ftohtë	↑	—
OK	Nxehtë	↓	—
Ftohtë	OK	↓	↑
Ftohtë	Ftohtë	—	↑
Ftohtë	Nxehtë	↓	↑
Nxehtë	OK	↑	↓
Nxehtë	Ftohtë	↑	↓
Nxehtë	Nxehtë	—	↓

Shihni "10.5.3 Kurba pjerrësi-kompensim" [▶ 69].

Për akordim të imët të kurbës në varësi të motit: kurba me 2 pika

Tabela në vijim përshkruan sesi të bëni akordin e imët të kurbës në varësi të motit të depozitës:

Temperatura e ujit të ngrohtë sanitar është...		Akordimi i imët me vlerat e caktuara:			
Në temperatura të jashtme normale...	Në temperatura të jashtme të ftohta...	Y2 ^(a)	Y1 ^(a)	X1 ^(a)	X2 ^(a)
OK	Ftohtë	↑	—	↑	—
OK	Nxehtë	↓	—	↓	—
Ftohtë	OK	—	↑	—	↑
Ftohtë	Ftohtë	↑	↑	↑	↑
Ftohtë	Nxehtë	↓	↑	↓	↑
Nxehtë	OK	—	↓	—	↓
Nxehtë	Ftohtë	↑	↓	↑	↓
Nxehtë	Nxehtë	↓	↓	↓	↓


^(a) Shihni "10.5.2 Kurba me 2 pika" [▶ 68].

10.6 Menyja e cilësimeve

Ju mund të vendosni cilësime shtesë duke përdorur ekranin e menysë kryesore dhe nënmenytë e saj. Cilësimet më të rëndësishme paraqiten këtu.

10.6.1 Funksionimi me defekt

Në rast defekti, në ekranin kryesor shfaqet  ose . Për të shfaqur kodin e gabimit, hapni pamjen e ekranit të menysë dhe shkoni te [0] **Defektet**. Shtypni ? për më shumë informacion rreth gabimit.




[0] Defektet

10.6.2 Depozita

Përmbledhje

Në nënmeny janë të renditura pikat e mëposhtme:



[5] Depozita

 Pamja e ekranit të vlerës së caktuar

[5.1] Funksionim i fuqishëm

[5.2] Setpointi i rehatisë

[5.3] Setpointi ECO

[5.4] Setpointi i ringrohjes

[5.5] Planifikimi Orar

[5.6] Mënyra e ngrohjes

[5.7] Dezinfektim

[5.8] Maksimumi

[5.9] Histerezia

[5.A] Histerezia

[5.B] Modaliteti i setpoint

[5.C] Kurba në varësi të motit

[5.D] Marzhi

[5.E] Lloji i kurbës në varësi të motit

[5.F] Planifikimi i prioritetit

[5.G] Modaliteti i funksionimit

[5.H] Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë

Pamja e ekranit të vlerës së caktuar për depozitën

Ju mund të vendosni temperaturën e ujit të ngrohtë sanitar duke përdorur pamjen e ekranit të vlerës së caktuar. Për më shumë informacion sesi ta bëni këtë, shihni "10.3.5 Pamja e ekranit të vlerës së caktuar" [▶ 60].

Funksionim i fuqishëm

Mund të përdorni funksionimin e fuqishëm për të filluar menjëherë nxehjen e ujit në vlerën e paracaktuar (**Setpointi i rehatisë**). Ky aktivizon së bashku pompën e nxehtësisë dhe rezistencën përforcuese elektrike, gjë e cila rezulton në konsum shtesë të energjisë. Nëse funksionimi i fuqishëm është aktiv, në ekranin kryesor shfaqet .

Për të aktivizuar funksionimin e fuqishëm

Aktivizoni ose çaktivizoni **Funksionim i fuqishëm** si më poshtë:

1	Shkoni te [5.1]: Depozita > Funksionim i fuqishëm	
2	Vendosni funksionimin e fuqishëm në Fikur ose Ndezur .	

Shembull përdorimi: juve ju nevojitet menjëherë ujë i ngrohtë

Nëse jeni në rrethanën e mëposhtme:

- Keni konsumuar shumicën e ujit të ngrohtë.
- Nuk mund të pritni deri në veprimin e programuar të radhës për të nxehur depozitën e ujit.

Atëherë mund të aktivizoni funksionimin e fuqishëm të depozitës së ujit të ngrohtë.

Avantazhi: Depozita e ruajtjes nxehet menjëherë deri në **Setpointi i rehatisë**.



INFORMACION

Nëse programi i prioritetit është vendosur te DHW (shihni Programi i prioritetit) dhe funksionimi i fuqishëm është aktiv, rreziku i problemeve të ajrit të kondicionuar (ngrohje/ftohje) dhe i komfortit nga mungesa e kapacitetit është i konsiderueshëm. Në rastin e përdorimit të shpeshtë të ujit të ngrohtë sanitar, do të ndodhin ndërprerje të shpeshta dhe të gjata të ajrit të kondicionuar (ngrohje/ftohje).

Setpointi i rehatisë

Vlen vetëm kur përgatitja e ujit të ngrohtë sanitar është me **Vetëm planifikim** ose **Programi + ringrohje**. Kur programoni programin, mund të përdorni vlerën e caktuar të komfortit si vlerë të paracaktuar. Nëse dëshironi ta ndryshoni më vonë vlerën e caktuar të ruajtjes, ju duhet ta bëni këtë gjë vetëm në një vend.

Depozita do të ngrohet derisa të arrihet **temperatura e komfortit e ruajtjes**. Është temperatura më e lartë e dëshiruar kur programohet veprimi i komfortit të ruajtjes.

Përveç kësaj, mund të programohet edhe ndalimi i ruajtjes. Kjo veçori vendos ndalimin e ngrohjes së depozitës, edhe nëse vlera e caktuar NUK është arritur. Programoni ndalimin e ruajtjes vetëm kur ngrohja e depozitës nuk dëshirohet në asnjë mënyrë.

#	Kodi	Përshkrimi
[5.2]	[6-0A]	Setpointi i rehatisë: ▪ 30°C~[6-0E]°C

Setpointi ECO

Temperatura ekonomike e ruajtjes përcakton temperaturën e ulët të dëshiruar të depozitës. Është temperatura e dëshiruar kur programohet veprimi i ruajtjes ekonomike (ndoshta gjatë ditës).

#	Kodi	Përshkrimi
[5.3]	[6-0B]	Setpointi ECO: ▪ 30°C~min(50,[6-0E])°C

Setpointi i ringrohjes

Temperatura e dëshiruar e ringrohjes së depozitës, e përdorur në modalitetin **Programi + ringrohje**, gjatë modalitetit të ringrohjes: temperatura minimale e garantuar depozitës vendoset nga **Setpointi i ringrohjes** minus

histerezinë e ringrohjes. Nëse temperatura e depozitës bie nën këtë vlerë, depozita do të nxehet.

#	Kodi	Përshkrimi
[5.4]	[6-0C]	Setpointi i ringrohjes: ▪ 30°C~min(50,[6-0E])°C

Planifikimi Orar

Ju mund të vendosni programin e temperaturës së depozitës duke përdorur pamjen e ekranit të programit. Për më shumë informacion rreth kësaj pamjeje të ekranit, shihni "10.4.3 Ekran i programit: Shembull ilustrues" [▶ 64].

Mënyra e ngrohjes

Uji i ngrohtë sanitar mund të përgatitet në 3 mënyra të ndryshme. Ato ndryshojnë nga njëra-tjetra nga mënyra sesi vendoset temperatura e dëshiruar e depozitës dhe si reagon njësia kundrejt kësaj.

#	Kodi	Përshkrimi
[5.6]	[6-0D]	Mënyra e ngrohjes: ▪ 0: Vetëm ringrohje : Lejohet vetëm veprimi i ringrohjes. ▪ 1: Programi + ringrohje : Depozita e ujit të ngrohtë sanitar ngrohet sipas një programi dhe midis cikleve të programuara të nxehjes, lejohet veprimi i ringrohjes. ▪ 2: Vetëm planifikim : Depozita e ujit të ngrohtë sanitar mund të ngrohet VETËM sipas një programi.

Shihni manualin e përdorimit për më shumë detaje.



INFORMACION

Nëse programi i prioritetit është vendosur te DHW (shihni Programi i prioritetit) dhe në të njëjtën kohë modaliteti i depozitës së DHW është vetëm ringrohje, rreziku për mungesë kapaciteti dhe probleme në komfort është i konsiderueshëm. Në rastin e funksionimit të shpeshtë të ringrohjes, funksioni i ngrohjes/ftohjes së hapësirës ndërpritet rregullisht.



INFORMACION

Aplikimi i histerezisë (sasia e rënies së temperaturës që do të aktivizojë nxehjen) mund të luhatet në varësi të faktit nëse temperatura e synuar është brenda diapazonit të funksionimit të njësive së jashtme.

Dezinfektim

Vlen vetëm për instalimet me depozitë të ujit të ngrohtë sanitar.


Funksioni i dezinfektimit dezinfekton depozitën e ujit të ngrohtë sanitar, duke e nxehur në mënyrë periodike ujin e ngrohtë sanitar deri në një temperaturë të veçantë.



KUJDES

Cilësimet e funksionit të dezinfektimit DUHEN konfiguruar nga instaluesi në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

#	Kodi	Përshkrimi
[5.7.1]	[2-01]	Aktivizimi: ▪ 0: Jo ▪ 1: Po
[5.7.2]	[2-00]	Dita e funksionimit: ▪ 0: Çdo ditë ▪ 1: E hënë ▪ 2: E martë ▪ 3: E mërkurë ▪ 4: E enjte ▪ 5: E premte ▪ 6: E shtunë ▪ 7: E diel
[5.7.3]	[2-02]	Ora e nisjes
[5.7.4]	[2-03]	Setpointi i depozitës: 55°C~maks(55, [6-0E])°C
[5.7.5]	[2-04]	Kohëzgjatja: 5~60 minuta



T_{DHW} Temperatura e ujit të ngrohtë sanitar
 T_U Temperatura e vlerës së caktuar nga përdoruesi
 T_H Temperatura e lartë e vlerës së caktuar [2-03]
 t Koha



PARALAJMËRIM

Mbani parasysh se temperatura e ujit të ngrohtë sanitar në rubinetin e ujit të ngrohtë do të jetë e barabartë me vlerën e zgjedhur në cilësimin e fushës [2-03] pas një operacioni dezinfektimi.

Kur temperatura e lartë e ujit të ngrohtë sanitar mund të jetë një rrezik i mundshëm për lëndim të personave, një valvul përzjerjeje (sigurohet në terren) duhet instaluar në lidhjen e daljes së ujit të ngrohtë në depozitën e ujit të ngrohtë sanitar. Kjo valvul përzjerjeje do të sigurojë që temperatura e ujit të ngrohtë në rubinetin e ujit të ngrohtë të rritet kurrë mbi një vlerë maksimale të caktuar. Kjo temperaturë maksimale e lejuar e ujit të ngrohtë duhet zgjedhur në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.



KUJDES

Sigurori që koha e fillimit të funksionit të dezinfektimit [5.7.3] me kohëzgjatje të përcaktuar [5.7.5] të MOS ndërpritet nga kërkesa e mundshme për ujë të ngrohtë sanitar.

**NJOFTIM**

Modaliteti i dezinfektimit. Edhe nëse e fikni funksionin e ngrohjes së depozitës ([C.3]: **Funksionimi > Depozita**), modaliteti i dezinfektimit do të mbetet aktiv. Megjithatë, nëse e fikni atë kur dezinfektimi është në proces, ndodh një gabim AH.

**INFORMACION**

Nëse shfaqet kodi i gabimit AH dhe nuk ka pasur asnjë ndërprerje të funksionit të dezinfektimit si rezultat i marrjes së ujit të ngrohtë sanitar nga çezma, rekomandohen veprimet e mëposhtme:

- Nëse zgjidhet modaliteti **Vetëm ringrohje** ose **Programi + ringrohje**, rekomandohet të programoni nisjen e funksionit të dezinfektimit të paktën 4 orë më vonë sesa tërheqja më e madhe e fundit e pritshme e ujit të ngrohtë në çezma. Kjo nisje mund të caktohet në cilësimet për instaluesin (funksioni i dezinfektimit).
- Nëse zgjidhet modaliteti **Vetëm planifikim**, rekomandohet të programoni veprimin **Ekonomik** 3 orë përpara nisjes së programuar të funksionit të dezinfektimit, për të nxehur paraprakisht depozitën.

**INFORMACION**

Funksioni i dezinfektimit fillon përsëri në rast se temperatura e ujit të ngrohtë sanitar bie 5°C nën temperaturën e synuar të dezinfektimit brenda kohës së kohëzgjatjes.

Vlera e caktuar e temperaturës maksimale të ujit të ngrohtë sanitar

Temperatura maksimale që përdoruesit mund të zgjedhin për ujin e ngrohtë sanitar. Ju mund të përdorni këtë cilësim për të kufizuar temperaturat në rubinetat e ujit të ngrohtë.

**INFORMACION**

Gjatë dezinfektimit të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar, temperatura e ujit të ngrohtë sanitar mund ta kalojë këtë temperaturë maksimale.

**INFORMACION**

Kufizoni temperaturën maksimale të ujit të ngrohtë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Histerezia (histerezia e pompës së nxehtësisë ndezur)

Përdoret kur përgatitja e ujit të ngrohtë sanitar bëhet me modalitetin vetëm ringrohje. Nëse temperatura e depozitës bie nën temperaturën e ringrohjes minus temperaturën e histerezisë së pompës së nxehtësisë ndezur, depozita nxehet deri në temperaturën e ringrohjes.

#	Kodi	Përshkrimi
[5.9]	[6-00]	Histerezia e pompës së nxehtësisë ndezur ▪ 2°C~20°C

Histerezia (histerezia e ringrohjes)

Përdoret kur përgatitja e ujit të ngrohtë sanitar bëhet me modalitetin Programim+ringrohje. Nëse temperatura e depozitës bie nën temperaturën e ringrohjes minus temperaturën e histerezisë së ringrohjes, depozita nxehet deri në temperaturën e ringrohjes.

#	Kodi	Përshkrimi
[5.A]	[6-08]	Histerezia e ringrohjes ▪ 2°C~20°C

**INFORMACION**

Për të garantuar funksionimin më optimal të njësisë së jashtme, ne rekomandojmë ta vendosni histerezinë në 6°C ose më lart.

**INFORMACION**

Nëse vlera e caktuar e ringrohjes është jashtë diapazonit të funksionimit të njësisë së jashtme, atëherë histerezia i referohet temperaturës më të lartë të arritshme nga puna e pompës së nxehtësisë.

Modaliteti i setpoint


#	Kodi	Përshkrimi
[5.B]	N/A	Modaliteti i setpoint: ▪ Fikse ▪ Në varësi të motit

Kurba në varësi të motit

Kur funksionimi në varësi të motit është aktiv, temperatura e synuar e depozitës përcaktohet automatikisht në varësi të temperaturës së jashtme mesatare: temperaturat e jashtme të ulëta do të rezultojnë në temperatura më të larta të dëshiruara të depozitës, sepse rubineti i ujit të ftohtë është më i ftohtë dhe anasjellas.

Në rastin e përgatitjes së ujit të ngrohtë sanitar me modalitetin **Vetëm planifikim** ose **Programi + ringrohje**, temperatura e komfortit e ruajtjes është në varësi të motit (sipas kurbës në varësi të motit), temperatura e ringrohjes dhe temperatura ekonomike e ruajtjes NUK janë në varësi të motit.

Në rastin e përgatitjes së ujit të ngrohtë sanitar me modalitetin **Vetëm ringrohje**, temperatura e dëshiruar e depozitës është në varësi të motit (sipas kurbës në varësi të motit). Gjatë funksionimit në varësi të motit, përdoruesi fundor nuk mund ta rregullojë temperaturën e dëshiruar të depozitës në ndërfaqen e përdoruesit. Shihni edhe "[10.5 Kurba në varësi të motit](#)" [▶ 68].


#	Kodi	Përshkrimi
[5.C]	[0-0E] [0-0D] [0-0C] [0-0B]	Kurba në varësi të motit: Shënim: Ekzistojnë 2 metoda për caktuar kurbën në varësi të motit. Shihni "10.5.2 Kurba me 2 pika" [▶ 68] dhe "10.5.3 Kurba pjerrësi-kompensim" [▶ 69] për më shumë informacion rreth llojeve të ndryshme të kurbave. Që të dyja llojet e kurbave kërkojnë konfigurimin e 4 cilësime të fushave sipas figurës më poshtë.  ▪ T_{DHW}: Temperatura e dëshiruar e depozitës. ▪ T_a: Temperatura (mesatare) e jashtme e ambientit ▪ [0-0E]: temperatura e ulët e jashtme e ambientit: $-40^{\circ}\text{C} \sim 5^{\circ}\text{C}$ ▪ [0-0D]: temperatura e lartë e jashtme e ambientit: $10^{\circ}\text{C} \sim 25^{\circ}\text{C}$ ▪ [0-0C]: temperatura e dëshiruar e depozitës kur temperatura e jashtme barazohet ose bie nën temperaturën e ulët të ambientit: $\text{Min}(45, [6-0E])^{\circ}\text{C} \sim [6-0E]^{\circ}\text{C}$ ▪ [0-0B]: temperatura e dëshiruar e depozitës kur temperatura e jashtme barazohet ose rritet mbi temperaturën e lartë të ambientit: $35^{\circ}\text{C} \sim [6-0E]^{\circ}\text{C}$

Marzhi

Në përdorimin e ujit të ngrohtë sanitar, për funksionimin e pompës së nxehtësisë mund të vendoset vlera e histerezisë më poshtë:

#	Kodi	Përshkrimi
[5.D]	[6-01]	Diferenca e temperaturës së përcakton temperaturën e fikjes së pompës së nxehtësisë. Diapazoni: $0^{\circ}\text{C} \sim 10^{\circ}\text{C}$

Shembull: vlera e caktuar (T_u) > temperatura maksimale e pompës së nxehtësisë – [6-01] ($T_{HP\ MAX} - [6-01]$)



BSH Rezistenca përforcuese

HP Pompa e nxehtësisë. Nëse koha e nxehtësisë nga pompa e nxehtësisë është shumë e gjatë, mund të ndodhë ngrohja ndihmëse nga rezistenca përforcuese, nëse është zgjedhur modaliteti Quick.

$T_{BSH\ OFF}$ Temperatura e fikjes së rezistencës përforcuese (T_U)

$T_{HP\ MAX}$ Temperatura maksimale e pompës së nxehtësisë në sensorin në depozitën e ujit të ngrohtë sanitar

$T_{HP\ OFF}$ Temperatura e fikjes së pompës së nxehtësisë ($T_{HP\ MAX} - [6-01]$)


$T_{HP\ ON}$ Temperatura e ndezjes së pompës së nxehtësisë ($T_{HP\ OFF} - [6-00]$) ose ($T_{HP\ OFF} - [6-08]$)

T_{DHW} Temperatura e ujit të ngrohtë sanitar

T_U Temperatura e vlerës së caktuar nga përdoruesi (që është vendosur në ndërfaqen e përdoruesit)

t Koha

Shembull: vlera e caktuar (T_U) ≤ temperatura maksimale e pompës së nxehtësisë – [6-01] ($T_{HP\ MAX} - [6-01]$)



HP Pompa e nxehtësisë. Nëse koha e nxehtësisë nga pompa e nxehtësisë është shumë e gjatë, mund të ndodhë ngrohja ndihmëse nga rezistenca përforcuese, nëse është zgjedhur modaliteti Quick.

$T_{HP\ MAX}$ Temperatura maksimale e pompës së nxehtësisë në sensorin në depozitën e ujit të ngrohtë sanitar

$T_{HP\ OFF}$ Temperatura e fikjes së pompës së nxehtësisë ($T_{HP\ MAX} - [6-01]$)

$T_{HP\ ON}$ Temperatura e ndezjes së pompës së nxehtësisë ($T_{HP\ OFF} - [6-00]$) ose ($T_{HP\ OFF} - [6-08]$)

T_{DHW} Temperatura e ujit të ngrohtë sanitar

T_U Temperatura e vlerës së caktuar nga përdoruesi (që është vendosur në ndërfaqen e përdoruesit)

t Koha



INFORMACION

Temperatura maksimale e pompës së nxehtësisë varet nga temperatura e ambientit. Për më shumë informacion, shihni diapazonin e funksionimit.

Lloji i kurbës në varësi të motit

Ekzistojnë 2 metoda për të përcaktuar kurbat në varësi të motit:

- 2 pika (shihni "10.5.2 Kurba me 2 pika" [▶ 68])
- Pjerrësi-Kompensim (shihni "10.5.3 Kurba pjerrësi-kompensim" [▶ 69])

Te [2.E] Lloji i kurbës në varësi të motit, mund të zgjidhni se cilën metodë dëshironi të përdorni.

Te [5.E] Lloji i kurbës në varësi të motit, metoda e zgjedhur shfaqet vetëm për lexim (e njëjta vlerë si te [2.E]).

#	Kodi	Përshkrimi
[2.E] / [5.E]	N/A	0: 2 pika 1: Pjerrësi-Kompensim

Programi i prioritetit

Në rastin e disa njësive të brendshme (p.sh. 1 depozitë, 1 kondicioner) Ky cilësim zgjedh funksionimin që duhet të ketë prioritet (mund të caktohet për çdo muaj) nga njësia e jashtme: Ujë i ngrohtë sanitar (DHW) ose Ajër i kondicionuar (A/C). Në varësi të prioritetit të zgjedhur njësi e jashtme mund të vendosë t'i mbulojë të dyja funksionimet së bashku (nuk është e mundur nëse A/C kërkon funksionim në ftohje) ose të kryejë vetëm një nga operacionet e kërkuara.

#	Kodi	Përshkrimi
[5.F]	[A-00]	Programi i prioritetit: 0: DHW 1: A/C

Nëse kërkesa e DHW dhe A/C ndodh në të njëjtën kohë, rezultatet e mundshme bazuar në cilësimet e prioritetit të programuar janë si më poshtë⁽¹⁾:

Nëse ...			Funksionimi i pompës së nxehtësisë =
Cili është prioriteti?	Kërkesa e A/C është ...	A i bën dot të dyja njësia e jashtme? ^(a)	...
DHW	Ftohje	-	DHW, kurse A/C vendoset në pritje
	Ngrohje	Po	DHW dhe A/C bashkë
		Jo	DHW, kurse A/C vendoset në pritje
A/C	Ftohje	-	A/C, kurse DHW realizohet nga rezistenca përforcuese
	Ngrohje	Po	DHW dhe A/C bashkë
		Jo	A/C, kurse DHW realizohet nga rezistenca përforcuese

^(a) Përcaktohet nga njësia e jashtme.

Modaliteti i funksionimit dhe kohëmatësi i modalitetit Quick

Gjatë prodhimit të ujit të ngrohtë sanitar (DHW), lejimi i rezistencës përforcuese⁽²⁾ mund të zgjidhet/kufizohet si më poshtë:

⁽¹⁾ *zbatohet kur temperatura e jashtme e ambientit dhe temperatura e synuar e depozitës janë brenda diapazonit të funksionimit të njësive së jashtme

⁽²⁾ Kur temperatura e ambientit dhe/ose temperatura e synuar është jashtë diapazonit të funksionimit të njësive së jashtme, rezistenca përforcuese lejohet gjithashtu të hyjë në punë, referohuni te "Funksionimi" [▶ 87].


#	Kodi	Përshkrimi
[5.G]	[A-01]	Programi i prioritetit: 0: Efikas: Rezistenca përforcuese është e ndaluar^(a), përveçse kur njësia e jashtme e ka të pamundur të prodhojë DHW (shih Programi i prioritetit) 1: I shpejtë: Rezistenca përforcuese lejohet të ndihmojë pompën e nxehtësisë gjatë prodhimit të DHW
[5.H]	[8-03]	Kur zgjidhet I shpejtë , rezistenca përforcuese mund të fillojë të ndihmojë funksionimin e pompës së nxehtësisë pas një kohe vonese. Koha e vonesës varet nga Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë i zgjedhur: Turbo (10 minuta) Normal (20 minuta) Ekonomik (30 minuta)

^(a) Kur dezinfektimi i depozitës kryhet me modalitetin **Efficient**, rezistenca përforcuese mund të nisët sërish pas 20 minutash për të ndihmuar pompën e nxehtësisë.

10.6.3 Cilësimet për përdoruesin

Përmbledhje

Në nënmeny janë të renditura pikat e mëposhtme:



[7] Cilësimet e përdoruesit

[7.1] Gjuha

[7.2] Ora/data

[7.3] Pushimet

[7.4] I qetë

Gjuha

#	Kodi	Përshkrimi
[7.1]	N/A	Gjuha

Ora/data

#	Kodi	Përshkrimi
[7.2]	N/A	Vendosni orën lokale dhe datën



INFORMACION

Në mënyrë të paracaktuar është e aktivizuar ora verore dhe formati i orës është i vendosur në format 24 orë. Këto cilësime mund të ndryshohen gjatë konfigurimit fillestar ose përmes strukturës së menysë [7.2]: **Cilësimet e përdoruesit > Ora/data**.

Pushimet

Rreth modalitetit të pushimeve

Gjatë pushimeve tuaja, ju mund të përdorni modalitetin e pushimeve për të devijuar nga programet normale, pa qenë nevoja t'i ndryshoni ato. Kur modaliteti i pushimeve është aktiv, funksioni i ujit të ngrohtë sanitar do të jetë i fikur. Operacioni i dezinfektimit do të mbetet aktiv.

Ngarkesa tipike e punës


Përdorimi i modalitetit të pushimeve në mënyrë tipike përbëhet nga fazat e mëposhtme:

- 1 Aktivizimi i modalitetit të pushimeve.
- 2 Vendosja e datës së fillimit dhe datës së mbarimit të pushimeve tuaja.

Për të kontrolluar nëse modaliteti i pushimeve është aktivizuar dhe/ose në punë

Nëse në ekranin kryesor është shfaqur , modaliteti i pushimeve është aktiv.

Për të konfiguruar pushimet

1	Aktivizoni modalitetin e pushimeve.	—
	Shkoni te [7.3.1]: Cilësimet e përdoruesit > Pushimet > Aktivizimi. 	
	Zgjidhni Ndezur.	
2	Vendosni ditën e parë të pushimeve.	—
	Shkoni te [7.3.2]: Nga.	
	Zgjidhni një datë.	 
	Konfirmoni ndryshimet.	
3	Vendosni ditën e fundit të pushimeve.	—
	Shkoni te [7.3.3]: Deri në.	
	Zgjidhni një datë.	 
	Konfirmoni ndryshimet.	

I qetë

Rreth modalitetit të qetë

Ju mund të përdorni modalitetin e qetë për të ulur zhurmën e njesisë së jashtme. Sidoqoftë, kjo ul gjithashtu kapacitetin e sistemit në ftohje/ngrohje. Ekzistojnë disa nivele të modalitetit të qetë.

Instaluesi mund të:

- Çaktivizojë plotësisht modalitetin e qetë
- Aktivizojë manualisht një nivel të modalitetit të qetë
- Caktojë përdoruesin të programojë një program të modalitetit të qetë

- Konfigurojë kufizimet në bazë të rregulloreve lokale

Nëse caktohet nga instaluesi, përdoruesi mund të programojë një program të modalitetit të qetë.



INFORMACION

Nëse temperatura e jashtme është nën zero, ne rekomandojmë të MOS përdorni nivelin më të qetë.

Për të kontrolluar nëse modaliteti i qetë është aktiv

Nëse në ekranin kryesor është shfaqur , modaliteti i qetë është aktiv.

Për të përdorur modalitetin e qetë

1	Shkoni te [7.4.1]: Cilësimet e përdoruesit > I qetë > Modaliteti.	
2	Kryeni një nga veprimet më poshtë:	—

Nëse përdoruesi dëshiron të...	Atëherë...	
Çaktivizojë plotësisht modalitetin e qetë	Zgjidhni Fikur . Rezultati: Njësia nuk punon asnjëherë në modalitetin e qetë. Përdoruesi nuk mund ta ndryshojë këtë.	
Aktivizojë manualisht një nivel të modalitetit të qetë	Zgjidhni Manuale .	
	Shkoni te [7.4.3] Niveli dhe zgjidhni nivelin e zbatueshëm të modalitetit të qetë. Shembull: I heshtur. Rezultati: Njësia punon gjithmonë në nivelin e zgjedhur të modalitetit të qetë. Përdoruesi nuk mund ta ndryshojë këtë.	
▪ Caktojë përdoruesin të programojë një program të modalitetit të qetë, DHE/OSE ▪ Konfigurojë kufizimet në bazë të rregulloreve lokale	Zgjidhni Automatike . Rezultati: ▪ Përdoruesi (ose ju) mund ta programoni programin te [7.4.2] Planifikimi Orar. Për më shumë informacion rreth programimit, shihni "10.4.3 Ekranin e programit: Shembull ilustrues" [▶ 64]. ▪ Kufizimet mund t'i konfiguroni te [7.4.4] Kufizimet. Shihni më poshtë. ▪ Rezultatet e mundshme për modalitetin e qetë ndryshojnë në varësi të programit (nëse është programuar) dhe në varësi të kufizimeve (nëse janë aktivizuar/përcaktuar). Shihni më poshtë.	

Për të konfiguruar kufizimet

1	Aktivizoni kufizimet. Shkoni te [7.4.4.1]: Cilësimet e përdoruesit > I qetë > Kufizimet > Aktivizo dhe zgjidhni Po .	
2	Përcaktoni kufizimet (koha + niveli) për t'u përdorur përpara mesditës (AM): [7.4.4.2] Koha e kufizuar AM Shembull: Nga ora 9 a.m. deri në orën 11 a.m. [7.4.4.3] Niveli i kufizuar AM Shembull: Më i qetë	
3	Përcaktoni kufizimet (koha + niveli) për t'u përdorur pas mesditës (PM): [7.4.4.4] Koha e kufizuar PM Shembull: Nga ora 3 p.m. deri në orën 7 p.m. [7.4.4.5] Niveli i kufizuar PM Shembull: I heshtur	


Rezultatet e mundshme kur modaliteti i qetë është vendosur në Automatike

Nëse...			Atëherë modaliteti i qetë =...
Kufizimet të aktivizuara?	Kufizimet të përcaktuara (koha + niveli)?	Programi i programuar?	
Jo	N/A	Jo	Fikur
		Po	Ndjek programin
Po	Jo	Jo	Fikur
		Po	Ndjek programin
	Po	Jo	Ndjek kufizimin
		Po	Gjatë kohës së kufizuar: Nëse niveli i kufizuar është më i rreptë se niveli i programuar, atëherë ndiqet kufizimi. Në rast tjetër, ndiqet programi. Jashtë kohës së kufizuar: Ndiqet programi.

10.6.4 Informacion

Përmbledhje

Në nënmeny janë të renditura pikat e mëposhtme:



[8] Informacion

[8.2] Historia e defekteve

[8.3] Informacioni i shitësit

[8.4] Sensorët

[8.5] Aktuatorët

[8.6] Modalitetet e funksionimit

[8.7] Rreth

[8.8] Statusi i lidhjes

[8.9] Orët e punës

[8.A] Rivendos

Informacioni i shitësit

Instaluesi mund të plotësojë këtu numrin e tij të kontaktit.

#	Kodi	Përshkrimi
[8.3]	N/A	Numri që përdoruesit mund të telefonojnë në rast problemesh.

Rivendos

Riktheni mbrapsht cilësimet e konfigurimit të ruajtura në MMI (ndërfaqja e përdoruesit e njësive së brendshme).

Shembull: Cilësimet e pushimeve.



INFORMACION

Kjo nuk rikthen mbrapsht cilësimet e konfigurimit dhe cilësimet e fushave të njësive së brendshme.

#	Kodi	Përshkrimi
[8.A]	N/A	Riktheni EEPROM të MMI ë cilësimet e paracaktuara nga fabrika

Informacioni i mundshëm për lexim


Në meny...	Ju mund të lexoni...
[8.2] Historia e defekteve	Historia e defekteve
[8.3] Informacioni i shitësit	Numri i kontaktit/sportelit të ndihmës
[8.4] Sensorët	Temperatura e jashtme, Temperatura e depozitës.
[8.5] Aktuatorët	Statusi/modaliteti i çdo aktuatori Booster heater
[8.6] Modalitetet e funksionimit	Modaliteti aktual i funksionimit Shembull: Modaliteti shkrirje/kthimi i vajit
[8.7] Rreth	Informacioni i versionit të sistemit

Në meny...	Ju mund të lexoni...
[8.8] Statusi i lidhjes	Informacioni rreth statusit të lidhjes së njësisë, termostetit të dhomës dhe Wi-Fi.
[8.9] Orët e punës	Orët e punës së komponentëve specifikë të sistemit

10.6.5 Cilësimet për instaluesin

Përmbledhje

Në nënmeny janë të renditura pikat e mëposhtme:



[9] Cilësimet e instaluesit

[9.1] Ndhmuesi i konfigurimit

[9.4] Rezistenca përforcuese

[9.5] Emergjencia

[9.9] Kontrolli i konsumit të energjisë

[9.E] Rindezja automatike

[9.F] Funksioni i kursimit të energjisë

[9.G] Çaktivizo mbrojtjet

[9.I] Përmbledhje e parametrave të vendosur

[9.N] Eksporto cilësimet e MMI

Ndhmuesi i konfigurimit

Në ndezjen e parë elektrike të sistemit, ndërfaqja e përdoruesit do t'ju orientojë duke përdorur ndhmuesin e konfigurimit. Në këtë mënyrë ju mund të vendosni cilësimet fillestare më të rëndësishme. Si rezultat, njësia do të jetë në gjendje të funksionojë si duhet. Pas kësaj, cilësimet më të detajuara mund të realizohen përmes strukturës së menysë, nëse nevojitet.

Për të rihapur ndhmuesin e konfigurimit, shkoni te **Cilësimet e instaluesit** > **Ndhmuesi i konfigurimit** [9.1].

Rezistenca përforcuese

Kapaciteti i rezistencës përforcuese

Kapaciteti i rezistencës përforcuese duhet vendosur, në mënyrë që funksioni i kontrollit të konsumit të energjisë të funksionojë si duhet. Kur matni vlerën e rezistencës së rezistencës përforcuese, mund të vendosni kapacitetin e saktë të rezistencës, dhe kjo do të rezultojë në të dhëna më të sakta për energjinë (p.sh. për kontrollin e konsumit të energjisë). Kapaciteti i rezistencës përforcuese të instaluar në depozitën e ujit të ngrohtë sanitar është 1,2 kW.

#	Kodi	Përshkrimi
[9.4.1]	[6-02]	Kapaciteti i rezistencës përforcuese [kW]. Kapaciteti i rezistencës përforcuese në tensionin nominal. Diapazoni: 0~10 kW

Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë

#	Kodi	Përshkrimi
[9.4.3]	[8-03]	Kohëmatësi i vonesës së rezistencës përforcuese. Koha e vonesës së ndezjes së rezistencës përforcuese kur modaliteti i ujit të ngrohtë sanitar nga pompa e nxehtësisë është aktiv dhe modaliteti i funksionimit të depozitës është I shpejtë, referohuni te "10.6.2 Depozita" [▶ 72]. - Kur modaliteti i ujit të ngrohtë sanitar nga pompa e nxehtësisë është aktiv dhe modaliteti i funksionimit të depozitës është I shpejtë, në mënyrë të paracaktuar koha e vonesës së ndezjes është 20 minuta. Përdoruesi fundor mund të zgjedhë 3 vlera të parapërcaktuara: 10, 20, ose 30 minuta, shihni Modaliteti i funksionimit, referohuni te "Modaliteti i funksionimit dhe kohëmatësi i modalitetit Quick" [▶ 80]. - Koha e vonesës nis në momentin që pompa e nxehtësisë fillon prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar. - Duke përshtatur kohën e vonesës së rezistencës përforcuese kundrejt kohës maksimale të punës, mund të gjeni një ekuilibër optimal midis efikasitetit të energjisë dhe kohës së nxehtësisë. - Nëse koha e vonesës së rezistencës përforcuese vendoset shumë e lartë, mund të duhet shumë kohë e gjatë derisa uji i ngrohtë sanitar të arrijë temperaturën e caktuar të tij. Diapazoni: 5~95 minuta. Nëse instaluesi vendos vlerat e [8-03] të ndryshme nga 3 vlerat e paracaktuara për përdoruesin fundor, ato do të shfaqen te Depozita > Kohëmatësi i modalitetit Quick si "vendosur nga instaluesi". Ne rekomandojmë të zgjidhni një nga vlerat e paracaktuara për përdoruesin fundor.

Funksionimi

#	Kodi	Përshkrimi
[9.4.4]	[4-03]	Përcakton lejen e funksionimit të rezistencës përforcuese në varësi të temperaturës së ambientit, temperaturës së ujit të ngrohtë sanitar ose të modalitetit të funksionimit të pompës së nxehtësisë.

#	Kodi	Përshkrimi
[9.4.4]	[4-03]	0 Kufizuar: Funksionimi i rezistencës përforcuese NUK lejohet, përveçse për "Funksioni i dezinfektimit" dhe "Ngrohja e fuqishme e ujit sanitar". Përdoreni këtë cilësim vetëm në rastin kur kapaciteti i pompës së nxehtësisë mund të mbulojë kërkesat për ngrohjen e shtëpisë dhe për ujë të ngrohtë sanitar gjatë gjithë sezonit të ngrohjes.
[9.4.4]	[4-03]	1 Lejohet: Funksionimi i rezistencës përforcuese lejohet kur është e nevojshme.
[9.4.4]	[4-03]	2 Mbivendosje: Rezistenca përforcuese lejohet jashtë diapazonit të funksionimit të pompës së nxehtësisë për funksionin e ujit të ngrohtë sanitar. Funksionimi i rezistencës përforcuese lejohet vetëm nëse: - Temperatura e ambientit është jashtë diapazonit të funksionimit: $T_a < -15\text{°C}$ ose $T_a > 42\text{°C}$ - Temperatura e ujit të ngrohtë sanitar është 2°C më e ulët se temperatura e fikjes së pompës së nxehtësisë.
9.4.4	[4-03]	3 Kompresori fikur: Rezistenca përforcuese lejohet kur pompa e nxehtësisë NUK është aktive në funksionin e ujit të ngrohtë sanitar. Njëlloj si cilësimi 1, por nuk lejohet funksionimi i njëkohshëm i funksionit të ujit të ngrohtë sanitar nga pompa e nxehtësisë dhe funksionimi i rezistencës përforcuese.

**INFORMACION**

Nëse vlera e zgjedhur te [4-03] është e ndryshme nga 1, modaliteti Quick nuk do të punojë, shihni Modaliteti i funksionimit, referohuni te "[Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë](#)" [▶ 87].

Emergjencia**Emergjencia**

Kur pompa e nxehtësisë nuk punon, rezistenca përforcuese mund të shërbejë si ngrohëse emergjence. Pas kësaj ajo merr përsipër peshën e ngrohjes ose automatikisht, ose përmes ndërhyrjes manuale.

- Kur **Emergjencia** është vendosur në **Automatike** dhe ndodh një prishje/defekt i pompës së nxehtësisë, rezistenca përforcuese në depozitë merr përsipër automatikisht prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar.

- Nëse **Emergjencia** është vendosur në **Manuale** dhe ndodh një prishje/defekt i pompës së nxehtësisë, nxehtësia e ujit të ngrohtë sanitar ndalon.

Për ta rikuperuar manualisht përmes ndërfaqes së përdoruesit, shkoni në ekranin e menysë kryesore **Defektet** dhe konfirmoni nëse rezistenca përforcuese mund ta marrë përsipër ose jo peshën e ngrohjes.

Për ta mbajtur të ulët konsumin e energjisë, ne rekomandojmë që **Emergjencia** të vendoset në **Manuale** nëse në shtëpi nuk ka njeri për periudha të gjata.

#	Kodi	Përshkrimi
[9.5.1]	[4-06]	0: Manuale 1: Automatike



INFORMACION

Cilësimi automatik i emergjencës mund të vendoset vetëm në strukturën e menysë të ndërfaqes së përdoruesit.



INFORMACION

Nëse ka avari në pompën e nxehtësisë dhe **Emergjencia** është vendosur në **Manuale**, funksioni i dezinfektimit do të aktivizohet VETËM nëse përdoruesi konfirmon funksionimin emergjent përmes ndërfaqes së përdorimit.

Kontrolli i konsumit të energjisë

Kontrolli i konsumit të energjisë

Shihni "**6 Udhëzimet e përdorimit**" [▶ 23] për informacione të detajuara rreth këtij funksionaliteti.

#	Kodi	Përshkrimi
[9.9.1]	[4-08]	Kontrolli i konsumit të energjisë: 0 Jo: Çaktivizuar. 1 I vazhdueshëm: Aktivizuar: Mund të vendosni një nga vlerat e kufizimit të fuqisë (në A ose kW) në të cilën konsumi i energjisë së sistemit do të jetë i kufizuar për të gjithë kohën.
[9.9.2]	[4-09]	Lloji: 0 Amp: Vlerat e kufizimit vendosen në A. 1 kW: Vlerat e kufizimit vendosen në kW.

Kufiri kur [9.9.1]=I vazhdueshëm dhe [9.9.2]=Amp:

#	Kodi	Përshkrimi
[9.9.3]	[5-05]	Kufiri: Zbatohet vetëm në rastin e modalitetit të kufizimit të rrymës gjatë gjithë kohës. 12 A~50 A

Kufiri kur [9.9.1]=I vazhdueshëm dhe [9.9.2]=kW:

#	Kodi	Përshkrimi
[9.9.8]	[5-09]	Kufiri: Zbatohet vetëm në rastin e modalitetit të kufizimit të fuqisë gjatë gjithë kohës. 3 kW~20 kW

Sensorët

Koha mesatare

Kohëmatësi mesatar korrigjon ndikimin e luhatjeve të temperaturës së ambientit. Llogaritja e vlerës së caktuar të funksionimit në varësi të motit bëhet bazuar në temperaturën e jashtme mesatare.

Temperatura e jashtme mesatarizohet për periudhën kohore të zgjedhur.

#	Kodi	Përshkrimi
[9.B.3]	[1-0A]	Koha mesatare: 0: Asnjë mesatarizim i temperaturës 1: 12 orë 2: 24 orë 3: 48 orë 4: 72 orë

Rindezja automatike

Rindezja automatike

Kur rikthehet energjia pas një ndërprerjeje të furnizimit me energji, funksioni i rindezjes automatike aplikon përsëri cilësimet e ndërfaqes së përdoruesit që ishin në kohën e ndërprerjes së energjisë. Për këtë arsye, rekomandohet që ta aktivizoni gjithmonë këtë funksion.

#	Kodi	Përshkrimi
[9.E]	[3-00]	Rindezja automatike: 0: Manuale 1: Automatike

Funksioni i kursimit të energjisë

Përcakton nëse furnizimi me energji i njësive së jashtme mund të ndërpritet (nga brenda nga njësia e brendshme) gjatë periudhave të ndalimit (kur nuk ka kërkesa për ajër të kondicionuar ose për ujë të ngrohtë sanitar). Vendimi përfundimtar për të lejuar ndërprerjen e energjisë së njësive së jashtme gjatë periudhës së ndalimit varet nga temperatura e ambientit, kushtet e kompresorit dhe kohëmatësit minimale të brendshëm.

Për të aktivizuar cilësimin e funksionit të kursimit të energjisë, [E-08] duhet aktivizuar në ndërfaqen e përdoruesit.

#	Kodi	Përshkrimi
[9.F]	[E-08]	Funksioni i kursimit të energjisë për njësinë e jashtme: 0: Jo 1: Po

Çaktivizimi i mbrojtjeve

Funksionet mbrojtëse

Njësia është e pajisur me funksionin mbrojtës të mëposhtëm:

- Dezinfektimi i depozitës [2-01]

#	Kodi	Përshkrimi
[9.G]	N/A	Çaktivizo mbrojtjet: ▪ 0: Jo ▪ 1: Po



INFORMACION

Funksionet mbrojtëse – "Modaliteti Instaluesi në vend". Softueri është i pajisur me funksione mbrojtëse, të tilla si dezinfektimi i depozitës. Njësia ekzekuton automatikisht këto funksione kur është e nevojshme.

Ky veprim nuk dëshirohet gjatë montimit ose shërbimit. Kështu që funksionet mbrojtëse mund të çaktivizohen:

- **Në ndezjen e parë elektrike:** Funksionet mbrojtëse janë të çaktivizuara në mënyrë të paracaktuar. Ato do të aktivizohen automatikisht pas 36 orësh.
- **Më pas:** Një instalues mund t'i çaktivizojë manualisht funksionet mbrojtëse nëpërmjet cilësimit [9.G]: **Çaktivizo mbrojtjet=Po**. Pas përfundimit të punës, ai mund t'i aktivizojë funksionet mbrojtëse nëpërmjet cilësimit [9.G]: **Çaktivizo mbrojtjet=Jo**.

Përmbledhje e cilësimeve të fushave

Pothuajse të gjitha cilësimet mund të bëhen duke përdorur strukturën e menysë. Nëse për ndonjë arsye nevojitet të ndryshohet një cilësim duke përdorur cilësimet e përgjithshme, atëherë hyni në cilësimet e përgjithshme si te [9.I] **Përmbledhje e parametrave të vendosur**. Shihni "[Për të modifikuar një cilësim të përgjithshëm](#)" [► 54].

Eksportimi i cilësimeve të MMI

Rreth eksportimit të cilësimeve të konfigurimit

Eksportoni cilësimet e konfigurimit të njësisë në një pajisje USB, nëpërmjet MMI (ndërfaqja e përdoruesit e njësisë së brendshme). Gjatë lokalizimit dhe zgjidhjes së problemeve, këto cilësime mund t'i jepen departamentit tonë të shërbimit.

#	Kodi	Përshkrimi
[9.N]	N/A	Cilësimet e MMI do të eksportohen në pajisjen ruajtëse të lidhur: ▪ Kthehu pas ▪ OK


Për të eksportuar cilësimet e MMI

1	Futni një pajisje USB në ndërfaqen e përdoruesit.	—
2	Në ndërfaqen e përdoruesit, shkoni te [9.N] Eksporto cilësimet e MMI.	
3	Zgjidhni OK.	
4	Hiqni pajisjen USB.	—
5	Mbyllni ndërfaqen e përdorimit.	—

10.6.6 Vënia në përdorim

Përmbledhje

Në nënmeny janë të renditura pikat e mëposhtme:

**[A] Vënia në përdorim**

[A.1] Prova e funksionimit


[A.2] Testi funksionimit të aktuatorëve

Rreth vënies në përdorim

Shihni: "11 Vënia në punë" [▶ 98]

10.6.7 Profili i përdoruesit

[B] Profili i përdoruesit: shihni "Ndryshimi i nivelit të autorizimit të përdoruesit" [▶ 53].

**[B] Profili i përdoruesit**

10.6.8 Funksionimi

Përmbledhje

Në nënmeny janë të renditura pikat e mëposhtme:



[C] Funksionimi

[C.3] Depozita

Për të aktivizuar ose për të çaktivizuar funksionet

Në menynë e funksionimit, mund të aktivizoni ose të çaktivizoni më vete funksionet e njësisë.

#	Kodi	Përshkrimi
[C.3]	N/A	Depozita: 0: Fikur 1: Ndezur

10.6.9 Wi-Fi




INFORMACION

Kufizim: Cilësimet e Wi-Fi janë të dukshme vetëm kur në ndërfaqen e përdoruesit është futur një kartë e Wi-Fi.

Përmbledhje

Në nënmeny janë të renditura pikat e mëposhtme:



[D] Portë Wireless

[D.1] Aktivizo modalitetin AP

[D.2] Rindiz

[D.3] WPS

[D.4] Hiq nga re-ja (cloud)


[D.5] Lidhja me rrjetin e shtëpisë

[D.6] Lidhja me re-në (cloud)

Rreth kartës së Wi-Fi

Karta e Wi-Fi lidh sistemin me internetin. Përdoruesi mund ta kontrollojë më pas sistemin nëpërmjet aplikacionit ONECTA.

Kjo kërkon komponentët e mëposhtëm:



a	Karta e Wi-Fi	Karta e Wi-Fi nevojitet për t'u futur në ndërfaqen e përdoruesit. Shihni manualin e instalimit të kartës së Wi-Fi.
b	Ruteri	Sigurohet në terren.
c	Smartfoni + aplikacioni 	Nevojitet që aplikacioni ONECTA të instalohet në smartfonin e përdoruesit. Shihni: http://www.onlinecontroller.daikineurope.com/ 

Konfigurimi

Për të konfiguruar aplikacionin ONECTA ndiqni udhëzimet e aplikacionit. Teksa e bëni këtë, në ndërfaqen e përdorimit nevojiten veprimet dhe informacionet ([D.1]~[D.6]) e mëposhtme:

[D.1] **Aktivizo modalitetin AP:** Bëjeni modulën WLAN aktiv si pikëhyrje.

#	Kodi	Përshkrimi
[D.1]	N/A	Ky cilësim gjeneron një SSID dhe çelës të rastësishëm (+ kod QR) të nevojshëm nga aplikacioni ONECTA: D.1 Modaliteti AP u aktivizua  SSID DaikinAPXXXXX Kodi XYZ12345 Ky ekran del automatikisht pas 10 minutash ose kur shtypni  ose  (dhe konfirmoni): Je i sigurt që dëshiron të dalësh nga modaliteti AP? Kthehu pas OK

[D.2] **Rindiz:** Rindizni modulën e Wi-Fi.

#	Kodi	Përshkrimi
[D.2]	N/A	Rindiz ruterin: ▪ Kthehu pas ▪ OK

[D.3] **WPS:** Lidhni modulën e Wi-Fi me ruterin.

#	Kodi	Përshkrimi
[D.3]	N/A	WPS: - Jo - Po

**INFORMACION**

Ju mund ta përdorni këtë funksion vetëm nëse ai mbështetet nga versioni i softuerit i Wi-Fi dhe versioni i softuerit i aplikacionit ONECTA.

[D.4] **Hiq nga re-ja (cloud):** Hiqni modulën e Wi-Fi nga reja kompjuterike.

#	Kodi	Përshkrimi
[D.4]	N/A	Hiq nga re-ja (cloud): - Jo - Po


[D.5] **Lidhja me rrjetin e shtëpisë:** Lexoni statusin e lidhjes në rrjetin e shtëpisë.

#	Kodi	Përshkrimi
[D.5]	N/A	Lidhja me rrjetin e shtëpisë: - U shkëput nga [WLAN_SSID] - U lidh me [WLAN_SSID]

[D.6] **Lidhja me re-në (cloud):** Lexoni statusin e lidhjes në re-në kompjuterike.

#	Kodi	Përshkrimi
[D.6]	N/A	Lidhja me re-në (cloud): - Jo i lidhur - I lidhur

10.7 Struktura e menysë: Përmbledhje e cilësimeve për përdoruesin




- Pamja e ekranit të vlerës së caktuar
- (*) Vlen vetëm kur modaliteti Operation është Quick
- (**) Mund të aksesohet vetëm nga instaluesi
- (***) Vlen vetëm kur është instaluar Wi-Fi

**INFORMACION**

Në varësi të cilësimeve të zgjedhura për instaluesin dhe të llojit të njësisë, cilësimet mund të jenë të dukshme/të padukshme.

10.8 Struktura e menysë: Përmbledhje e cilësimeve për instaluesin



(*) NUK mund të rregullohet



INFORMACION

Në varësi të cilësimeve të zgjedhura për instaluesin dhe të llojit të njësisë, cilësimet mund të jenë të dukshme/të padukshme.

11 Vënia në punë



NJOFTIM

Lista e plotë e komisionimit të përgjithshëm. Përkrah udhëzimeve të komisionimit në këtë kapitull, disponohet gjithashtu një listë e plotë e komisionimit të përgjithshëm në Daikin Business Portal (kërkohe vërtetimi).

Lista e plotë e komisionimit të përgjithshëm është plotësuese e udhëzimeve në këtë kapitull dhe mund të përdoret si udhëzim dhe shabllon raportimi gjatë komisionimit dhe dorëzimit te përdoruesi.



INFORMACION

Funksionet mbrojtëse – "Modaliteti Instaluesi në vend". Softueri është i pajisur me funksione mbrojtëse, të tilla si dezinfektimi i depozitës. Njësia ekzekuton automatikisht këto funksione kur është e nevojshme.

Ky veprim nuk dëshirohet gjatë montimit ose shërbimit. Kështu që funksionet mbrojtëse mund të çaktivizohen:

- **Në ndezjen e parë elektrike:** Funksionet mbrojtëse janë të çaktivizuara në mënyrë të paracaktuar. Ato do të aktivizohen automatikisht pas 36 orësh.
- **Më pas:** Një instalues mund t'i çaktivizojë manualisht funksionet mbrojtëse nëpërmjet cilësimit [9.G]: **Çaktivizo mbrojtjet=Po**. Pas përfundimit të punës, ai mund t'i aktivizojë funksionet mbrojtëse nëpërmjet cilësimit [9.G]: **Çaktivizo mbrojtjet=Jo**.

Shihni edhe "[Funksionet mbrojtëse](#)" [▶ 91].

Në këtë kapitull

11.1	Pamja e përgjithshme: Autorizimi.....	98
11.2	Masat paraprake kur jep autorizim.....	98
11.3	Lista e plotë para komisionimit	99
11.4	Lista e plotë gjatë komisionimit	100
11.4.1	Prova e funksionimit të aktuatorit.....	100
11.4.2	Prova e funksionimit	100

11.1 Pamja e përgjithshme: Autorizimi

Ky kapitull përshkruan çfarë duhet të bëni dhe dini për të vënë në punë sistemin pas instalimit dhe konfigurimit.

Ngarkesa tipike e punës

Zakonisht komisionimi kalon në këto faza:

- 1 Kontrolli i "Lista e kontrollit përpara vënies në përdorim".
- 2 Kryerja e një prove funksionimi të sistemit.
- 3 Nëse nevojitet, kryerja e një prove funksionimi për një ose më shumë aktuatorë.

11.2 Masat paraprake kur jep autorizim



NJOFTIM

GIJTHMONË përdorni njësine me rezistorët elektrikë dhe/ose sensorët/çelësat e presionit. Nëse JO, mund të ndodhë djegia e kompresorit.

**NJOFTIM**

GIJTHMONË kompletini tubacionin e ftohësit të njësisë para se ta operoni. Nëse JO, kompresori do të priset.

**INFORMACION**

Gjatë periudhës së funksionimit të parë të njësisë, energjia e kërkuar mund të jetë më e lartë se ajo e konstatuar në pllakën e markës së njësisë. Ky fenomen është shkaktuar nga kompresori, i cili ka nevojë për një kohë të vazhdueshme funksionimi prej 50 orësh para arritjes së operimit normal dhe konsumimit të qëndrueshëm të energjisë.

11.3 Lista e plotë para komisionimit

- 1 Pas instalimit të njësisë, kontrolloni artikujt e renditur më poshtë.
- 2 Mbyllni njësinë.
- 3 Ndizni njësinë.

☐	Lexo udhëzimet e instalimit të plotë, siç përshkruhen në udhëzuesin e instaluesit të referimit .
☐	Njësia e brendshme është e montuar si duhet.
☐	Njësia e jashtme është montuar siç duhet.
☐	Instalimet elektrike në vend në vijim realizohen në përputhje me këtë dokument dhe me legjislacionin e zbatueshëm: ▪ Midis panelit lokal të furnizimit dhe njësisë së jashtme ▪ Midis njësisë së brendshme dhe njësisë së jashtme ▪ Midis panelit lokal të furnizimit dhe njësisë së brendshme
☐	Sistemi është tokëzuar siç duhet dhe terminalet e tokëzimit janë shtrënguar.
☐	Siguresat ose pajisjet e mbrojtjes të instaluara lokalisht vendosen në përputhje me këtë dokument dhe NUK kanë kaluar në rrugë anësore.
☐	Voltazhi i furnizimit me energji elektrike përputhet me voltazhin në etiketën identifikuese të njësisë.
☐	NUK ka lidhje të lira ose përbërës të dëmtuar elektrikë në kutinë e çelësit.
☐	NUK ka përbërës të dëmtuar ose tuba të ngjeshur në pjesën e brendshme të njësive të brendshme dhe jashtme.
☐	Automati i rezistencës përforcuese F2B (sigurohet në terren) është i ndezur.
☐	NUK ka rrjedhje të ftohësit .
☐	Tubat e ftohësit (të gazit dhe lëngut) janë të izoluar termikisht.
☐	Madhësia e duhur e tubit instalohet dhe tubat izolohehen siç duhet.
☐	Nuk ka ASNJË rrjedhje uji brenda njësisë së brendshme.
☐	Valvulat mbyllëse (të gazit dhe lëngut) në njësinë e jashtme dhe të brendshme janë plotësisht të hapura.
☐	Depozita e ujit të ngrohtë sanitar është mbushur plot.

11.4 Lista e plotë gjatë komisionimit

☐	Kryerja e një testimi të aktivizuesit .
☐	Kryerja një testimi .

11.4.1 Prova e funksionimit të aktuatorit

Qëllimi

Kryeni një provë funksionimi të aktuatorit për të konfirmuar funksionimin e aktuatorëve të ndryshëm. Për shembull, kur zgjidhni **Rezistenca përforcuese**, do të nisë një provë e rezistencës përforcuese.

Për të kryer një provë të aktuatorit

Kushtet: Sigurohuni që i gjithë funksionimi është i çaktivizuar. Shkoni te [C]: **Funksionimi** dhe çaktivizoni funksionin **Depozita**.

1	Vendosni nivelin e autorizimit të përdoruesit në Installer. Shihni " Ndryshimi i nivelit të autorizimit të përdoruesit " ► 53].	—
2	Shkoni te [A.2]: Vënia në përdorim > Testi funksionimit të aktuatorëve .	
3	Zgjidhni Rezistenca përforcuese .	
4	Zgjidhni OK për ta konfirmuar. Rezultati: Do të fillojë procesi i testimit të aktuatorit. Ai ndalon automatikisht kur të jetë gati (±30 min). Për të ndaluar manualisht provën e funksionimit:	
1	Në meny, shkoni te Ndalo provën e funksionimit .	
2	Zgjidhni OK për ta konfirmuar.	

Provat e mundshme për aktuatorët

- Testimi i rezistencës përforcuese

11.4.2 Prova e funksionimit

Qëllimi

Kryeni prova funksionimi të njësive dhe monitoroni temperaturën e depozitës për të kontrolluar nëse njësia po punon si duhet. Provat testuese që duhen kryer janë:

- Depozita

Për të kryer një provë funksionimi

Kushtet: Sigurohuni që i gjithë funksionimi është i çaktivizuar. Shkoni te [C]: **Funksionimi** dhe çaktivizoni funksionin **Depozita**.

Për të monitoruar temperaturat e depozitës

Gjatë procesit të provës, funksionimi i duhur i njësive mund të kontrollohet duke monitoruar temperaturën e depozitës (modaliteti i ujit të ngrohtë sanitar).

Për të monitoruar temperaturat:

1	Në meny, shkoni te Sensorët .	
2	Zgjidhni informacionin e temperaturës.	

1	Vendosni nivelin e autorizimit të përdoruesit në Instaluesi . Shihni " Ndryshimi i nivelit të autorizimit të përdoruesit " [▶ 53].	—
2	Shkoni te [A.1]: Vënia në përdorim > Prova e funksionimit .	
3	Zgjidhni Depozita .	
4	Zgjidhni OK për ta konfirmuar. Rezultati: Do të fillojë procesi i testimit. Ai ndalon automatikisht kur të jetë gati (± 30 min). Për të ndaluar manualisht provën e funksionimit:	
1	Në meny, shkoni te Ndalo provën e funksionimit .	
2	Zgjidhni OK për ta konfirmuar.	

**INFORMACION**

Nëse temperatura e jashtme është jashtë diapazonit të funksionimit, njësia mund të MOS punojë ose të MOS ofrojë kapacitetin e kërkuar.

12 Kthimi te përdoruesi

Pasi të përfundojë ekzekutimi i provës dhe njësia funksionon siç duhet, sigurohuni që sa vijon është e qartë për përdoruesin:

- Plotësoni tabelën e cilësimeve për instaluesin (në manualin e përdorimit) me cilësimet aktuale.
- Sigurohuni që përdoruesi ka dokumentacionin e printuar dhe kërkojini atij ta ruajë atë për referencë në të ardhmen. Informoni përdoruesin se ai mund ta gjejë dokumentacionin e plotë në URL-në e përmendur më herët në këtë manual.
- Shpjegojini përdoruesit si ta përdorë siç duhet sistemin dhe çfarë të bëjë në rast të problemeve.
- Tregojani përdoruesit çfarë të bëjë për mirëmbajtjen e njësisë.
- Sqaroni këshillat mbi kursimin e energjisë për përdoruesin siç përshkruhet te manuali i përdorimit.

13 Mirëmbajtja dhe shërbimi



NJOFTIM

Lista e plotë e mirëmbajtjes/inspektimit të përgjithshëm. Përkrah udhëzimeve të mirëmbajtjes në këtë kapitull, disponohet gjithashtu një listë e plotë e mirëmbajtjes/inspektimit të përgjithshëm në Daikin Business Portal (kërkohet vërtetimi).

Lista e plotë e mirëmbajtjes/inspektimit të përgjithshëm është plotësuese e udhëzimeve në këtë kapitull dhe mund të përdoret si udhëzim dhe shabllon raportimi gjatë mirëmbajtjes.



NJOFTIM

Mirëmbajtja DUHET të kryhet nga një instalues i autorizuar ose agjent shërbimi.

Ne rekomandojmë kryerjen e mirëmbajtjes të paktën një herë në vit. Megjithatë, legjislacioni në fuqi mund të kërkojë intervale më të shkurtra të mirëmbajtjes.



NJOFTIM

Legjislacioni në fuqi për **gazrat serë me fluor** kërkon që ngarkimi i ftohësit të njësive të tregohet si në peshë ashtu edhe në ekuivalentin CO₂.

Formula për të llogaritur sasinë në tonet ekuivalente të CO₂: Vlera GWP e ftohësit × Ngarkesa totale e ftohësit [në kg] / 1000

Në këtë kapitull

13.1	Masat paraprake të sigurisë së mirëmbajtjes	103
13.2	Mirëmbajtja vjetore	103
13.2.1	Mirëmbajtja vjetore e njësive së brendshme: përmbledhje	103
13.2.2	Mirëmbajtja vjetore e njësive së brendshme: udhëzimet	104
13.3	Për të zbratur depozitën e ujit të ngrohtë sanitar	105

13.1 Masat paraprake të sigurisë së mirëmbajtjes



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI



NJOFTIM: Rrezik shkarkimi elektrostatik

Para kryerjes së ndonjë mirëmbajtjeje apo pune shërbimi, prekni një pjesë metalike të njësive në mënyrë që të eliminoni elektricitetin statik dhe të mbronj PCB.

13.2 Mirëmbajtja vjetore

13.2.1 Mirëmbajtja vjetore e njësive së brendshme: përmbledhje

- Valvula e çlirimit të presionit të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar
- Kutia shpërndarëse
- Rezistenca përforcuese e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar
- Anoda

13.2.2 Mirëmbajtja vjetore e njësive të brendshme: udhëzimet

Valvula e çlirimit të presionit të depozitës së ujit të ngrohtë sanitar (sigurohet në terren)

Hapni valvulën.

**KUJDES**

Uji që del nga jashtë nga valvula mund të jetë shumë i nxehtë.

- Kontrolloni që asgjë të mos bllokojë ujin në valvul ose në tubacionin e ndërmjetëm. Rrjedha e ujit që del nga valvula e shkarkimit duhet të jetë mjaftueshëm e lartë.
- Kontrolloni nëse uji që del nga valvula e shkarkimit është i pastër. Nëse ai përmban mbeturina ose papastërti:
 - Hapni valvulën derisa uji i shkarkuar të mos përmbajë më mbeturina ose papastërti.
 - Shpëlani dhe pastroni të gjithë depozitën, duke përfshirë tubacionin midis valvulës së shkarkimit dhe hyrjes së ujit të ftohtë.

Për t'u siguruar që ky ujë vjen nga depozita, kontrolloni pas një cikli të nxehtësie së depozitës.

**INFORMACION**

Rekomandohet që ta këtë mirëmbajtje ta kryeni më shumë se një herë në vit.

Kutia shpërndarëse

- Kryeni një kontroll vizual tërësor të kutisë shpërndarëse dhe shikoni për defekte të dukshme të tilla si lidhjet e liruara ose telat me defekt.
- Duke përdorur një matës rezistence, kontrolloni nëse kontaktori K3M punon si duhet. Të gjitha kontaktet e këtij kontaktori duhet të jenë në pozicionin hapur kur energjia është e fikur.

**PARALAJMËRIM**

Nëse instalimi i brendshëm elektrik është dëmtuar, ai duhet zëvendësuar nga prodhuesi, agjenti i tij i shërbimit ose persona me kualifikim të ngjashëm.

Rezistenca përforcuese e depozitës së ujit të ngrohtë sanitar

Rekomandohet që hiqni bigorin e formuar në rezistencën përforcuese për të rritur jetëgjatësinë e saj, në veçanti në rajonet me ujë të fortë. Për ta bërë këtë, zbrazi depozitën e ujit të ngrohtë sanitar, hiqni rezistencën përforcuese nga depozita e ujit të ngrohtë sanitar dhe zhyteni në një kovë (ose diçka të ngjashme) me produkt për largimin e bigorrit, për 24 orë.

**NJOFTIM**

Guarnicioni i rezistencës përforcuese duhet ndërruar pas çdo kontrolli. Shtrëngoni vidat e rezistencës përforcuese me një forcë shtrëngimi 10 N•m.

Anoda

Për të kontrolluar integritetin e anodës së magnezit, zbrazi depozitën e ujit të ngrohtë sanitar, hiqni rezistencën përforcuese nga depozita e ujit të ngrohtë sanitar dhe kontrolloni anodën. Nëse korrozioni ka prekur më shumë se 2/3 e sipërfaqes së anodës, ndërroni anodën.

**NJOFTIM**

Guarnicioni i rezistencës përforcuese duhet ndërruar pas çdo kontrolli. Shtrëngoni vidat e rezistencës përforcuese me një forcë shtrëngimi 10 N•m.

13.3 Për të zbrazur depozitën e ujit të ngrohtë sanitar

**RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI**

Uji brenda në depozitë mund të jetë shumë i nxehtë.


Kushti paraprak: Ndaloni funksionimin e njësisë përmes ndërfaqes së përdoruesit.

Kushti paraprak: Fikni automatën elektrik përkatës.

Kushti paraprak: Mbyllni furnizimin me ujë të ftohtë.

Kushti paraprak: Hapni të gjitha pikat e marrjes së ujit të ngrohtë për të lejuar futjen e ajrit në sistem.

- 1 Hiqni lidhjen e hyrjes së ujit dhe uji do të rrjedhë jashtë depozitës.



- a DHW – Dalja e ujit të ngrohtë (lidhja e filetuar, ½")
- b DHW – Hyrja e ujit të ftohtë (lidhja e filetuar, ½")

14 Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve

Në këtë kapitull

14.1	Pamje e përgjithshme: Zgjidhja e problemeve	106
14.2	Masat paraprake kur zgjidhni problemet.....	106
14.3	Zgjidhja e problemeve bazuar në simptoma.....	107
14.3.1	Simptoma: Uji i ngrohtë NUK arrin temperaturën e dëshiruar.....	107
14.3.2	Simptoma: Presioni në pikën e marrjes së ujit është përkohësisht jashtëzakonisht i lartë	107
14.3.3	Simptoma: Funkcioni i dezinfektimit të depozitës NUK përfundon si duhet (gabim AH)	107
14.4	Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimit	107
14.4.1	Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti	108
14.4.2	Kodet e gabimeve: Përmbledhje	108

14.1 Pamje e përgjithshme: Zgjidhja e problemeve

Ky kapitull përshkruan se çfarë duhet të bëni në rast problemesh.

Ai përmban informacione për sa më poshtë:

- Zgjidhja e problemeve bazuar te simptomat
- Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimeve

Para zgjidhjes së problemeve

Kryeni një inspektim vizual tërësor të njësisë dhe kërkonit të gjeni defekte të dukshme siç janë lidhjet e lira ose instalimet e dëmtuara elektrike.

14.2 Masat paraprake kur zgjidhni problemet



RREZIK: RREZIK VRASJEJE NGA GODITJA ELEKTRIKE



RREZIK: RREZIK DJEGIEJE//PËRVËLIMI



PARALAJMËRIM

- Kur kryeni një inspektim të kutisë së çelësit të njësisë, GJITHMONË sigurohuni që njësia është e shkëputur nga tubat kryesorë. Fikni çelësin përkatës.
- Kur aktivizohet një pajisje sigurie, ndalni njësinë dhe gjeni pse pajisja e sigurisë u aktivizua para rivendosjes. KURRË mos spostoni pajisjet e sigurisë apo të ndryshoni vlerat e tyre me një vlerë ndryshe nga ajo e cilësimit të parazgjedhjes nga fabrika. Nëse nuk arrini të gjeni shkakun e problemit, telefononi distributorin tuaj.



PARALAJMËRIM

Parandaloni rreziqet të shkaktuara nga rivendosja e shkujdesur e çelësit automatik termal: kjo aparaturë NUK DUHET të sigurohet përmes një pajisjeje të jashtme suiçing, siç është kohëmatësi, ose e lidhur me një qark që rregullisht NDIZET dhe FIKET nga shërbimi.

14.3 Zgjidhja e problemeve bazuar në simptoma

14.3.1 Simptoma: Uji i ngrohtë NUK arrin temperaturën e dëshiruar

Shkaqet e mundshme	Veprimi korrigjues
Një nga sensorët e temperaturës së depozitës është prishur.	Shihni manualin e shërbimit të njësisë për veprimin përkatës të korrigjimit.

14.3.2 Simptoma: Presioni në pikën e marrjes së ujit është përkohësisht jashtëzakonisht i lartë

Shkaqet e mundshme	Veprimi korrigjues
Valvula e çlirimit të presionit është prishur ose është bllokuar.	- Shpëlani dhe pastroni të gjithë depozitën duke përfshirë tubacionin midis valvulës së çlirimit të presionit dhe hyrjes së ujit të ftohtë. - Ndërroni valvulën e çlirimit të presionit.

14.3.3 Simptoma: Funkcioni i dezinfektimit të depozitës NUK përfundon si duhet (gabim AH)

Shkaqet e mundshme	Veprimi korrigjues
Funksioni i dezinfektimit është ndërprerë nga marrja e ujit të ngrohtë sanitar	Programoni nisjen e funksionit të dezinfektimit në periudhën kur gjatë 4 orëve NUK parashikohet fare përdorim i ujit të ngrohtë sanitar.
Së fundi ka pasur përdorim të madh të ujit të ngrohtë sanitar, përpara nisjes së funksionit të dezinfektimit	Nëse te [5.6] Depozita > Mënyra e ngrohjes është zgjedhur modaliteti Vetëm ringrohje ose Programi + ringrohje, rekomandohet të programoni nisjen e funksionit të dezinfektimit të paktën 4 orë më vonë sesa tërheqja më e madhe e fundit e pritshme e ujit të ngrohtë në çezma. Kjo nisje mund të caktohet në cilësimet për instaluesin (funksioni i dezinfektimit). Nëse te [5.6] Depozita > Mënyra e ngrohjes është zgjedhur modaliteti Vetëm planifikim, rekomandohet të programoni veprimin Ekonomik 3 orë përpara nisjes së programuar të funksionit të dezinfektimit, për të nxehur paraprakisht depozitën.
Operacioni i dezinfektimit është ndërprerë manualisht: [C.3] Funksionimi > Depozita është fikur gjatë dezinfektimit.	MOS ndaloni funksionimin e depozitës gjatë dezinfektimit.

14.4 Zgjidhja e problemeve bazuar te kodet e gabimit

Nëse njësia ka probleme, ndërfaqja e përdoruesit shfaq një kod gabimi. Është e rëndësishme të kuptohet problemi dhe marrja e masave para rivendosjes së kodit

të gabimit. Kjo duhet të bëhet nga një instalues i licencuar ose distributori juaj lokal.

Ky kapitull ju jep një përmbledhje të të gjitha kodeve të mundshme të gabimit dhe përshkrimin e tyre siç shfaqen në ndërfaqen e përdoruesit.



INFORMACION

Shikoni manualin e shërbimit për:

- Listën e plotë të kodeve të gabimit
- Një udhëzim më të detajuar për zgjidhjen e problemeve për secilin gabim

14.4.1 Për të shfaqur tekstin e ndihmës në rast defekti

Në rast defekti, në ekranin kryesor shfaqet një nga opsionet në vijim, në varësi të ashpërsisë:

- : Gabim
- : Defekt

Mund të merrni një përshkrim të shkurtër dhe një përshkrim të gjatë të defektit, si më poshtë:

1	Shtypni çelësin rrotullues të majtë për të hapur menunë kryesore dhe shkoni te Defektet . Rezultati: Në ekran shfaqet një përshkrim i shkurtër i gabimit dhe kodi i gabimit.	
2	Shtypni ? në ekranin e gabimit. Rezultati: Në ekran shfaqet një përshkrim i gjatë i gabimit.	?



PARALAJMËRIM

Në rastin e kodit të gabimit F3-00, ekziston rreziku i mundshëm për rrjedhje të gazit ftohës. Kontaktoni me instaluesin.

14.4.2 Kodet e gabimeve: Përmbledhje

Kodet e gabimeve të njësisë

Kodi i gabimit	Përshkrimi
89-01	Aktivizuar mbrojtja kundër ngrirjes e shkëmbyesit të nxehtësisë gjatë shkrirjes (gabim)
89-02	Aktivizuar mbrojtja kundër ngrirjes e shkëmbyesit të nxehtësisë gjatë funksionimit në ngrohje / DHW. (paralajmërim)
89-03	Aktivizuar mbrojtja kundër ngrirjes e shkëmbyesit të nxehtësisë gjatë shkrirjes (paralajmërim)
A1-00	Problem i diktimit të kryqëzimit të fazave
A5-00	OU: Ndërprerje nga piku i presionit të lartë / problem i diktimit të ngrirjes
AH-00	Funksioni i dezinfektimit të depozitës nuk ka përfunduar si duhet

Kodi i gabimit	Përshkrimi
AJ-03	 Kohë shumë e gjatë e nevojshme për nxehjen e DHW
C4-00	 Problem i sensorit të temperaturës së shkëmbyesit të nxehtësisë
C5-00	 Anomali e termistorit të shkëmbyesit të nxehtësisë
E1-00	 OU: Defekt i PCB
E3-00	 OU: Aktivizimi i çelësit të presionit të lartë (HPS)
E3-24	 Anomali e sensorit të presionit të lartë
E5-00	 OU: Mbinxehje e motorit të kompresorit inverter
E6-00	 OU: Defekt i nisjes së kompresorit
E7-00	 OU: Defekt i motorit të ventilatorit të njësisë së jashtme
E8-00	 OU: Mbitension i furnizimit me energji
EA-00	 OU: Problem me kalimin nga ftohje/ngrohje
EC-00	 Rritje anormale e temperaturës së depozitës
F3-00	 OU: Defekt i temperaturës së tubit të shkarkimit
F6-00	 OU: Presion i lartë anormal në ftohje
F8-00	 Gabim i brendshëm i kompresorit
H0-00	 OU: Problem i sensorit të tensionit/rrymës
H3-00	 OU: Defekt i çelësit të presionit të lartë (HPS)
H6-00	 OU: Defekt i sensorit të zbulimit të pozicionit
H8-00	 OU: Defekt i sistemit të hyrjes së kompresorit (CT)
H9-00	 OU: Defekt i termistorit të ajrit të jashtëm
HC-00	 Problem i sensorit të temperaturës së depozitës
J3-00	 OU: Defekt i termistorit të tubit të shkarkimit
J3-10	 Anomali e termistorit të portës së kompresorit
J6-00	 OU: Defekt i termistorit të shkëmbyesit të nxehtësisë
J6-07	 OU: Defekt i termistorit të shkëmbyesit të nxehtësisë

Kodi i gabimit	Përshkrimi
J6-32	 Anomali e termistorit të temperaturës së ujit që largohet (njësia e jashtme)
J8-00	 Defekt i termistorit të gazit ftohës lëng
J9-00	 Defekt i termistorit të gazit ftohës gaz
JA-00	 OU: Defekt i sensorit të presionit të lartë
L1-00	 Defekt i PCB INV
L3-00	 OU: Problem i rritjes së temperaturës së kutisë elektrike
L4-00	 OU: Defekt i rritjes së temperaturës së fletës së rrezatimit të inverterit
L5-00	 OU: Rrymë e lartë e menjëhershme e inverterit (DC)
L8-00	 Defekti është aktivizuar nga mbrojtja termike në PCB të inverterit
P1-00	 Fazë e hapur, disbalancë në furnizimin me energji elektrike.
P4-00	 OU: Defekt i sensorit të temperaturës së fletës së rrezatimit
PJ-00	 Mospërputhje në vendosjen e kapacitetit
U0-00	 OU: Mungesë e gazit ftohës
U2-00	 OU: Defekt i tensionit të furnizimit me energji.
U4-00	 Problem komunikimi njësi e brendshme/e jashtme
U5-00	 Problem komunikimi i ndërfaqes së përdoruesit
U6-38	 Problem komunikimi Extension/Hydro
U7-00	 OU: Defekt transmetimi midis CPU kryesore - CPU INV
U8-04	 Pajisje USB e panjohur
U8-05	 Defekt i skedarit
U8-07	 Gabim komunikimi P1P2
U8-09	 Gabim përputhshmërie versioni i softuerit të MMI {version_MMI_software} / njësia e brendshme [version_IU_modelname]
U8-11	 Lidhja me ruterin wireless u shkëput.
UA-00	 Problem i përputhjes njësi e brendshme, njësi e jashtme
UA-17	 Problem i llojit të depozitës
UF-00	 Diktim i lidhjes së tubave në të kundërt ose instalim i keq i komunikimit.

Kodi i gabimit	Përshkrimi
UH-00	 Defekt i njësisë së brendshme ose ngricë në njësitet e tjera të brendshme

**INFORMACION**

Në rastin e kodit të gabimit F3-00, ekziston një rrezik i mundshëm për rrjedhje të gazit ftohës.

**INFORMACION**

Nëse shfaqet kodi i gabimit AH dhe nuk ka pasur asnjë ndërprerje të funksionit të dezinfektimit si rezultat i marrjes së ujit të ngrohtë sanitar nga çezma, rekomandohen veprimet e mëposhtme:

- Nëse zgjidhet modaliteti **Vetëm ringrohje** ose **Programi + ringrohje**, rekomandohet të programoni nisjen e funksionit të dezinfektimit të paktën 4 orë më vonë sesa tërheqja më e madhe e fundit e pritshme e ujit të ngrohtë në çezma. Kjo nisje mund të caktohet në cilësimet për instaluesin (funksioni i dezinfektimit).
- Nëse zgjidhet modaliteti **Vetëm planifikim**, rekomandohet të programoni veprimin **Ekonomik** 3 orë përpara nisjes së programuar të funksionit të dezinfektimit, për të nxehur paraprakisht depozitën.

**INFORMACION**

Gabimi AJ-03 hiqet automatikisht në momentin që ka një nxehje normale të depozitës.

**INFORMACION**

Nëse ndodh një gabim U8-04, gabimi mund të hiqet pas përditësimit me sukses të softuerit. Nëse përditësimi i softuerit nuk përfundon me sukses, atëherë sigurohuni që pajisja juaj USB ka formatin FAT32.

**INFORMACION**

Nëse rezistenca përforcuese nxehet më shumë sesa duhet dhe çaktivizohet nga mbrojtja termostatike, njësia nuk jep gabim direkt. Kontrolloni nëse rezistenca përforcuese është ende në punë, nëse hasni një ose më shumë nga gabimet e mëposhtme:

- Funksionimi i fuqishëm kërkon shumë kohë që të nxehë dhe shfaqet kodi i gabimit AJ-03.
- Gjatë operacionit anti-legionella (çdo javë), kodi i gabimit AH-00 shfaqet sepse njësia nuk mund të arrijë temperaturën e kërkuar që nevojitet për dezinfektimin e depozitës.

**INFORMACION**

Rezistenca përforcuese që punon me defekt do të ketë ndikim në matjen e energjisë dhe kontrollin e kufizimit të energjisë.

**INFORMACION**

Ndërfaqja e përdoruesit tregon sesi rivendoset një kod gabimi.


15 Të dhënat teknike

Një **nëngrup** i të dhënave më të fundit teknike ofrohet në faqen rajonale të internetit të Daikin (e aksesueshme nga publiku). **Seti i plotë** i të dhënave më të fundit teknike ofrohet në Daikin Business Portal (kërkohet autentikim).

Në këtë kapitull

15.1	Diagrami i tubacionit: Njësia e brendshme.....	113
15.2	Skema e qarkut: Njësia e brendshme	114

15.1 Diagrami i tubacionit: Njësia e brendshme



- a1** Uji i ngrohtë sanitar – dalja e ujit të ngrohtë
a2 Uji i ngrohtë sanitar – hyrja e ujit të ftohtë
b1 Valvula e bllokimit të lëngut
b2 Valvula e bllokimit të gazit
c Rezistenca përforcuese
d Valvula e lirimit të presionit
 (vetëm për Mbretërinë e Bashkuar)

- Termistorët:**
R3T Termistori i shkëmbyesit të nxehtësisë – tubi i lëngut
R5T Termistori i depozitës

15.2 Skema e qarkut: Njësia e brendshme

Shihni skemën e brendshme të qarkut të ofruar me njësinë (në brendësi të kapakut të kutisë shpërndarëse të njësisë së brendshme). Shkurtime të përdorura jepen të renditura më poshtë.

Legjenda

A1P		PCB kryesore
F2B	#	Siguresa e mbirrymës e rezistencës përforcuese
FU1 (A1P)		Siguresa (5 A 250 V për PCB)
K3M		Kontaktori i rezistencës përforcuese
Q1DI	#	Çelësi automat për rrjedhje të tokëzimit
TR1		Transformatori i ushqimit elektrik
X4M	#	Shiriti i terminaleve të ushqimit elektrik të rezistencës përforcuese, klienti
X8M		Shiriti i terminaleve të ushqimit elektrik të rezistencës përforcuese
X*, X*A, X*B		Bashkuesi
X*M		Shiriti i terminaleve

* Opsional/e

Sigurohet në terren

Përkthimi i tekstit në skemën e qarkut

Anglisht	Përkthimi
(1) Connection diagram	(1) Connection diagram
Compressor switch box	Kutia shpërndarëse e kompresorit
Multi+DHW Tank switch box	Kutia shpërndarëse për disa depozita të ujit të ngrohtë sanitar
Indoor	Brenda
Outdoor	Jashtë
SWB	Kutia shpërndarëse
(2) Legend	(2) Legjenda
A1P	PCB kryesore
F2B	Siguresa e mbirrymës e rezistencës përforcuese
FU1 (A1P)	Siguresa (5 A 250 V për PCB)
K3M	Kontaktori i rezistencës përforcuese
Q1DI	Çelësi automat për rrjedhje të tokëzimit
TR1	Transformatori i ushqimit elektrik
X4M	Shiriti i terminaleve të ushqimit elektrik të rezistencës përforcuese, klienti

Për më shumë detaje kontrolloni skemën e njësisë.



16 Fjalori

Shitësi

Shpërndarësi i shitjeve për produktin.

Instaluesi i autorizuar

Personi me aftësi teknike, i cili është i kualifikuar për të instaluar produktin.

Përdoruesi

Personi që është zotëruesi i produktit dhe/ose operon produktin.

Legjislacioni në fuqi

Të gjitha direktivat, ligjet, rregullat dhe/ose kodet ndërkombëtare, evropiane, kombëtare dhe vendore, që lidhen dhe përdoren për një produkt ose domen të caktuar.

Kompania e shërbimit

Kompania e kualifikuar që mund të kryejë ose bashkërendojë shërbimin e kërkuar të produktit.

Manuali i instalimit

Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen.

Manuali i përdorimit

Manuali i specifikuar i udhëzimit për një produkt ose përdorim të caktuar, duke shpjeguar përdorimin e tij.

Udhëzimet e mirëmbajtjes

Manuali i udhëzimit specifikuar për një produkt të caktuar apo aplikim, i cili sqaron (nëse përshtatet) si të instaloni, konfiguroni, operoni dhe/ose mirëmbani produktin apo aplikimin.

Aksesorë

Etiketa, manuale, fletëudhëzues dhe pajisje, që dorëzohen me produktin dhe që kanë nevojë të instalohen në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Pajisjet opsionale

Pajisje prodhuar ose miratuar nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet në dokumentet shoqëruese.

Furnizuar nga instaluesi

Pajisje të prodhuara JO nga Daikin që mund të kombinohen me produktin në përputhje me udhëzimet te dokumentacioni shoqërues.

Tabela e cilësimeve të fushave

Njësitë e brendshme të zbatueshme

EKHWET90BAV3

EKHWET(U)120BAV3

Shënime

(*1) EKHWET90+120

(*2) EKHWETU120

Tabela e cilësimeve të fushave					Cilësimi i instaluesit në ndryshim nga vlera e paracaktuar		
Modeli shabllon	Kodi i fushës	Emri i cilësimit		Diapazoni, hapi Vlera e paracaktuar	Data	Vlera	
Depozita							
5.2	[6-0A]	Vlera e caktuar e komoditetit	R/W	30~[6-0E]°C, hapi: 1°C 50°C			
5.3	[6-0B]	Vlera e caktuar ekologjike	R/W	30~min(50, [6-0E])°C, hapi: 1°C 45°C			
5.4	[6-0C]	Vlera e caktuar e ringrohjes	R/W	30~min(50, [6-0E])°C, hapi: 1°C 45°C			
5.6	[6-0D]	Modaliteti i nxehjes	R/W	0: Vetëm ringrohje 1: Ringrohje + programim 2: Vetëm programuar			
Dezinfektimi							
5.7.1	[2-01]	Aktivizimi	R/W	0: Jo 1: Po			
5.7.2	[2-00]	Dita e funksionimit	R/W	0: Çdo ditë 1: E hënë 2: E martë 3: E mërkurë 4: E enjte 5: E premte 6: E shtunë 7: E diel			
5.7.3	[2-02]	Ora e nisjes	R/W	Ora 0~23, hapi: 1 orë 1			
5.7.4	[2-03]	Vlera e caktuar e depozitës	R/W	55-maks(55, 6-0E)~75°C, hapi: 1°C (*1) 55-maks(55, 6-0E)~70°C, hapi: 1°C (*2) 70°C			
5.7.5	[2-04]	Kohëzgjatja	R/W	5~60 min, hapi: 5 min 10 min			
Depozita							
5.8	[6-0E]	Maksimumi	R/W	40~75°C, step: 1°C (*1) 40~70°C, step: 1°C (*2) 75°C (*1) 70°C (*2)			
5.9	[6-00]	Histerezia	R/W	2~20°C, hapi: 1°C 6°C			
5.A	[6-08]	Histerezia	R/W	2~20°C, hapi: 1°C 10°C			
5.B		Modaliteti i vlerës së caktuar	R/W	0: I fiksuar 1: Në varësi nga moti			
Kurba WD							
5.C	[0-0B]	Vendosja e vlerës së temperaturës së ujit për temp. e lartë ambienti për kurbën DHW WD.	R/W	35~[6-0E]°C, hapi: 1°C 43°C			
5.C	[0-0C]	Vendosja e vlerës së temperaturës së ujit për temp. e ulët ambienti për kurbën DHW WD.	R/W	45~[6-0E]°C, hapi: 1°C 50°C			
5.C	[0-0D]	Temp. e lartë ambienti për kurbën DHW WD.	R/W	10~25°C, hapi: 1°C 25°C			
5.C	[0-0E]	Temp. e ulët ambienti për kurbën DHW WD.	R/W	-40~5°C, hapi: 1°C -15°C			
Depozita							
5.D	[6-01]	Kufiri	R/W	0~10°C, hapi: 1°C 2°C			
5.F	[A-00]	Programi i prioritetit	R/W	0: DHW 1: Ajri i kondicionuar			
5.G	[A-01]	Modaliteti i funksionimit	R/W	0: Efikas 1: I shpejtë			
5.H	[8-03]	Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë	R/W	Turbo: 10 min Normal: 20 min Ekonomik: 30 min			
Cilësimet e përdoruesit							
I qetë							
7.4.1		Modaliteti	R/W	0: FIKUR 1: Manual 2: Automatik			
7.4.3		Niveli	R/W	0: I qetë 1: Më i qetë 2: Më i qetë			
Cilësimet e instaluesit							
Eksperti i konfigurimit							
Sistemi							
9.1.3.3	[E-05] [E-06] [E-07]	Uji i ngrohtë sanitar	R/O	I integruar			
9.1.3.4	[4-06]	Emergjencia	R/W	0: Manuale 1: Automatike			
9.1.3.7	[6-02]	Kapaciteti BSH	R/W	0~10kW, hapi: 0,2kW 1,2 kW			
Depozita							
9.1.B.1	[6-0D]	Modaliteti i nxehjes	R/W	0: Vetëm ringrohje 1: Ringrohje + programim 2: Vetëm programuar			
9.1.B.2	[6-0A]	Vlera e caktuar e komoditetit	R/W	30~[6-0E]°C, hapi: 1°C 50°C			
9.1.B.3	[6-0B]	Vlera e caktuar ekologjike	R/W	30~min(50, [6-0E])°C, hapi: 1°C 45°C			
9.1.B.4	[6-0C]	Vlera e caktuar e ringrohjes	R/W	30~min(50, [6-0E])°C, hapi: 1°C 45°C			
9.1.B.6	[6-08]	Histerezia e ringrohjes	R/W	2~20°C, hapi: 1°C 10°C			
Ngrohësi përforcues							
9.4.1	[6-02]	Kapaciteti	R/W	0~10kW, hapi: 0,2kW 1,2 kW			
9.4.3	[8-03]	Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë	R/W	5~95 min, hapi: 5 min 20 min			
9.4.4	[4-03]	Funksionimi	R/W	0: I kufizuar 1: I lejuar 2: Mbivendosje 3: Kompresori fikur			
Emergjencia							
9.5.1	[4-06]	Emergjencia	R/W	0: Manuale 1: Automatike			
Kontrolli i konsumit të energjisë							

Tabela e cilësimeve të fushave					Cilësimi i instaluesit në ndryshim nga vlera e paracaktuar		
Modeli shabllon	Kodi i fushës	Emri i cilësimit	Diapazoni, hapi	Vlera e paracaktuar	Data	Vlera	
9.9.1	[4-08]	Kontrolli i konsumit të energjisë	R/W	0: Pa kufizim 1: Në vazhdimësi			
9.9.2	[4-09]	Lloji	R/W	0: Rryma 1: Fuqia			
9.9.3	[5-05]	Kufiri	R/W	12~50 A, hapi: 1 A 12 A			
9.9.8	[5-09]	Kufiri	R/W	3~20 kW, hapi: 0,5 kW 3 kW			
9.9.D	[4-01]	Ngrohësi parësor	R/O	0: Asnjë 1: BSH 2: BUH			
└─ Sensorët							
9.B.3	[1-0A]	Mesatarizimi i kohës	R/W	0: Asnjë mesatarizim 1: 12 orë 2: 24 orë 3: 48 orë 4: 72 orë			
Cilësimet e instaluesit							
9.E	[3-00]	Rindezja automatike	R/W	0: Jo 1: Po			
9.F	[E-08]	Funksioni i kursimit të energjisë	R/W	0: Çaktivizuar 1: Aktivizuar			
9.G		Çaktivizo mbrojtjet	R/W	0: Jo 1: Po			
└─ Përmbledhje e cilësimeve të fushave							
9.I	[0-0B]	Vendosja e vlerës së temperaturës së ujit për temp. e lartë ambientit për kurbën DHW WD.	R/W	35~[6-0E]°C, hapi: 1°C 43°C			
9.I	[0-0C]	Vendosja e vlerës së temperaturës së ujit për temp. e ulët ambientit për kurbën DHW WD.	R/W	45~[6-0E]°C, hapi: 1°C 50°C			
9.I	[0-0D]	Temp. e lartë ambientit për kurbën DHW WD.	R/W	10~25°C, hapi: 1°C 25°C			
9.I	[0-0E]	Temp. e ulët ambientit për kurbën DHW WD.	R/W	-40~5°C, hapi: 1°C -15°C			
9.I	[1-0A]	Cila është koha e mesatarizimit për temperaturën e jashtme?	R/W	0: Asnjë mesatarizim 1: 12 orë 2: 24 orë 3: 48 orë 4: 72 orë			
9.I	[2-00]	Kur duhet ekzekutuar funksioni i dezinfektimit?	R/W	0: Çdo ditë 1: E hënë 2: E martë 3: E mërkurë 4: E enjte 5: E premte 6: E shtunë 7: E diel			
9.I	[2-01]	Duhet ekzekutuar funksioni i dezinfektimit?	R/W	0: Jo 1: Po			
9.I	[2-02]	Kur duhet të nisë funksioni i dezinfektimit?	R/W	Ora 0~23, hapi: 1 orë 1			
9.I	[2-03]	Cila është temperatura e synuar e dezinfektimit?	R/W	55~maks(55, 6-0E), hapi: 1°C 70°C			
9.I	[2-04]	Sa gjatë duhet ruajtur temperatura e depozitës?	R/W	5~60 min, hapi: 5 min 10 min			
9.I	[3-00]	A lejohet rindezja automatike e njësisë?	R/W	0: Jo 1: Po			
9.I	[4-01]	Cili ngrohës elektrik ka prioritet?	R/O	0: Asnjë 1: BSH 2: BUH			
9.I	[4-03]	Leja e funksionimit e ngrohësit përforcues.	R/W	0: I kufizuar 1: I lejuar 2: Mbivendosje 3: Kompresori fikur			
9.I	[4-06]	Emergjenca	R/W	0: Manuale 1: Automatike			
9.I	[4-08]	Cili modalitet i kufizimit të fuqisë kërkohet në sistem?	R/W	0: Pa kufizim 1: Në vazhdimësi			
9.I	[4-09]	Cili lloj i kufizimit të fuqisë kërkohet?	R/W	0: Rryma 1: Fuqia			
9.I	[5-05]	Cili është kufiri i kërkuar për DI1?	R/W	12~50 A, hapi: 1 A 12 A			
9.I	[5-09]	Cili është kufiri i kërkuar për DI1?	R/W	3~20 kW, hapi: 0,5 kW 3 kW			
9.I	[6-00]	Diferenca e temperaturës që përcakton temperaturën e ndezjes së pompës së nxehtësisë.	R/W	2~20°C, hapi: 1°C 6°C			
9.I	[6-01]	Diferenca e temperaturës që përcakton temperaturën e fikjes së pompës së nxehtësisë.	R/W	0~10°C, hapi: 1°C 2°C			
9.I	[6-02]	Cili është kapaciteti i ngrohësit përforcues?	R/W	0~10kW, hapi: 0,2kW 1,2 kW			
9.I	[6-08]	Cila histerezi duhet përdorur në modalitetin e ringrohjes?	R/W	2~20°C, hapi: 1°C 10°C			
9.I	[6-0A]	Cila është temperatura e dëshiruar e ruajtjes së komoditetit?	R/W	30~[6-0E]°C, hapi: 1°C 50°C			
9.I	[6-0B]	Cila është temperatura e dëshiruar e ruajtjes ekologjike?	R/W	30~min(50, [6-0E])°C, hapi: 1°C 45°C			
9.I	[6-0C]	Cila është temperatura e dëshiruar e ringrohjes?	R/W	30~min(50, [6-0E])°C, hapi: 1°C 45°C			
9.I	[6-0D]	Cili është lloji i dëshiruar i prodhimit të DHW?	R/W	0: Vetëm ringrohje 1: Ringrohje + programim 2: Vetëm programuar			
9.I	[6-0E]	Cila është vlera e caktuar maksimale e temperaturës së DHW?	R/W	40~75°C, step: 1°C (*1) 40~70°C, step: 1°C (*2) 75°C (*1) 70°C (*2)			
9.I	[7-00]	Temperatura e kapërcimit e ngrohësit përforcues të ujit të ngrohtë sanitar.	R/W	0~4°C, hapi: 1°C 0°C			
9.I	[7-01]	Histerezia e ngrohësit përforcues të ujit të ngrohtë sanitar.	R/W	2~40°C, hapi: 1°C 2°C			
9.I	[8-03]	Kohëmatësi i vonësës së ngrohësit përforcues (ose Kohëmatësi i modalitetit të shpejtë)	R/W	5~95 min, hapi: 5 min 20 min			
9.I	[A-00]	Cili funksionim i njësisë së brendshme merr prioritet nga njësia e jashtme?	R/W	0: DHW 1: Ajri i kondicionuar			

(*1) EKHWE90+120

(*2) EKHWE120

Tabela e cilësimeve të fushave					Cilësimi i instaluesit në ndryshim nga vlera e paracaktuar	
Modeli shabllon	Kodi i fushës	Emri i cilësimit	Diapazoni, hapi Vlera e paracaktuar		Data	Vlera
9.I	[A-01]	Cili modalitet funksionimi përdoret për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar?	R/W	0: Efikas 1: I shpejtë		
9.I	[A-02]	--		1		
9.I	[A-03]	--		0		
9.I	[A-04]	--		0		
9.I	[B-00]	--		0		
9.I	[B-01]	--		0		
9.I	[B-02]	--		0		
9.I	[B-03]	--		0		
9.I	[B-04]	--		0		
9.I	[E-00]	Çfarë lloj njësie është instaluar?	R/O	0-5 4: DHWHP		
9.I	[E-01]	Cili lloj kompresori është instaluar?	R/O	0		
9.I	[E-02]	Cili është lloji i softuerit të njësisë së brendshme?	R/O	1: Vetëm ngrohje		
9.I	[E-04]	Disponohet funksioni i kursimit të energjisë në njësinë e jashtme?	R/O	0: Jo 1: Po		
9.I	[E-05]	A përgatit dot sistemi ujë të ngrohtë sanitar?	R/W	0: Jo 1: Po		
9.I	[E-06]	A është instaluar depozitë DWH në sistem?	R/O	0: Jo 1: Po		
9.I	[E-07]	Çfarë lloj depozite DHW është instaluar?	R/O	0-8 0: EKHV, vëllim i vogël 1: E integruar 2: Depozitë me BSH 3: EKHV, vëllim i madh 5: EKHWP 7: Depozitë nga të tjerë, serpentinë e vogël 8: Depozitë nga të tjerë, serpentinë e madhe		
9.I	[E-08]	Funksioni i kursimit të energjisë për njësinë e jashtme.	R/W	0: Çaktivizuar 1: Aktivizuar		
9.I	[F-0A]	--		0		

